Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 4 (120). PRILL 2016. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



Market KEN
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

PORTRET

Doktor Qatipi, shkencëtari i bimëve mjekësore

NGA **OSMAN XHILI** - FAQE 9

FOLKLOR

"Oj Fusha e Korabit", pasthirrmë dhimbje, thirrje shprese

NGA **ERMIRA SHEHU - TOCA** - FAQE 19

REPORTAZH

Vetëm me fitore mund t'ua shlyej borxhin e mikpritjes suaj

NGA **DEFRIM METHASANI** - FAQE 13

PORTRET

Hajri Shehu, një personalitet i heshtur i gjuhësisë shqiptare

NGA **ESHREF YMERI** - FAQE 21

Lura akuzon



Prerja e pyjeve, zjarret, mungesa e rrugës dhe heqja e mundësisë së shfrytëzimit të turizmit është një krim, për të cilën të gjitha përgjegjësitë bien mbi qeveritë shqiptare të tranzicionit. Me mosveprimet e saj ajo ka ndihmuar në shkatërrimin e pasurisë sonë kombëtare.

Nga **BUJAR KAROSHI**

Më 16 prill udhëtova drejt Lurës së bashku me 12 veta të tjerë nga Fieri, Përmeti, Rrësheni, Mirdita e Tirana. Ne jemi pjesë e një autokolone me 15 mikrobusë, me qytetarë nga të katër anët e vendit, nga Kosova, por edhe të huaj, që i jemi bashkuar projektit *"Të gjithë për Lurën"*.

Iniciativa për mbjelljen e pishave lindi nga *Ecovolis*, një organizatë joqeveritare me qendër në Tiranë, e cila promovon transportin ekologjik dhe ruajtjen e natyrës. Të dielën e parë të prillit 12 anëtarë të organizatës mbollën 40 pemët e para rreth kurorës së Liqenit të Rrasave, liqenit të parë më të afërt me qendrën e Lurës, pjesë e shtatë liqeneve akullnajorë të njohur nga librat e gjeografisë.

(Lexoni në faqet 2-3)

koment

Rruga si çështje elektorale, një kartë e djegur

- Partitë e përdorin për të fituar vota, por në fakt e përdorin për turpin e tyre, sepse pikërisht me mënyrën se si e përdorin këtë çështje, kuptohet se ata gënjejnë.
- Një grup qytetarësh të angazhuar po përpiqen të mbajnë gjallë çështjen dhe peticioni online ka mbi tre vite që nuk po e ul ritmin. Ndërkohë që qeveria nuk e ka pranuar qoftë edhe formalisht peticionin, kërkohen angazhime të reja për çështjen dhe ristrukturim të shoqatave dibrane, madje edhe me radikalizim të çështjes: protesta në sheshe dhe rrugë.
- Të kërkosh ta përdorësh Rrugën e Arbrit si një argument për fushatën e ardhshme është humbje kohe. Deri atëherë është një vit në mes: dhe për një vit qeveria aktuale ka mundësi të tregojë vullnetin për rrugën. Së pari të pranojë publikisht peticionin dhe së dyti të dëshmojë veprime konkrete në fillimin e punimeve.

NGA **BUJAR KAROSHI** - FAQE 7

opinion

Eh, ç'më ktheve gjashtë dekada pas Lura ime !

NGA **ABDURAHIM ASHIKU** - FAQE 4

Rinimi i shkretëtirës lurjane

NGA **DR. SELMAN MEZIU** - FAQE 4

opinion

Kush e shkatërroi Lurën?

Kush e shoi parkun e madh të Lurës, të bukurën e dheut? Banorët e Lurës, drejtuesit e këtyre komunave, biznesmenët e ndërtimit apo politikanet? Kësaj pyetjeje i përgjigjen kështu ata që kanë ngelë në Lurë: "Lurën e shkatërroi SISTEMI". Me këtë ata nuk e kanë fjalën për sistemin demokratik, por për një lidhje të fuqishme që u krijua dhe veproi brenda tij. Një sistem njerëzish dhe forcash që e pushtoi vendin tonë. Në këtë sistem janë sistemuar politikanët, p.sh deputeti i Lurës, që, kur shkonte në Lurë për të kërkuar votat, ju thoshte banorëve: "Për të jetuar ju mund të prisni ndonjë dru nga pylli, se neve do e mbyllim një sy për të ndihmuar të varfërit".

NGA **XHEMAL MATO** - FAQE 5

O sa mirë me qenë dibran…

NGA **PËRPARIM SPAHIU** - FAQE 6

Dhe Rruga e Arbrit duhet bërë

NGA **SHPËTIM IDRIZI** - FAQE 6

Jalla lema me këta deputet që kena

FEJTON NGA **ABDURAHIM ASHIKU** - FAQE 6

KNAUF Bashkëpunon me komunitetin
www.knauf.al

cyan magenta yelloë black 1

Rruga e Arbërit nr. 120
kryesore

Ata e quajtën vetën "Heronjtë e heshtur" dhe pishat që mbollën u vendosën emrin "Pishat e Shpresës". Fotografitë e tyre këmbëzbathur duke mbjellë pishat aty ku bora nuk kishte ikur akoma, ngjallën një reagim shumë pozitiv në rrjetet sociale, çka i nxitën që nismës "Një pishë për Lurën", t'i bashkoheshin me 16 prill rreth 300 qytetarë nga rajone të ndryshme të vendit.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 4 (120). 1 - 30 Prill 2016

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Korrespondentë të përhershëm:
Sashenka NDREKA
Hysen LIKDISHA
Abdurahim ASHIKU

Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Selman MËZIU
Xhemal MATO
Marin MEMA
Xhafer MARTINI
Përparim SPAHIU
Shpëtim IDRIZI
Defrim METHASANI
Halil TEODORI
Ali HOXHA
Astrit GJUNKSHI
Ermira SHEHU
Dionis XHAFA
Fatbardh CENA
Zabit LLESHI
Mevlud BUCI
Ruzhdi LATA
Eshref YMERI
Valeria DEDEJ
Qazim D. SHEHU

Fotoreporter: Fehmi Lleshi

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL902021121900000004700036640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Nga BUJAR KAROSHI



Të dielën e parë të prillit 12 anëtarë të rinj mbollën 40 pemët e para rreth kurorës së Liqenit të Rrasave. Foto: Ecovolis

Më 16 prill udhëtova drejt Lurës së bashku me 12 veta të tjerë nga Fieri, Përmeti, Rrësheni, Mirdita e Tirana. Ne jemi pjesë e një autokolone me 15 mikrobusë, me qytetarë nga të katër anët e vendit, nga Kosova, por edhe të huaj, që i jemi bashkuar projektit *"Të gjithë për Lurën"*.

Iniciativa për mbjelljen e pishave lindi nga Ecovolis, një organizatë joqeveritare me qendër në Tiranë, e cila promovon transportin ekologjik dhe ruajtjen e natyrës. Të dielën e parë të prillit 12 anëtarë të organizatës mbollën 40 pemët e para rreth kurorës së Liqenit të Rrasave, liqenit të parë më të afërt me qendrën e Lurës, pjesë e shtatë liqeneve akullnajorë të njohur nga librat e gjeografisë.

Ata e quajtën vetën "Heronjtë e heshtur" dhe pishat që mbollën u vendosën emrin "Pishat e Shpresës". Fotografitë e tyre këmbëzbathur duke mbjellë pishat aty ku bora nuk kishte ikur akoma, ngjallën një reagim shumë pozitiv në rrjetet sociale, çka i nxitën që nismës "Një pishë për Lurën", t'i bashkoheshin me 16 prill rreth 300 qytetarë nga rajone të ndryshme të vendit, ku nuk munguan as disa zyrtarë lokalë, mes të cilëve edhe Prefektja e Dibrës.

Nismës iu bashkua edhe Dod Doçi, një biznesmen i njohur në Tiranë me origjinë nga Lura, i cili mbështeti aktivistët me shpenzimet e transportit, por edhe me drekën e shtruar për ta në Lurë.

"TË GJITHË PËR LURËN"

Albiona Muçoimaj është një vajzë nga Tepelena, studente në Tiranë. Ajo është e angazhuar në organizatën Ecovolis dhe kur ne e takuam në Tiranë, sapo kthehej nga një protestë para Ministrisë së Mjedisit dhe në krah kishte shkruar parullën "Me Lurën dogjët edhe shpresën". "Parulla ishte për protestën, por ne po përpiqemi të ringjallim shpresën në Lurë", - thotë Muçoimaj. Ajo thotë se iniciativa nuk ka asnjë mbështetje financiare, nuk është bazuar mbi asnjë projekt apo mënyrë tjetër financimi. Gjithçka është vullnetare, edhe donacionet. Vullnetarët kanë blerë vetë pishat e zeza që do mbillen në Lurë ose disa prej tyre kanë kontribuar në kutitë e ndihmës të shpërndarë në disa pika të *Ecovolis* në Tiranë. Por shumica e donacioneve u mblodh më 16 prill në mëngjes, - tha ajo, - ndërsa aktivistët po bëheshin gati për t'u nisur.

Albiona tregon se është rritur me imazhet e një Lure përmes librash dhe fotografish, por nuk i kishte shkuar kurrë në mendje se ajo do të përballej me një Lurë ku trungjet e prera të pishave, bredhave të sëmurë dhe foleve të tenjave. Lurën e gjetëm të ftohtë, të zbrazur, të boshatisur, pa rrugë, por prej kësaj veç u shtua dëshira për të nisur një lëvizje që do t'i kthejë shpresën Lurës.

"Neve na dhemb zemra. Na dhemb kur e shohim të braktisur, në mjerim, jetim e zhdukje", - shkruhet në faqen e FB të ndërtuar nga *Ecovolis* në lidhje me nismën "Të gjithë për Lurën".

Nisma ka synime që duken si utopike për gjendjen aktuale të rrugës, por ndryshimi nuk ndodh menjëherë. Albiona shpjegon se nisma nuk është utopike. Ajo dhe anëtarët e tjerë të organizatës e dinë se nuk janë në gjendje të mbjellin gjithë Lurën, t'i ruajnë fidanët e mbjellë apo të ndërpresin shkatërrimin e saj. Synimi i të rinjve është që kurorat rreth liqeneve të mbillen dhe të gjenerohen brenda një afati të shkurtër. Kështu së paku do të merrte formë kurora e liqeneve dhe pamjet që përcjellin fotografitë nuk do të ishin kaq të tmerrshme.

RRUGA PËR LURË, NJË TORTURË

Kur mikrobusi del nga asfalti, kuptohet menjëherë se rruga do të jetë e vështirë. Një torturë e vërtetë nis. Ti mendon se rruga duhet të jetë vetëm pak kilometra e paasfaltuar, por e tillë është deri në Lurë. Me matjet në Google Map, nga fshati Perlat, aty ku një tabelë rrugore tregon Lurën si një destinacion i zakonshëm, thuhet se duhen edhe 40 km për të arritur ose 1 orë e 14 minuta, por në të vërtetë rruga është një torturë më vete. Më shumë se 4 orë e gjysmë zgjat udhëtimi dhe një pjesë e atyre që janë në mikrobus thonë se po ta dinin nuk do ta ndërmerrnin një iniciativë të tillë.

Një makinë është rrëzuar në fillim të muajit nga kjo rrugë e keqe në Lurë me pasojë një të vdekur dhe një të plagosur, por "Miqtë e Lurës" – kështu quhej grupi ynë, ose nuk ndjek lajme, ose nuk dëshiron që aksidentet të kujtohen gjatë udhëtimit. Shoferi, me siguri i ka dëgjuar lajmet, pasi herë pas here, në vende të vështira për të kaluar ndalon dhe mendohet: nga t'ia mbajë?

Në frugon tregohen barsoleta, se gjatë një fushate të kaluar, kishin qenë dy kandidatë në takim me popullin: I pari kishte thënë se n.q.s do më zgjidhni do t'ju bëj rrugën, ndërsa i dyti kishte thënë se unë rrugën nuk ua bëj dot, por merrni nga një thes me miell nga unë dhe më jepni votën. Dhe lurjanët kishin votuar thesin e miellit.

Anekdota duket e besueshme në mjedisin politik shqiptar, por kur e pyeta një rojtar të antenave të telefonisë celulare që takuam rrugës ndërsa ngjiteshim te liqenet, ai tha se kjo nuk është e vërtetë: kemi 25 vjet që na premtojnë rrugën dhe kemi 25 vjet që na gënjejnë.

Rruga është një pengesë e madhe e zhvillimit të zonës. Lura nuk ka rrugë komunikimi nga asnjëra anë, as nga Peshkopia dhe as nga Rrësheni. Si e tillë, duhet më shumë se katër orë që një makinë policie të mbërrijë në terren, kështu që kjo e ka ndihmuar që masakra mjedisore të ndodhë dhe fajtorë të mos jetë askush. Aty ku nuk futen makinat e vogla dhe komunikimi mungon, kontrabandistët dhe trafikantët e kanë më të lehtë të operojnë.

"Nuk e ka ba rrugën qeveria, as kjo dhe as ajo që ishte, sepse ata nuk e duan Lurën e bukur, por duan Lurën për ta vjedhur", më tha një banor.

Albiona pranon se nuk e dinte që Lura ishte kaq larg. Pas vizitës së parë në fillim të muajit, ajo mendonte se do të ishte shumë e vështirë që aksioni të bëhej masiv, pasi rruga e largët dhe mundësitë e pakta të transportit nuk jepnin shumë shpresë. Por me ndihmën e disa miqve nga Lura u bë e mundur që ky aksion të realizohej dhe për këtë ajo dëshiron të falënderojë Kastriot Vladin dhe vëllezërit e tij, si dhe biznesmenin Dod Doçi, pa ndihmën e të cilëve aksioni i 16 prillit nuk do të kishte kaq sukses.

Administratori i Lurës, Hasan Hoti, thotë se rruga është një problem i madh që e pengon zhvillimin e këtij rajoni. Në Lurë banojnë sot rreth 1600 banorë dhe gjatë verës numri shkon deri në 2000, pasi rikthehen disa banorë. Ndërkohë që turizmi është i pakët dhe pa shumë ndikim në ekonominë e zonës.

Lura është në programet e agjencive turistike në Tiranë, por në të shumtën e rasteve vetëm formalisht. "Është shumë larg, - thotë një menaxhere e një agjencie turistike. Ne kemi kërkesa nga turistë të huaj për ta vizituar, por i paralajmëromë për vështirësitë e rrugës dhe shpesh grupet turistike e anulojnë axhendën për Lurë, përveç atyre që pëlqejnë të ecin në këmbë. Jo vetëm kaq, - thotë ajo, - por rruga e keqe si nga Rrësheni, ashtu edhe nga Peshkopia, e bëjnë guidën turistike nga Lura shumë të vështirë për ta menaxhuar dhe me kosto të larta për vizitorët".

Një natë në Lurë, për grupet turistike me mbi 10 veta kushton afër 20 euro.

KUSH E SHKATËRROI LURËN?

Kjo ishte një pyetje më e shpeshtë e aktivistëve të 16 prillit. Kësaj pyetje i dha një përgjigje gazetari dhe aktivisti i çështjeve mjedisore, Xhemal Mato.

"Deputeti kur shkonte në Lurë për të kërkuar votat, ju thoshte banorëve: "Për të jetuar ju mund të prisni ndonjë dru nga pylli, se neve do e mbyllim një sy për të ndihmuar të varfrit". Sa u mor ky sinjal nga "biznesmenët", shkuan me vrap me plane të sakta "punësimi": " Çdo familje që nxjerr anash rrugës një kamion me lëndë drusore do të marrë 2000 lekë. Kryetari i



Me një rrugë të asfaltuar turistët do të shtohen dhe banorët do të kenë mundësi të tjera për të punuar dhe jetuar. Dhe atëherë njërën nga detyrat që do ta bëjnë pa pagesë dhe me shumë dashuri janë mbrojtja e pyjeve... Të atij pylli që rinia e sotme po mundohet ta ringjallë me shumë dashuri dhe sakrifica...

Lura akuzon

Prerja e pyjeve, zjarret, mungesa e rrugës dhe heqja e mundësisë së shfrytëzimit të turizmit është një krim, për të cilën të gjitha përgjegjësitë bien mbi qeveritë shqiptare të tranzicionit. Me mosveprimet e saj ajo ka ndihmuar në shkatërrimin e pasurisë sonë kombëtare.



Foto: © Bujar Karoshi

Komunës që të mbyllë një sy do të marrë 10.000 lekë. Policët në Rrëshen ku do të kalojmë në orën 12.00 të natës do të marrin nga 2000 lekë secili për kamion. Dy policët e tjerë në Milot në orën 13.00 të natës do të kenë 4000 lekë dhe në hyrje të Tiranës 5000 lekë. Me kaq fitimi na del rreth 25 mijë euro në sezon duke llogaritur dhe ndonjë lehtësim për politikanin".

"Mos më pyet mua, - më tha një banor i Lurës. - Shko e pyet në Tiranë se kush e shkatërroi Lurën. Pyet ministrin, pyet kryeministrin! Ata e dinë se kush e shkatërroi Lurën. Për mua, asnjë lurjan nuk e ka shkatërruar. Atë e ka ka shkatërruar Shteti!"

Hasan Hoti, i cili përveç punës si administrator i Lurës, ka në pronësi njërin nga dy hotelet që ka Lura, pranon se shkatërrimi i pyjeve është një masakër që i ka ndodhur këtij vendi. Ai pranon se qeveria shqiptare nuk ka bërë atë që duhet të bënte për ta ruajtur këtë bukuri natyrore. Ai tregon se në vitin 2004 ka qenë vetë që ka regjistruar me kamera ata që prisnin e shkatërronin pyjet, por megjithëse pamjet u transmetuan nga një televizion qendror, asnjë masë nuk u mor.

"Lura, - tregon Mehmet Metaj, një inxhinier pyjesh, - ka qenë një Park Kombëtar i mbrojtur dhe në vitin 2000 u përzgjodh nga IUCN – Unioni Botëror për Mbrojtjen e Natyrës - për t'u filmuar si parku më me vlera peizashistike dhe biodiversiteti në Europën Lindore, me pyjet dhe liqenet akullnajorë. Madje, thekson ai, për këtë qëllim, një ekip i televizionit nga Amsterdami bënë edhe xhirime në terren".

Por Lura e kishte marrë rrugën për shkatërrim. E ndodhur në mes te tre rretheve: Dibrës, Burrelit dhe Mirditës, ajo pati sulme me motosharra në pyjet e saj dhe nuk u mor asnjë masë për ndalimin e saj.

"Kur kjo histori filloi, - tregoi një banor, - në pamundësi për ta ndaluar, u gjend një mënyrë se si banorët e Lurës të kishin një mundësi për të jetuar".

"Lura qe shpallur dhe si 'zonë e rëndësisë së veçantë" nga Qeveria Meksi, në vitet 1995-1996, - tregon Mehmet Metaj. *"De jure"* ajo kishte edhe statusin që të mbrohet me ushtri, por kjo nuk ndodhi, - tregon ai. Sipas tij, ky vendim i Këshillit të Ministrave nuk është abroguar ende, ndaj nuk e dimë se pse qeveria Rama nuk e vë në zbatim për të ndihmuar kështu në rigjenerimin, së pari natyralisht të Lurës.

Inxhinieri i pyjeve Mehmet Metaj thotë se kjo gjendje katastrofike e Lurës është për faktin se tentativat për mbrojtjen e saj nga institucionet shtetërore-përgjegjëse, respektivisht nga Shërbimi Pyjor, nuk u shoqëruan dhe me masa subvencionuese sociale për mbijetesën e njerëzve që banonin atje, por iu mëshua vetëm mbrojtjes së parkut".

Nuk ka rrugë për në Lurë dhe me këtë mënyrë asaj i janë prerë mundësitë e shfrytëzimit të turizmit.

"Është shumë e dhimbshme, teksa po bënim rrugën nga Rrësheni për të mbërritur në park, të shohësh një babëzi të paparë për të shfrytëzuar çdo përrua, mijëra hektarë të dëmtuar e të djegur për të ndërtuar HEC-e, pas të cilave është trumbetuar Shqipëria si një superfuqi energjetike. Ndërkohë, ne kemi humbur atë që është më e rëndësishme, të ardhmen e fëmijëve tanë, të ardhmen e turizmit shqiptar, - thoshte dy vite më parë në Lurë, ministri aktual i Mjedisit, Lefter Koka.

"Do t'i rikthejmë Shqipërisë një nga zonat më të bukura turistike, do t'i rikthejmë krenarinë Lurës, për t'i garantuar një zhvillim ekonomik e turistik", - premtonte në qershor të vitit 2014 ministri Koka. Ai pati premtuar gjithashtu në atë kohë edhe mbjelljen e të paktën 2 milionë fidanëve dhe rehabilitimin e peizazheve rreth liqeneve. Por prej atëherë gjendja nuk ka ndryshuar. Një dokument i Ministrisë së Mjedisit i publikuar së fundmi thotë se në Lurë janë mbjellë 45 mijë pisha dhe janë harxhuar më shumë se 300 mijë euro. Një banor tha se aksioni vazhdoi, por pikërisht në zonën ku "gjasme u mbollën pishat", ra një zjarr... Dhe zjarri zhduku gjurmët e mbjelljes së pemëve. Përveç disa rrethimeve prej teli pranë ndonjë liqeni që rezistojnë akoma.

SI MUND TË RIGJALLËROHEN PYJET E LURËS?

Rigjallërimi i Lurës, jo vetëm pyjeve, por edhe rritja e turizmit, vjen së pari nga të rinjtë.

"Këta të rinj që kanë nisur të vijnë për të mbjellë pemë, po i rikthejnë Lurës dinjitetin", - thotë Hasan Hoti.

Albiona Muçoimaj thotë se ne synonim që të mbillnim rreth 3000 fidanë gjatë këtij viti, por me përkrahjen që kemi gjetur shpresojmë se numri i fidanëve të mbjellë do të kalojë mbi 5000 deri më 28 nëntor, kur fushata do të quhet e mbyllur zyrtarisht për këtë vit. Një aksion tjetër do të zhvillohet më 7 maj dhe një tjetër planifikohet në fund të muajit.

Por komentet e atyre që qëndrojnë gjithë kohës në rrjetet sociale dhe presin që Shqipëria të ndryshojë me komandë nga tastierat e smartfonëve, e kritikuan mbjelljen e pemëve. Ata shkruanin se nuk ishte kohë e përshtatshme për mbjelljen e tyre dhe se asnjëra prej tyre nuk do të zërë.

Albiona përgjigjet me të qeshur dhe thotë se "nuk e di nëse do të zënë apo jo, por ne jemi konsultuar me inxhinierin e pyjeve Imirjon Baleta, i cili na ka rekomanduar mbjelljen e pishës së zezë të moshës 2-vjeçare. Kjo për arsyen se gjatë këtij viti të tretë të rritjes, pisha e zezë do të ketë më shumë mundësi të përshtatet me klimën e Lurës".

Mehmet Metaj, inxhinier i pyjeve, thotë se ka dy rrugë për rigjallërimin e pyjeve të Lurës: së pari rruga natyrale, duke e ruajtur si zonë e rëndësisë së veçantë me ushtri dhe personel teknik-inspektoriat pyjor dhe së dyti përmes rimbjelljeve të llojeve autoktone të saj, arrnin, rrobullin, etj., pra, ripyllëzime me plan 5-vjeçar.

> "Ka dy rrugë për rigjallërimin e pyjeve të Lurës: së pari rruga natyrale, duke e ruajtur si zonë e rëndësisë së veçantë me ushtri dhe personel teknik-inspektoriat pyjor dhe së dyti përmes rimbjelljeve të llojeve autoktone të saj, arrnenin, rrobullin, etj., pra, ripyllëzime me plan 5-vjeçar".

Ai thekson se të dyja metodat, edhe me fidanë, edhe me hedhjen e farërave të atyre llojeve të vendit që mund t'ju gjenden farërat. Në Lurë, - thekson Metaj, - gjenden lloje shumë të rralla si arrni, kërleka, bile ka dhe ekzemplarë të rrallë si ai i një dushku që quhet *'Shurdhia' (Quercus crenata)* që gjendet vetëm aty.

Metaj kritikon mbjelljen e disa pishave të huaja, që është një shkelje e teknikave më elementare dhe pastaj atyre ekologjike. Këto lloje, të marra në Holandë apo andej-këtej, nuk shkojnë në arealin e Lurës. Ai thekson se duhet ndërtuar një fidanishte atje në vend, siç bëhet në këto raste dhe të prodhohen fidanë çdo vit. Për 5-vjet, sipas tij, në Lurë ripyllëzohen sipërfaqet e degraduara dhe të zhveshura të saj.

Metaj gjithashtu rekomandon marrjen e masave për ndalimin e dëmtimeve të mëtejshme, sidomos të zjarreve. "Duhet që Këshilli i Ministrave të nxjerrë një vendim për mbrojtjen e Lurës nga dëmtimi i mëtejshëm dhe zjarret si zonë e rëndësisë së veçantë dhe forcimi-shtimi i inspektoriatit pyjor me një ekip të veçantë në terren. Gjithashtu, ai thekson se është e domosdoshme përfshirja e komunitetit që të mos dëmtohet më tej, por ata të rikthehen për ta restauruar, duke duke i punësuar në fidanishten që duhet ngritur dhe në punimet ripyllëzimit me fidanë dhe farë".

Hasan Hoti thotë se që nga viti 2013 është ndaluar prerja e mëtejshme e pyjeve. Ai shikon një ndërhyrje emergjente të lufta kundër tenjës që ka kapur pishat rreth e rrotull Lurës.

Njësia administrative po merr masa për ruajtjen e fidanëve të mbjellë dhe krijimin e kushteve për t'i rikthyer sadopak bukuritë e Lurës.

Hoti mendon se më emergjente është pastrimi i pyjeve nga drurët e prerë dhe të rrëzuar. Ato janë një rrezik për zjarre, të cilat do t'i dëmtonin shumë filizat natyralë. Ai sjell si shembull zonën e Borie Lurë, ku pas pastrimit nga drurët e prerë është mbushur plot me fidanë dhe ka rritje të shpejtë të tyre.

***

Të rinjtë nga Tirana mbollën 500 pisha rreth Liqenit të Madh, rreth 8 km larg nga qendra e Lurës. Mes trungjeve të mëdha të prera filizat e rinj duan kohë të rriten, por megjithatë Lura është e bukur, mjaftueshëm për të thithur turistë vendas e të huaj. Lurës së bukur i mungon "dora e ngrohtë" e shtetit. Lurës i mungon rruga. Në qoftë se Lura do ta kishte një rrugë me pak asfalt, turizmi do të ishte një mundësi e madhe punësimi për banorët dhe atëherë kontrabandistët e drurit nuk do ta kishin kaq të lehtë realizimin e asaj masakre. Qeveritë e këtij vendi në gjithë këto vite postkomuniste janë mburrur se kanë shtruar mijëra kilometra rrugë rurale, por çuditërisht për Lurën nuk është kujtuar askush. Ndoshta është koha që Fondi Shqiptar i Zhvillimit t'i lërë mënjanë shtrimet në qendrat e qyteteve, qoftë edhe në qendër të Tiranës, dhe t'i rikthejë sytë nga kjo rrugë, pasi Lura nuk është vetëm e banorëve, por është një krenari shqiptare.

Me një rrugë të asfaltuar turistët do të shtohen dhe banorët do të kenë mundësi të tjera për të punuar dhe jetuar. Dhe atëherë njërën nga detyrat që do ta bëjnë pa pagesë dhe me shumë dashuri janë mbrojtja e pyjeve... Të atij pylli që rinia e sotme po mundohet ta ringjallë me shumë dashuri dhe sakrifica...

Rruga e Arbërit nr. 120

opinion



Eh, ç'më ktheve gjashtë dekada pas Lura ime !

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Saktë, gjashtëdhjetë e gjashtë vite pas...

Atëherë isha dhjetë vjeç, në klasën e tretë të shkollës fillore në katundin tim të lindjes, Brezhdanin e Dibrës.

Një ditë prilli na morën në rresht e me nga një shat në krah të rëndë për supet e një fëmije dhjetëvjeçar, kapërcyem kodrën e parë të Kubenit për tu ngjitur në të dytën. Kishin çelë gjethe manaferrat e kishin plasë sythat e fierit...

Na thanë të hapim gropa e të hidhnim në çdo gropë nga dy kokrra gështenja. Gropa u thënçin, furrik pule më mirë thuaj. Se gropat hapen me bel e pastrohen me lopatë. Shati është ndërtuar nga frëngu për të prashitë e për të tërheq ujin për të vaditë...

Gështenjat nuk mbinë. E si të mbinin kur edhe atë pak vlagë që kishte mbetur nga dimri e përcollëm në qiell? Fara do vlagë ashtu si mielli do ujë të bëhet brumë e të gatuhet bukë.

Mbase kaq dinin dhe kaq bënin...

Do kalonin vite, jo shumë, as edhe një dekadë...

Në Zdojan, në livadhet midis fshatrave të Vakufit, Brezhdanit e Rreth Kales, Livadhet e Frangut, siç quheshin çuditshëm, do të mbilleshin fidanët e parë të një lloj mbjellje tjetër. Fidanë mollësh, dardhash, kumbullash, arrash... me moshë 2-3 vjeçare e me kurorë të formuar. Do të mbilleshin në gropa një metër të thella, një metër të gjera e një metër të gjata. Në çdo gropë do të hidheshin një gjysmë koshi kali pleh organik, tek 25 kilogram. Për mbjellje do të përdoreshin beli, kazma, lopata dhe shati...

Pas Livadheve të Frangut u erdhi radha kodrave të Gjarajcës e Pasmarit. Më tej i erdhi radha Fushës së Kastriotit, kodrave të Ostushit e të Shumbatit. Kubeni i "gështenjave" do të shndërrohej në plantacionin më të bukur me kumbulla "Roza gjigande" e "Tropojane". Kodra e Kabe do të shndërrohej në plantacionin e veçantë, mbase ballkanik, me vishnje.

Ravnat e Grevës do të merrnin gjithë plehun organik të ndërmarrjes së grumbullimit dhe të ndonjë kooperative të afërt për ti dhënë jetë bllokut prej 70 hektarësh të vreshtave të para të organizuara në Dibër.

Më tej kodrat e Qenokut do të formonin një bllok frutor me mbi pesëdhjetë mijë rrënjë pemë frutore...kumbulla, mollë, arra, gështenja.

Së fundi fidanët e qershive dhe vishnjave e lajthive do të ngjiteshin në Kuplon, në 800-900 metra lartësi mbi nivelin e detit duke krijuar konvejerin më interesant bio (logjik) ku qershitë piqeshin në gusht kur të parat në Luginën e Drinit ishin pjekur në maj.

Të gjitha këto në gropa një herë një, herë një, me një gjysmë koshi pleh organik e kur erdhi koha edhe një kilogram superfosfat...

Të mbjellësh për të vjelë do punë dhe mend. Do mendjen e specialistit dhe krahun e lidhur fort pas punës të bujkut.

Me mbjelljen fillon puna. Për të arrirë tek korrja, vjelja e fryteve duhen vite. Vite ujitjeje për të përballuar thatësirën e verës, vite që do të kërkojnë të marrësh ujin e Drinit me gjyma (siç ndodhi në thatësirën e jashtëzakonshme të vitit 1962) që gjethi i gjelbër i pemës të mos bëhej kafe, të mos thahej. Vite me krasitje formuese e prodhuese, punim toke e prashitje, luftim sëmundjesh e dëmtuesish.

Fruti mbi pjatë, mollë, dardhë, portokall, ulli, rrush... ka në përbërje një lëndë të padukshme, vitaminën e punës së njeriut...

Tërë këtë rrjedhë agronomike nuk do ta kisha bërë sikur të mos më ngacmonte një miku im gazetar që së bashku me të shoqen la Tiranën për të mbjell "pesë fidanë pishe" në "shkretëtirën e kohës sonë, Parkun Kombëtar të Liqeneve të Lurës".

Mbi Lurën e braktisur nga lurasit.

Mbi Lurën e shfrytëzuar deri në palcën e pishave shekullore, arnenin e mrekullueshëm të një masivi pyjor më të bukurin e vendit.

Mbi Lurën e prerë nga sëpata së cilës i dha bisht të gjatë shteti në këto njëzet e pesë vjet rrënimesh, shkatërrimesh, prerjesh e shkuljesh masive.

Miku im me siguri në gazetën "Rruga e Arbërit" do të bëjë një reportazh ashtu siç bëri në numrin e marsit për Selanen, fshatin që do ta mbysë "Qeveria e Katundit të Ri", për ti dhënë "dritë parash në xhep" dreqi e di se kujt.

Do të shkruajë për fidanët e pishave sukulluar me një dorë dheu në një qeskë plastmase. Do të shkruaj edhe për dhjetëra vullnetarë që lanë Tiranën dhe me "shatë në dorë" rrëmihën tokën e zezë formuar nga kalbja e gjetheve shekullore, hapën nga një "furrik thëllëze" dhe mbuluan fidanin një pëllëmbë mbi tokë.

Nuk e di në se do të shkruajë se nga erdhën këto fidanë dhe në se nga ana biologjike ishin të njëjtë me fidanët që dalin nga farat e pishave të Lurës. Se në biologjinë e bimëve ka një lloj procesi që quhet "procesi i aklimatizimit", i përshtatjes së farës apo fidanit me kushtet klimatike e tokësore të vendit ku mbillet. Po qe se fidanët janë mbjellë në ndonjë fidanishte në bregdet dhe kanë fara të pishave bregdetare, lëshoju dushke, siç thuhet në Dibër...

E vlerësoj hapin e shoqërisë civile që kërkon ta kthejë Lurën dhe pyjet e saj siç kanë qenë, por nuk e vlerësoj me asnjë pikë (zero) nismën e Ministrisë së Mjedisit, nismë e cila më ngjan njëqind për qind me atë të fëmijërisë time tek mbillnim gështenja për tu...tharë.

Fidani është si fëmija i porsalindur.

Me një ndryshim.

Fëmija me duart grusht qan, e thërret. Me thirrmën e tij ai kërkon qumësht nga gjiri i nënës, kërkon të jetojë e të rritet.

Fidani i pishës i sapo mbjellë në Lurë as qan, as thërret, as bërtet.

Vullnetarët më gëzimin që mbollën disa fidanë pishash kthehen në shtëpitë e tyre për tu treguar shokëve, prindërve, të afërmeve gëzimin se mbollën "dhjetë fidanë pishe".

Fidani, nën diellin e këtyre ditëve të nxehta prilli, do ta thithë shpejt lagështirën.

Askush nuk do të kujdeset për të.

Maji, korriku dhe gushti do ta shndërrojnë në një piketë kafe në "folenë e thëllëzës".

Sikur kjo punë të ishte bërë në tetor apo në nëntor, para se të binte dëborë, mbase lagështia e mbledhur në gropë do ta ushqente fidanin për të përballuar thatësirën e pranverë-verës.

Mbase...

Udhëtova nëpër dhjetëra dekada të jetës sime.

Mes gëzimesh dhe trishtimesh...

Ma bëri Lura ime që e dua aq sa dua mrekulli të tjera të pyjeve të Dibrës shkatërruar rrënjësh që asnjë moratorium, qoftë edhe shekullor, nuk i kthen në jetë.

19 prill 2016

Rinia që mbolli fidanë pishash në shkretëtirën artificiale më të renë në botë në Parkun Kombëtar të Lurës e dha shembullin, e tregoi forcën e saj, i shprehu energjitë mendore e fizike, si dhe i hapi dyert një shkolle të re, ku të gjithë ne shqiptarët duhet të mësojmë e t'u shëmbëllejmë.

Rinimi i shkretëtirës Lurjane

Nga ***Dr.*** **SELMAN MEZIU**

Nuk mund të hesht. Nuk mund të frenoj emocionet. Pompeu nuk shpërtheu vullkanzjarr në kreshtat e Nezhdës së Lurës. Ato ashtu të murrme e thepa-thepa kanë mbijetuar në mijëvjeçarët. Ndërsa shpatet, luginat, kurrizet e stërzgjatura dhe shtatë sytë e kaltër si margaritarë, kanë shkëlqyer në mes gjelbërimit pishnajash e ahesh. Arkitektura relieve ndryshëm, ngjyrë tërheqëse me të gjelbërtën e errët me rrënjë në atë tokë gurishtore është mbajtur gjallë e ka fabrikuar gjethe e drurë përkrah gjerdanëve të shekujve. Muzika e pyllit në katëzimet e shekujve është ndigjue duke të mahnitur. Popullata e kafshëve e shpendëve, gjallëri ka sjell e bukuri emocionuese ka përcjell. Por...

Kur ju shikoj juve të rinj e juve o njerëz të mirë në këto peizazhe të zymta, më dhimbseni. Sepse iu revolton e iu zemëron mjedisi rrënqethës. Me trupat e shtrira përdhe të zituara nga gjuhët e flakëve. Në mes trungjeve të shumtë të torturuar, të zvenitur, të tharë. Të pa jetë. Të vdekur e të pavarrosur. Bëj pyetjen: Ku shkoi pjesa e trupit tuaj dru pylli shekullor? Shumica e dimë. Atë e grabitën. Ato, huliganët me kallashnikov. Ata të pashpirtët. Grabitësit e pasurisë së gjelbërt. Ata e dogjën për të fshehur krimin. Ata e shitën trupin tim, për t'u pasuruar sikur thonë mbetjet e tyre. E mua më vegjetojnë dhjetëra pyetje. Po ku isha unë? Ku ishte pylltari me veshje e shpirt të gjelbërt? Ku ishe ti lurjan bashkatdhetar e mëmëdhetar i tyre? Ku ishe ti kryeministër? Po ti mor president, ku i kishe sytë, po trutë a i kishe? Si nuk i ndaluat? Si nuk i shpëtuat? Si nuk u zgjoi ulërima e motosharrave, zhurmat therëse të skodave të... Por mjerisht, fatkeqësisht, marrëzisht e për të vënë kujën. Shteti ishte kthyer në kufomë. Ai ishte shndërruar në çerdhe banditësh e kriminelësh. Ato që përbënin atë, veç grindeshin, shaheshin, bërtisnin. Kush të grabisë, vjedhë, masakrojë natyrën. Ato prodhuan kriminelë, gangsterë, maskarenj, mjerim, varfërim të popullit, zhuritje të natyrës.

Tek iu shoh me pisha në duar. Shoh rreze drite. Ndjej vegime shprese. Ergysi, fëmija lurjan tek vë fidanin e pishës, mendon të rritet bashkë me të. Fidanët dhe ai në mes gurëve, barit, të ftohtit, borës, vapës përvëluese kërkojnë të mbijetojnë. Ai është i pafajshëm. Ai nuk e ka parë Lurën nuse. Ai nuk ka dëgjuar për gjelin e egër, as për ariun. Ai nuk e din se kush ishte doktori i pyllit. Por ai bashkë me këto të rinj shikon të ardhmen me pisha, arnena, rrobulla dhe ahe kurorëgjelbërt. Te natyra këto gjejnë shërim mirëqenie, kulturë. Ai dëshiron e dha shembullin për një Lurë që mund e duhet lulëzuar. Por kështu e duan, dëshirojnë, kontribuojnë, rinia kryeqytetase, lurjanët, dibranët. Kështu dëshiron me gjithë zemër çifti i gazetarëve Karoshi, gazetari emigrant Milloshi dhe dibranit Kërkuti që edhe pse shikon grataçelat e Nju Jorkut, tiktaket e zemrës e mëndja i fluturojnë në peizazhet e rrënuara të zymtuara të Kurorës së Lurës.

Të qeshur. Me fidanë nëpër duar. Kështu së bashku iu ngjitën monopateve të zhveshura. U djersitën. U lodhën. Por këto treqind pjesëmarrës ishin si treqind nuset e Lurës. Me ndryshim jo me luftue me armë kundër turqve, por me mbjell jetë. Me projektue të ardhmen. Fidanët janë të vegjël. Me pak bukë dheu. Me gropa të hapur nga këto të rinj. Ato do të rriten. Ato do të zbukurojnë natyrën. Brezat do t'i bekojnë. E këto të rinj me prush energjish në gji krenohen. Se do të zhdukin këto pamje rrënqethëse shkaktuar nga hitlerianët e natyrës. Ato pisha të vogla, shpresëdhuruese, shumica kanë emra si të vogëlushëve: Lurës, Ajlës, Deas, Klovisit, Kristit... Kur të rriten emrin do ta kenë të pagëzuar që padyshim do të përcillet brez pas brezi.

Peizazhi pranë liqenit të Madh u rinua. Shpatet përreth ndjen trokëllimat e kazmave. Zërat e të rinjve. Këngët e vogëlushëve. Urimet e lurjanëve. Përgëzimet e shqiptarëve. Fidanët e pishave të vockla gjetën dheun e tyre. Gjetën vendrritjen e vendjetesën këtu buzë liqenit ujëkaltër. Ndërsa ky gjest homerik i kohëve moderne do t'iu japë shumë brezave të sotëm e të nesërm. Gazetar të televizioneve, bashkohuni me ta. Me gjuhën tuaj, me filmimet tuaja ndihmoni dhe inkurajoni rininë të ripërtërijë natyrën. Të dashurojë atdheun, vetveten e të respektojë mjedisin rrethues.

Juve gazetar e kryeredaktorë gazetash, ju lini disa kolona këtyre veprimeve, iniciativave të guximshme. Ju shprehuni me fjalë, fjali për t'i shërbyer rimëkëmbjes së këtij populli, të gjelbërimit të natyrës. Ka nevoje rinia që të shohë ish pyjet madhështore të Bizës, Stravajt, Munellës, Shelegurit, Nika Mërturit, Rajcës etj., të ripërtëritura, të rifitojnë funksionet bioekologjike e peisazhistike. Ndërsa ju inxhinierë e teknikë pyjesh shkundni stepjen, përzijeni frikën, ndihmoni rininë. Punoni e bashkëpunoni me ta. Ata janë në gjendje të bëjnë çudira. Të mbrojnë nga shkatërrimi bukuritë e Vjosës e Valbonës, të Drinit e Shkumbinit, që politikanët e sotëm kanë përgatitur varrosjen e tyre.

Rinia kryeqytetase po kalon muajin në grevë për mbrojtjen e bunkerizimit të parkut të Tiranës. Disa heshtin. Disa spekullojnë. Politikanët e deputetët shahen e zihen me grushta në parlament. Ndërsa parku i Lurës, i Valbonës, parku i gjelbërt i Tiranës, natyra shqiptare ende është nën oreksin e politikanëve me shpirt kulture, edukate betonizimesh, hekurizimesh e dhunimesh të bukurive natyrore. Prandaj të shtojmë radhët e ushtrisë të të gjelbërve.

Nga lartësitë e Kunorës së Lurës vjen ushtima kushtruese e rinisë shqiptare: Të mbjellim fidanë pyjore, drurë frutorë, lule shumëngjyrëshe ne topojansit, borovasit, shllakasit, ostrenasit, rajcasit, përmetarë, zagoritë, voskopojanë, vlonjatë, sarandiotë, kuksianë, pukjanë, shkodranë. Kështu zbukurojmë vendin. Shpëtojmë nga sëmundjet dhe helmimet.

Gjithashtu, shembulli i këtyre të rinjve iu errësojnë sytë, u ngrenë nervat, i egërsojnë politikanët e këtij vendi. Sepse e gjelbërta atyre iu verbon sytë e iu ndal fitimet e pallogaritshme. Pikërisht të gjithë duhet të bashkohemi për të ruajtur natyrën, për të zbukuruar natyrën duke mbjellë pisha, duglazin, radiatën, akacjen, ekualptet, plepat pse jo të ndjekim ecurinë e paulonias.

Rinia që mbolli fidanë pishash në shkretëtirën artificiale më të renë në botë në Parkun Kombëtar të Lurës e dha shembullin, e tregoi forcën e saj, i shprehu energjitë mendore e fizike, si dhe i hapi dyert një shkolle të re, ku të gjithë ne shqiptarët duhet të mësojmë e t'u shëmbëllejmë.

aktualitet

Rinia që mbolli fidanë pishash në shkretëtirën artificiale më të renë në botë në Parkun Kombëtar të Lurës e dha shembullin, e tregoi forcën e saj, i shprehu energjitë mendore e fizike, si dhe i hapi dyert një shkolle të re, ku të gjithë ne shqiptarët duhet të mësojmë e t'u shëmbëllejmë.

Kush e shkatërroi Lurën?



Nga **XHEMAL MATO**

Kush e shoi parkun e madh të Lurës, të bukurën e dheut? Banorët e Lurës, drejtuesit e këtyre komunave, biznesmenët e ndërtimit apo politikanet? Kësaj pyetjeje i përgjigjen kështu ata që kanë ngelë në Lurë: "Lurën e shkatërroi SISTEMI". Me këtë ata nuk e kanë fjalën për sistemin demokratik, por për një lidhje të fuqishme që u krijua dhe veproi brenda tij. Një sistem njerëzish dhe forcash që e pushtoi vendin tonë.

Në këtë sistem janë sistemuar politikanët, p.sh deputeti i Lurës, që, kur shkonte në Lurë për të kërkuar votat, ju thoshte banorëve: "Për të jetuar ju mund të prisni ndonjë dru nga pylli, se neve do e mbyllim një sy për të ndihmuar të varfërit". Sa u mor ky sinjal nga "biznesmenët" , shkuan me vrap me plane të sakta "punësimi": "Çdo familje që nxjerr anash rrugës një kamion me lëndë drusore do të marrë 2000 lekë. Kryetari i komunës që të mbyll një sy do të marrë 10.000 lekë. Policët në Rrëshen ku do të kalojmë në orën 12.00 të natës do të marrin nga 2000 lekë secili për kamion. Dy policët e tjerë në Milot në orën 13.00 të natës do të kenë 4000 lekë dhe në hyrje të Tiranës 5000 lekë. Me kaq fitimi na del rreth 25 mijë EU në sezon, duke llogaritur dhe ndonjë lehtësim për politikanin". Pra, të gjithë aktorët e këtij sistemi fitonin.

Ky sistem funksionoi me sukses pa u thyer dot as nga ligji as nga ndonjë idealist apo njeri i ndershëm. Ai lulëzoi brenda sistemit demokratik si kanceri brenda një njeriu me pamje optimiste .

Kështu, brenda 15 vjetësh gjithë pasuria e pamatë e Lurës u kthye në lekë, lekët u kthyen ne vila dhe shtëpi banimi ne periferi te e Lurës dhe Tiranes." SISTEMI ynë shfarosës" vërtet prodhoi vila dhe shtëpi për disa, por për shumicën vazhdoi përsëri me papunësi dhe varfëri. Parku u rrop pothuajse i tëri dhe shumë banorë të zonës emigruan në Tiranë dhe pastaj prej këtej, emigruan në Evropë. Lura ngeli këtu, e prerë, e djegur dhe e venitur deri në rrezik vdekje. "Lura nuk bëhet më" - thanë disa ekspertë të Ministrisë dhe të Komisionit Europian në një takim për parqet në Tiranë. Kështu e hoqën nga regjistri i të gjallëve, i ndërprenë fondet dhe e lanë të vetmuar aty larg, pa dashuri, pa vëmendje, pa rrugë, pa vizitorë.

Por ja qe doli një brez i ri qytetarësh që ktheu vëmendjen nga Lura. "Ejani të mbjellim në Lurë! Të gjithë për Lurën!" thirrje që ngjasonte me atë të Vaso Pashës (Kujt i ban zemra m'e e lan' me dekë, / Këtë farë trimneshe, qi sot asht mekë?.).

Brenda 2 javësh në rrjetet sociale dolën me qindra vullnetarë, që dhanë lekë për të blerë fidanë, dolën disa kompani që sponsorizuan aksionin dhe mijëra njerëz që e përshëndetën.

Lura kërkon përkujdesje për të mos u keqësuar më tej dhe për shërim të shpejtë. A do ta bëjë këtë qeveria apo do ia lërë në dorë këtyre qytetarëve vullnetarë?

Politikanët, të habitur po shihnin këta "të çmendur" që akuzonin pa fjalë, por thjesht duke mbjellë fidanë edhe në fund të sezonit. Dhe ndërkohë që të tjerët duartrokisnin, ata u fshehën si pjesëmarrës në krim.

Lurën mund ta rregullojë SISTEMI

Një ekspert pyjesh tha në takim: "Lura e merr veten, boll që të lihet e qetë, të mbrohet"

Vërtet që natyra po qe se ruhet nga shfrytëzimi barbar i njeriut e merr veten. Por kur plagët e saj janë të rënda, kjo mund të kërkojë shumë vite, p.sh 100 vjet. Dhe Lura ka shumë plagë të tilla, sepse në shumë hapësira të saj, kanë rënë shpesh zjarre që e kanë shkretuar dhe vështirësuar ringjalljen e shpejtë të saj. Këto zjarre ndodhin çdo vit. Mënyra barbare e shfrytëzimit, duke marrë vetëm trungun dhe duke lënë degët e pemëve, e ka bërë rrezikun e zjarrit të vazhdueshëm. Parku i Lurës është i mbushur me lëndë drusore të tilla, të braktisura dhe duket si të jetë goditur nga një kometë. Pra, Lura kërkon përkujdesje për të mos u keqësuar më tej dhe për shërim të shpejtë.

A do ta bëjë këtë qeveria apo do ia lërë në dorë këtyre qytetarëve vullnetarë?

Lura ka rrugë vetëm për kamionët e druve, pra, vetëm për ata që e vjedhin atë. Rruga nga Rrësheni në Lurë është njësoj si rrugët e shfrytëzimit të pyjeve, me gropa, me gurë, ku mund të kalojnë vetëm makinat e mëdha të shfrytëzimit të pyjeve. Makinat vetura të policisë apo inspektorëve të pyjeve, që të kontrollojnë Lurën duhet të mendohen 10 herë për ta bërë këtë rrugë. Po kështu dhe qytetarët apo turistët që duan të vizitojnë Lurën dhe të sjellin një tjetër lloj zhvillimi kundrejt vjedhjes së pyjeve.

Por a do të shkëpusë qeveria disa fonde nga rrugët e jugut për të asfaltuar vetëm 40 km deri në Lurë apo do ua lërë dhe këtë vullnetarëve?

Lura rilind nëpërmjet turizmit. Shembulli i zonës së Thethit e vërtetoi shumë mirë këtë. A do ketë programe për nxitjen dhe zhvillimin e këtij turizmi apo ajo do të ngelet me turizmin e vullnetarëve që në 2 ditët e fundit e gjallëruan Lurën, aq sa s'kishte ndodhur ndonjëherë?

Ky pra do të ishte "SISTEMI" i ri që do ta ringjallte Lurën dhe njerëzit pastaj do të thonë "Lurën e rilindi SISTEMI!"

(ecovolis.al)

Lura, perla që kërkon të rilindë

Nga **MARIN MEMA**

Lura është një nga mrekullitë natyrore të Shqipërisë, ndaj së cilës tranzicioni tentoi disa atentate ekologjike. Por ajo i mbijetoi shkatërrimit dhe sot, moratoriumi i pyjeve i ka dhënë mundësinë e ringritjes. Megjithatë, problemet që ka kjo perlë e natyrës dhe turizmit nuk zgjidhen dot brenda një nate.

Ndryshe nga një pjesë e madhe e Shqipërisë, që prej javësh po kalon një klimë të butë e të ngrohtë, Lura mahnit me realitetin e saj. Të shkosh deri në zonën e liqeneve është e pamundur. Rruga vazhdon të jetë e bllokuar nga dëbora.

Por bora nuk fsheh dot gjurmët e krimit. Bilanci zyrtar i dëmeve? Nga mëse 1.049 hektarë, që dikur llogaritej si sipërfaqe pyjore, mëse 40 për qind është prerë, dëmtuar apo djegur.

"Kjo pasojë ka ardhur nga shumë faktorë. Në fakt edhe lurasit vet e kanë dëmtuar, por edhe mbrojtja e këtyre nuk ka qenë nga lurasit. Ka qenë nga njerëz të ardhur, që nuk e çanin shumë kokën se çfarë bëhet në Lurë", thotë Nebi Hoti.

Shkatërrimi i ekosistemit është ndierë edhe te liqenet akullnajore, që përbëjnë ndoshta pjesën më të veçantë të këtij parku. Ata zënë mëse 26.6 hektarë të hapësirës së përgjithshme të tij. Duket një histori e largët, koha kur këtu lëvizte gjitari më i madh në vend: ariu i murrmë; ashtu sikurse rrëqebulli, zardafi, kaprollët apo sorkadhet, e po ashtu gjeli i egër. Të gjitha kanë qenë specie që jetonin në numër të konsiderueshëm në Lurë, e që sot janë zhdukur.

Por, tashmë jo gjithçka është gri. Mes trungjeve të prerë ka jetë, ose më mirë ajo po përpiqet të rilindë mes shkatërrimit. Janë ende gjurmë të vogla, por që tregojnë dëshirën e natyrës për të rimarrë frymë, për të shëruar e mbyllur plagët, duke i dhënë këtij vendi shpresë për rikthimin e fytyrës së dikurshme.

"Pemët e reja kanë filluar atje poshtë, po bëhen shumë dhe kanë filluar të rriten. Për 10 vite ato bëhen pyll, në të cilin s'futesh dot me lehtësi. Ne këtë duam prej shtetit dhe prej lurasit tonë, që të bëhemi të gjithë e të mos lejojmë që të prishet mali", thotë Gani Bruci.

Moratoriumi i pyjeve i ka dhënë një mundësi jete Parkut Kombëtar, që ka nisur - edhe pse në fazat fillestare, - një rigjenerim të tijin. Shpërndarja e natyrshme e farave ka nisur të japë disa rezultate sado të vogla. Kjo ka kthyer buzëqeshjen edhe te banorët.

"Kur shikojmë filizat që po dalin dhe është duke u ripërtërië, ne gëzohemi dhe kemi shpresë, rritet shpresa përditë", thotë Nazmi Skana.

"Ishte shumë i nevojshëm dhe i domosdoshëm moratoriumi i pyjeve, gjë që ka ndikuar menjëherë. Me këtë moratorium do të ecë puna shumë mirë, pasi nuk ka prerje dhe nuk mund të ketë më prerje", thotë Imer Mena.

Në ato pjesë ku situata është më e vështirë, ripyllëzimi është ndihmuar edhe me fidanë të rinj. Procesi, në mbështetje të atij tërësisht natyror, parashikon mbjelljen e mëse dy milionë të tillëve në zona të ndryshme të Parkut Kombëtar.

"Shteti shqiptar ka investuar në këtë drejtim. Ky është projekti i parë, teksa është investuar në një sipërfaqe prej 20.6 hektarësh me lloje të ndryshme halorësh, siç është pisha e zezë, ardeni, hartina, që janë mbjellur. Kemi mbjellë 45.860 fidanë gjithsej", thotë Mehdi Shtrezi, specialist i zonës së mbrojtur.

Sigurisht që është herët të flasësh për rikthimin e Lurës në gjendjen fillestare, sepse për 25 vite janë prerë pemë me moshë qindravjeçare. Megjithatë, specialistët mendojnë se në stadin aktual, duke e ndihmuar parkun në forma të ndryshme, gjërat mund të ndryshojnë, edhe pse ndryshimi do të ndihet pas shumë kohësh.

"Për ta ndihmuar pak filezerinë, ne si specialistë mendojmë që në vendet ku ka shumë mbeturina, ato duhet të hiqen dhe ndoshta një gërvishtje duke hedhur farë. Kjo sepse, krahasuar me pyllëzimin me fidanë, pyllëzimi me farë është më i leverdisshëm. Normalisht kjo është e mbuluar me halorë dhe një i tillë për të arritur në moshën madhore i duhen rreth 100 vite. Por instalimi i filezerisë mund të bëhet në një periudhë më të shpejtë 20-30 vjeçare dhe me qëllimin për zonat e mbrojtura. Pra për krijimin e një imazhi besojmë se, për 20-30 vite, Lura krijon tamam pamjen e një parku të vërtetë", thotë Shkëlqim Hasa, shef i monitorimit në zonat e mbrojtura, Dibër.

Lura është një mundësi jo thjesht për rreth 1.500 banorët që jetojnë gjatë gjithë vitit në këtë fshat të vjetër, por edhe për të gjithë ekonominë e zonës përreth, e më gjerë. Ka mjaftueshëm vende historike e arkeologjike, kulturore e tradicionale, sa të konsiderohet si një nga perlat e Ballkanit, siç e cilësonte Edith Durham, por dhe rilindasit tanë.

"Kush do të shikojë Shqipërinë, duhet të vijë të shikojë Lurën", thoshte dikur At Gjergj Fishta, duke e lidhur me bukuritë që kishte ky vend. E në fakt, fati i Lurës ka ecur gjithmonë paralel me atë të Shqipërisë. Edhe sot, të dyja po kërkojnë të ringrihen.

(Top Channel/ Shqipëria tjetër")

Rruga e Arbërit nr. 120

opinione

O sa mirë me qenë dibran…



Segment i Rrugës së Arbrit në luginën e Planit të Bardhë. Foto e vitit 2016, e njëjtë që nga viti 2011.

Nga **PËRPARIM SPAHIU,**
Deputet i Qarkut të Dibrës

Me qenë dibran, edhe jo fort i mencur, kupton se fushata elektorale për Zgjedhjet 2017, tashmë ka nisur. Pavarësisht rrugës së vështirë dhe të gjatë për të mbërritur deri atje, shumë politikanë, jashtë dhe brenda Kuvendit, nuk po pyesin më as për makina, dhe as për karburant. Me qenë dibran, qoftë edhe për një ditë, tashmë që po vjen fushata, ia vlen barra qeranë. Mjafton që t'u përmendësh njerëzve, kudo ku ajo duhet të kalonte, Rrugën e Arbrit…

Por me qenë dibran, pas gati dy dekadash premtimesh, zor se të beson njeri. Madje as unë që kam "gënjyer" veten një herë, kur garoja për deputet në zgjedhjet e kaluara parlamentare, nuk më takon të mashtrohem më. Rruga e Dibrës (jo kjo e Tiranës) vazhdon të jetë po ajo, sikurse politikanët e të gjitha ngjyrave, që një herë në katër vite, detyrohen të bëhen dibranë për një ditë. Duke premtuar pa u lodhur dhe deri në turp, po Rrugën e Arbrit…Disa nga ne, sikurse edhe kolegu im i PBDIU-së dje, nuk kemi asnjë faj për "gënjeshtrat" e vjetra, por hir të atyre që janë thënë deri tani, nuk na takon të premtojmë më!

O sa mirë me qenë dibran…me qenë e vërtetë, duhet të bëhet e vërtetë, sëbashku me Rrugën e Arbrit. Sa pa filluar mirë fushata, të paktën Ne deputetëve të Kuvendit, na takon të kërkojmë urgjentisht realizimin e saj. Këtë herë me një rezolutë të përbashkët, të gjitha forcat politike, të vendosim ndërtimin e saj, me të gjitha sforcot financiare, llojet e koncensioneve apo partneritetit me privatët. Rruga e Arbrit kushton shumë më shumë, e pandërtuar. Pa folur për kostot morale, që prej dy dekadash vazhdojnë të njollosin të gjithë klasën politike shqiptare. Rruga e Arbrit është gënjeshtra më e madhe e tranzicionit shqiptar dhe banorët e Matit, Bulqizës e Dibrës, meritojnë premtime të tjera në 2017-ën. Kush është dibran dhe prej andej nga kalon Rruga e Arbrit, nuk na beson më. Sa pa nisur mirë fushata, të votojmë në Kuvend ndërtimin e saj. Pastaj ka vend për të gjithë për të bërtitur me gishta në vesh: "O sa mirë me qenë dibran!"

Dhe Rruga e Arbrit duhet bërë…

Nga **SHPËTIM IDRIZI**

Miku im Përparim Spahiu, deputet i Dibrës, nisur nga takimi i PDIU-së me anëtarësinë e saj në Peshkopi, bëri një reagim që sipas meje kishte shënjestrën e gabuar. Ai kujtoi premtimet e pambajtura të politikës shqiptare e të deputetëve të Dibrës për ndërtimin e Rrugës së Arbërit në këto 20 vjet. Madje, përfshihu dhe veten, meqë dikur e kishte premtuar këtë rrugë. I nderuar koleg, unë kam përshtypjen se je nisur nga fakti që ke parë dibranët e shumtë që ishin në Pallatin e Sportit dhe nuk je përqendruar tek ajo që unë deklarova për Rrugën e Arbërit. Po si ty kritikova ata që e kanë premtuar në çdo fushatë në 20 vjet e akoma nuk dimë, kur do bëhet. Ajo që unë premtova është që duhet të bëjmë gjithçka për ndërtimin e asaj rruge, ndaj paralajmërova një interpelancë së shpejti me qeverinë shqiptare për të kuptuar më mirë se ku ka mbetur premtimi i dy dhjetë vjeçarëve të politikës shqiptare dhe se si mund të lobojmë më mirë për të bërë të mundur ndërtimin e kësaj rruge, sepse ti e di mirë që tash e shtatë vjet PDIU nuk ka qenë kurrë në poste qeveritare apo të ketë mundësi numrash t'i imponohet qeverisë. Por, kjo s'na pendon të bëjmë gjithsa mundemi për të lobuar, ngritur zërin, ushtruar presion që kjo rrugë të bëhet. Ajo që ka më shumë rëndësi koleg është fakti që premtimet elektorale s'kanë më vlerë në Dibër, por gjithsesi ajo rrugë do bërë jo thjesht për të mbajtur një premtim elektoral e ca vota më shumë, por si një rrugë e rëndësishme në strategjinë tonë kombëtare për fuqizimin ekonomik të Shqipërisë për bashkimin e asaj zone si gjymtyrë e rëndësishme që do të bashkonte çerekun e vendit tonë me pjesën tjetër të saj. Nga Tirana ku rrinë dhe deputetët e Dibrës e ku stigmatizohen me shprehjen "O sa mirë me qenë Dibranë" duhen katër orë me arrit në Peshkopi në një udhë shumë të vështirë për mileniumin e ri. Megjithatë është një zonë e pasur me njerëz punëtor e ku me krenari të thonin se në këtë stinë të vitit të tërë njerëzit janë në punë e s'ka asnjë ngastër të pa punuar e të pa mbjellë. Ata janë totalisht jashtë tregjeve tona bujqësorë e prodhimet e tyre si fushës sit ë pemëve frutorë kalben, sepse nuk arrijnë dot të grumbullohen apo të mbërrijnë në Tiranë a Portin e Durrësit për eksport, prandaj ajo rrugë duhet ndërtuar me patjetër për ta lidhur zonën e Dibrës me pjesën tjetër të vendit. Ndaj, kur fola për strategji kombëtare ne kemi detyrim kushtetues të kujdesemi për bashkëkombasit tanë kudo që janë. Kjo rrugë do të lidhte me aktivitet ekonomik Dibrën e Shqipërinë me të gjithë zonat shqiptare në Maqedoni, pasi edhe ata si ne kanë nevojë për integrim e tregje për produktet e tyre. Prandaj, ajo rrugë duhet ndërtuar patjetër. Ajo është e rëndësishme si rrugë strategjike e zhvillimit kombëtar dhe më gjerë dhe si e tillë duhet bërë. Ajo nuk është rruga e dibranëve dhe atyre që kanë marrë votat për 20 vjet. Ajo është rruga e gjithë shqiptarëve, të cilët duan një atdhe më të integruar e me ekonomi të zhvilluar. Prandaj, dhe një herë koleg duhet hequr dorë nga premtimet boshe e për vota, megjithë respektin që nuk ju shmange as përgjegjësisë personale. Por, nuk duhet hequr dorë kurrsesi nga gjetja e udhëve, mundësive e formave për ndërtimin e Rrugës së Arbërit me rëndësi kombëtare dhe më gjerë.

Fejton

Jalla lema me këta deputet që kena

Thërret nga "Qielli i Shtatë" Ferrë Doka - Mesele me deputetë që zgjohen në mbrëmje dhe flenë në mëngjes

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Dy deputetë, një vendas dhe një kryetar partie, i ardhur për të parën herë në Dibër, dy ditë njeri pas tjetrit, zbuluan "Rrugën e Arbrit".

Eureka!

Arkimedi i fjalës dhe i veprës së artë; fizikan, inxhinier, astronom, filozof , matematikani më i madh i lashtësisë (287-212 para Krishtit) i njohur për zbulimin e famshëm "të dendësisë dhe pluskimit" ndërsa lahej në banjë, dhe për daljen lakuriq rrugëve duke bërtitur me të madhe… *Eureka*, (Εύρηκα) , *(E gjeta),* njeriu që kërkoi një pikë për të mbështetur levën për të rrotulluar botën, njeriu i cili hijes së shpatës të ushtarit romak mbi kokë iu përgjigj… "Μη μου τους κύκλους τάραττέ" (Mos mi trazo rrathët)… do tua kishte zili…

"Lakuriq" duke bërtitur "EUREKA!" doli të hënën në një gazetë të shkruar një "deputet i Dibrës" duke thirre në mënyrë sportive:

"Oh sa mirë me qenë dibran"!

Deputeti i LSI, tre vjen nw pushtet me Ramën, habiti kush e lexoi dhe kush e dëgjoi.

Doli në aksham për të bërë atë që duhej ta kishte bërë në mëngjes,

u ngrit publikisht mbi "shtizën e hedhjes së larti" dhe foli për "Rrugën e Arbrit!".

Me siguri pa leje të kryetarit të partisë e të grupit kuvendar…

"Jalla lema!" do të thoshte Ferrë Doka…

Deputeti, duke u futur me not që tani në fushatën për zgjedhjet kuvendare 14 muaj më vonë, pasi sulmon kolegët e vet që këto ditë shkuan "të ngjyejnë penën në bojën e fëndulave të Dibrës" i kthehet Rrugës së Arbrit.

"Me qenë dibran, thotë deputeti, zor se të beson njeri. Madje, as unë që kam "gënjyer" veten njëherë, kur garoja për deputet në zgjedhjet e kaluara parlamentare, nuk më takon të mashtrohem më. Rruga e Dibrës (jo kjo e Tiranës) vazhdon të jetë po ajo, sikurse politikanët e të gjitha ngjyrave, që një herë në katër vite detyrohen të bëhen dibranë për një ditë…duke premtuar pa u lodhur dhe deri në turp, po Rrugën e Arbrit…"

Eureka!…

Deputeti, tre vite rresht i "rilindjes", vijon justifikimin se "nuk kemi asnjë faj për "gënjeshtrat" e vjetra, por për hir të atyre që janë thënë deri tani, nuk na takon të premtojmë më!"

Eureka!…

Pas kësaj rrëfenje të "sinqertë", (ala elektorale '17), deputeti bën thirrje për të kërkuar "urgjentisht realizimin e saj… Me një rezolutë të përbashkët, të gjitha forcat politike, të vendosim ndërtimin e saj, me të gjitha sforcot financiare.

Eureka!…

Më tej deputeti i Dibrës vijon…"Rruga e Arbrit është gënjeshtra më e madhe e tranzicionit shqiptar…"

Eureka!…

Deputeti është tepër i shqetësuar se "Kush është dibran…nuk na beson më. Sa pa nisur fushata, të votojmë në Kuvend ndërtimin e saj.

Eureka!…

Nuk qenka vetëm ai, qenka edhe një tjetër që askush nuk e ka dëgjuar të thotë një fjalë për Rrugën e Arbrit dhe për Skavicën që e mbyt dhe e shkul Dibrën. Një që shkon sa majtas djathtas, sa me Berishën aq me Ramën dhe që ankohet se "tash shtatë vjet nuk ka qenë në poste qeveritare apo të ketë mundësi numrash ti imponohet qeverisë!!!".

Ai, në udhëtimin e tij të parë në Peshkopi, mëson se "duhen katër orë (me makinën speciale) me arrit në Peshkopi në një udhë shumë të vështirë për mileniumin e ri"

Eureka!…

Deputetë të krahut të majtë kanë zbuluar tash 14 muaj përpara zgjedhjeve të ardhshme kuvendare të flasin, të "fajësojnë veten" e të bërtasin për Rrugën e Arbrit, tu tregojnë dibranëve "arat e baballarëve", tu thonë se Dibra "është një zonë e pasur me njerëz punëtorë e ku me krenari të thoshin se në këtë stinë të vitit të tërë njerëzit janë në punë e s'ka asnjë ngastër të papunuar e të pambjellë".

Eureka!…

Aferim zotërinj. U zgjuat në aksham, pas gjumit të gjatë të vapës së korrikut.

Ferrë Doka nga "Qielli i Shtatë", sheh e thërret!

"Jalla lema, me këta deputetë që kena"…

…Sot, në faqet e para të gazetave dhe në dritaret e vogla të televizioneve kombëtare, me germa të mëdha e flesh, jepej lajmi për lidhjen e Çorovodës me Përmetin.

E mbështes pa asnjë diskutim…

Por, para së gjithash, e mbi të gjitha "deputeti dhëndër Dibre", në një seancë kuvendare të thërresë në podium dy deputetët në koalicion qeverisës që zbuluan se Rruga e Arbrit, nuk është rrugë vetëm për aksin Tiranë, Mat, Bulqizë, Peshkopi… por edhe për qytetin e Dibrës, Gostivarit, Tetovës… është rrugë që bashkon trupin e prerë për kurrizi të Shqipërisë, rrugë që kalon përmes "QENDRËS GJEOGRAFIKE SHQIPTARE", qendër mbi 60 mijë kilometrave katrore; ku flitet, shkruhet dhe këndohet shqip që kur u krijua njerëzimi.

Rruga e Arbrit tash hyri në fjalorin e deputetëve që zgjohen në darkë e flenë në mëngjes…

Jalla lema…

Shënim:

Ferrë Doka ishte një endacak që qarkullonte në tërë Dibrën. Shprehja e tij "Jalla lema" është bërë pjesë e të folmes alegorike dibrane.

koment

Partitë e përdorin për të fituar vota, por në fakt e përdorin për turpin e tyre, sepse pikërisht me mënyrën se si e përdorin këtë çështje, kuptohet se ata gënjejnë.

Rruga si çështje elektorale, një kartë e djegur

Nga **BUJAR KAROSHI**

Megjithëse nuk ka lajme të reja për fillimin e punimeve në Rrugën e Arbrit, partitë politike nuk heqin dorë prej zakonit të vjetër e të vjetëruar të përdorimit të kësaj çështje për përfitime elektorale.

Ishte kryetari i Partisë për Drejtësi dhe Integrim, Shpëtim Idrizi dhe deputetja e kësaj Partie Mesila Doda, që gjatë një takimi zgjedhor në Peshkopi, premtuan se "do të bëjnë gjithçka që kjo rrugë të ndërtohet", mjafton që dibranët të anëtarësohen në PDIU. Doda shkoi edhe më tej, kur tha se "javën tjetër do të kërkoj interpelancë me ministrin se pse rruga e Arbrit nuk po ndërtohet".

Kjo nxiti deputetin e Dibrës nga radhët e LSI-së që të botonte një reagim në shtypin qendror, ku thekson se "me qenë Dibra, qoftë edhe për një ditë, tashmë që po vjen fushata, ia vlen barra qeranë".

Përdorimi si kartë elektorale e çështjes së rrugës ka nisur që në vitin 2005 nga qeveria socialiste e Fatos Nanos, por tashmë është bërë një kartë e vjetër. Partitë e përdorin për të fituar vota, por në fakt e përdorin për turpin e tyre, sepse pikërisht me mënyrën se si e përdorin këtë çështje, kuptohet se ata gënjejnë.

Jam dëshmitar, kur në maj të vitit 2007, ndërsa merreshim me organizimin e Konferencës Shkencore për Rrugën e Arbrit, një natë përpara takimit, ndërsa po merreshim me detajet e fundit të organizimit, pamë në kafen e Hotel Tirana deputetin Shpëtim Idrizi – sot kryetar i PDI dhe dibranin Ylli Manjani, sot Ministër i Drejtësisë, që pinin kafe së bashku. Aty për aty, vendosëm së bashku me Hysen Ukën, që t'i takonim dhe t'u jepnim një ftesë. E diskutuam në moment dhe duke ditur se njëri ishte dibran dhe mendonim se kishte ndikim në radhët e PS dhe tjetri ishte deputet i zonës së Tiranës nga kalonte Rruga e Arbrit – Zall Dajt e Zall Bastar, - iu afruam dhe u dhamë nga një ftesë. Ata na pritën ftohtë dhe si të çuditur, por megjithatë ftesën ua lamë në duar... Shpëtim Idrizi e kishte marrë një ftesë më parë përmes postës si deputet i një zone të rëndësishme nga kalonte Rruga e Arbrit. Të nesërmen asnjëri nuk erdhi në Kuvend.

Po ashtu, disa deputetë të PD – shumë të afërt me kryeministrin Berisha, atë ditë kishin marrë disa kryetarë shoqatash dibrane dhe kishin organizuar një takim me ministrin e Transportit Sokol Olldashi, nga ku kishin marrë prej tyre premtimin se "Rruga e Arbrit do të bëhet patjetër". Këta kryetarë thanë të nesërmen se "kot që e organizonim Kuvendin, pasi ministri kishte thënë se shumë shpejt fillojnë punimet".

Atë ditë, ndërsa Kuvendi po zhvillonte punimet, deputetë të tjerë të PD u shfaqën në hyrje të Hotel Tirana, por vendosën të mos futeshin në sallë, pasi organizatorë ishte një shoqatë "vegël e PS"...

Kështu që ajo konferencë – e cila ka qenë një ndër më e mirat e organizuar për këtë çështje, nuk pati vëmendjen e duhur nga qeveritarët. Materialet e asaj konference, të botuar edhe në një libër është mundi dhe djersa e dhjetëra specialistëve të infrastrukturës, të ekonomisë, turizmit, industrisë. Aty janë gjithë argumentet ekonomikë, financiarë dhe social që justifikojnë ndërtimin e Rrugës së Arbrit. Të renditësh këto argumente sot është si të përsëritësh fjalë për fjalë ato që u thanë në atë kuvend 10 vite më parë.

Prej atëherë kanë kaluar dy fushata: 2009 dhe 2013, ku Rruga e Arbrit ka qenë e vetmja kartë elektorale me peshë e partive politike. Sepse me këtë premtim dhe diskutimin pasionant rreth saj, çdo kandidat e kishte të lehtë dhe të suksesshëm takimin me elektoratin. Madje për këtë, të gjithë kandidatët nuk e kishin problem të përdornin anëtarë të shoqërisë civile për të mbrojtur argumentet e tyre. Por, pasi fushata mbaronte, deputetët e mazhorancës të Berishës dhe të Ramës sot, gjenin rrugën më të lehtë: të këshillonin organizatat e shoqërisë civile apo anëtarët e tyre të mos flasim, të mos bëjnë të paduruarin "pasi Kryeministri e ka prioritet këtë çështje dhe ai do t'i japë zgjidhje të shpejtë".



Tuneli i Qafës së Buallit, një nga "sukseset" e qeverisë në ecurinë e rrugës

Pasi PDIU e rifut edhe njëherë në agjendat politike dhe pas "autokritikës" së deputetit të LSI, ka një sulm nga njerëzit përmes rrjetet sociale për të radikalizuar qëndrimet e qytetarëve të Dibrës dhe Matit për këtë çështje, për t'i ndaluar politikanët të shkojnë në këto zona, madje edhe për të paralajmëruar një bojkot në bllok të zgjedhjeve të ardhshme.

Por asnjëra nga këto nuk do të ndodhë, sepse dy partitë e mëdha duket sikur këtë duan. Në këtë mënyrë ata e kanë më të lehtë t'i kontrollojnë militantët dhe aleatët. Ndërsa popullin e kanë të vështirë të kontrollojnë apo ta blejnë, qoftë edhe me një thes miell.

Rezoluta e Kuvendit të Majit 2007, kishte në thelb të saj disa paragrafë që edhe sot nuk u heq dot asnjë presje.

Aty thuhej se "Kuvendi u kërkon institucioneve qendrore në vend, veçmas Kryeministrisë dhe Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, që ta marrin seriozisht problemin e ndërtimit të Rrugës së Arbrit. Kuvendi u kërkon qeverisë dhe institucioneve përkatëse që të intensifikojnë bashkëpunimin me institucionet homologe në Maqedoni dhe institucioneve financiare të huaja për këtë çështje. Gjithashtu, Kuvendi u kërkon këtyre institucioneve që të dëshmojnë me veprime konkrete atë që kanë premtuar para gjithë popullit në përgjithësi e para dibranëve e matjanëve në veçanti, se janë të gatshëm e po punojnë që Rruga e Arbrit të bëhet sa më shpejt".

Rezoluta theksonte se "çdo hap i vonuar në këtë drejtim nga institucionet vendimmarrëse është mungesë vullneti dhe serioziteti para publikut" dhe i kërkonte opinionit publik që të mbajnë nën vëmendje hapat e mëtejshme të institucioneve vendimmarrëse.

Disa anëtarë të kryesisë së LID e kundërshtuan projekt-rezolutën, me argumentin se shoqëria civile nuk kishte mekanizma për të detyruar "të zgjedhurit e popullit". Megjithatë, pas diskutimeve, u la që pasi të lexohej rezoluta, të ngriheshin nga salla dhe të propozonin ndryshime. Por kjo nuk ndodhi, madje rezoluta u duartrokit fuqishëm pikërisht se parashikonte angazhime të mëdha të shoqërisë civile.

Tani, 10 vite më vonë kërkojmë të kthehemi sërish te ato qëndrime. Ndërkohë shumë aktorë kanë dalë nga skena dhe të tjerë janë aktivizuar. Një grup qytetarësh të angazhuar po përpiqen të mbajnë gjallë çështjen dhe peticioni online ka mbi tre vite që nuk po e ul ritmin. Ndërkohë që qeveria nuk e ka pranuar qoftë edhe formalisht peticionin, kërkohen angazhime të reja për çështjen dhe ristrukturim të shoqatave dibrane, madje edhe me radikalizim të çështjes: protesta në sheshe dhe rrugë.

Tani është koha e një radikalizimi në lidhje me këtë çështje, por jo në kuptimin që të bllokojmë rrugët apo të kapim gurët, por në kuptimin që t'i shtrëngojmë deputetët tanë, secili të partisë së tij, që të detyrohen, jo të largohen e të japin dorëheqjen, por të luftojnë që Dibrës t'i jepet ajo që i takon. Ne nuk duhet të shfaqim xhelozira pse ndërtohen rrugë në Skrapar, Vlorë, Gramsh e gjetkë, por deputetët tanë duhet të kërkojnë atë që i takon Dibrës: një rrugë! Dhe duhet t'ua shpjegojnë kolegëve të tyre deputetë që mund t'i kenë kundër, se nuk bëhet fjalë për një autostradë si ajo që çan malet e Mirditës dhe as si një autostradë që lidh Lushnjen me Fierin e Vlorën. Por bëhet fjalë për një rrugë të zakonshme: që lidh krahina të tëra të Tiranës me Tiranën, që lidh Matin, Bulqizën e Dibrën me Tiranën, me një rrugë 7 metra të gjerë sa për t'u këmbyer dy makina.

Dibranët e duan kaq shumë Rrugën e Arbrit sa janë sjellë me të si me një suvenir të çmuar: kujdes, mos fol! Mërzitet mistri, mërzitet deputeti, mërzitët kryeministri dhe pastaj thyhet! E dinë ata! Mendojnë ata! Dhe befas, kur kjo gjë e çmuar thyhet, mërzitemi, dëshpërohemi dhe revoltohemi.

Të kërkosh ta përdorësh Rrugën e Arbrit si një argument për fushatën e ardhshme është humbje kohe. Deri atëherë është një vit në mes: dhe për një vit qeveria aktuale ka mundësi të tregojë vullnetin për rrugën. Së pari të pranojë publikisht peticionin dhe së dyti të dëshmojë veprime konkrete në fillimin e punimeve.

Në mos e bëftë këtë, atëherë ne duhet të kërkojmë të na sjellin herës tjetër deputet Erion Braçen! Të paktën, kam besim se do të arrijmë që të dibranët të jenë më të vlefshëm se kastravecat e Lushnjës!

Një grup qytetarësh të angazhuar po përpiqen të mbajnë gjallë çështjen dhe peticioni online ka mbi tre vite që nuk po e ul ritmin. Ndërkohë që qeveria nuk e ka pranuar qoftë edhe formalisht peticionin, kërkohen angazhime të reja për çështjen dhe ristrukturim të shoqatave dibrane, madje edhe me radikalizim të çështjes: protesta në sheshe dhe rrugë.

Të kërkosh ta përdorësh Rrugën e Arbrit si një argument për fushatën e ardhshme është humbje kohe. Deri atëherë është një vit në mes: dhe për një vit qeveria aktuale ka mundësi të tregojë vullnetin për rrugën. Së pari të pranojë publikisht peticionin dhe së dyti të dëshmojë veprime konkrete në fillimin e punimeve.

Kujtesë nga viti 2007

Rezolutë e Kuvendit tekniko-shkencor për "Rrugën e Arbrit"

Ne, përfaqësues të Shoqatave "Lidhja e Intelektualëve Dibranë", "Nisma Dibrane", "Bashkësia Dibrane", "Votra Dibrane", u mblodhëm sot më 26 Maj në Tiranë, në këtë Kuvend për të diskutuar mbi alternativën më të mirë të zhvillimit të Dibrës në veçanti e gjithë Shqipërisë në përgjithësi: Ndërtimin e Rrugës së Arbrit.

Kuvendi për "Rrugën e Arbrit" dëgjoi nga profesorë e inxhinierë të fushave përkatëse, alternativat e zhvillimit të vendit me vënien në funksionim të Rrugës së Arbrit.

Kuvendi shtroi alternativat për zgjidhjen sa më shpejt të probleme paraprake në mënyrë që ndërtimi i rrugës të fillojë një ditë e më parë.

Kuvendi u kërkon institucioneve qendrore në vend, veçmas Kryeministrisë dhe Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, që ta marrin seriozisht problemin e ndërtimit të Rrugës së Arbrit.

Kuvendi u kërkon qeverisë dhe institucioneve përkatëse që të intensifikojnë bashkëpunimin me institucionet homologe në Maqedoni dhe institucioneve financiare të huaja për këtë çështje.

Kuvendi u kërkon këtyre institucioneve që të dëshmojnë me veprime konkrete atë që kanë premtuar para gjithë popullit në përgjithësi e para dibranëve e matjanëve në veçanti, se janë të gatshëm e po punojnë që Rruga e Arbrit të bëhet sa më shpejt.

Kuvendi u shpreh se çdo hap i vonuar në këtë drejtim nga institucionet vendimmarrëse është mungesë vullneti dhe serioziteti para publikut.

Kuvendi i kërkon opinionit publik, që në këtë kuadër, të mbajnë nën vëmendje hapat e mëtejshme të institucioneve vendimmarrëse.

Kuvendi u kërkon deputetëve të zgjedhur nga populli i zonave ku kalon Rruga e Arbrit, zotërinjve Shpëtim Idrizi, Leonard Demi, Idriz Xhumara, Sali Shehu, Rrahim Kaleci, Genc Sharku, Sadri Abazi, Albert Farruku, Qemal Minxhozi, që të ushtrojnë të drejtat e tyre parlamentare, për të venë në lëvizje gjithë mekanizmat e ekzekutivit, në mënyrë që ky projekt madhor të bëhet realitet, që dita e Rrugës së Arbrit të jetë sa më afër.

Tiranë, 26 maj 2007

Rruga e Arbërit nr. 120

opinion

Skavica është kthyer për Dibrën në sinonim të engjëllit të vdekjes



Nga **ALI HOXHA**

Të parët tanë që na kanë lënë trashëgim këtë truall arbëror, e kanë mbrojtur me gjakun dhe jetën e tyre, për shekuj me radhë, nga sulmet e shovinisteve fqinj. Ndaj edhe neve na bije detyra që ta mbrojmë dhe t'ua lëmë trashëgim pasardhësve tanë. Por, nëse dje, në shekujt e kaluar, pushtimet e ndryshme kishin karakter kryesisht ushtarak, tani në shekullin e 21, me krijimin e sistemit të ri botëror, që njihet me emrin sistemi i ekonomisë së tregut, pushtimi ushtarak është modifikuar me një lloj tjetër, me pushtimin ekonomik. Ky lloj pushtimi është shumë herë më i rrezikshëm se ai ushtarak sepse, siç thotë një shprehje popullore, ai të vret me "plumba pambuku", pa e kuptuar fare. Prandaj duhet të jemi tepër vigjilentë, si nga pushtuesit ekonomik të jashtëm, firmat e huaja ekonomike, por më të rrezikshëm janë pushtuesit ekonomik të brendshëm, pushtetarët, tregtarët që e kanë vënë në shitje Shqipërinë "për një euro", si dhe sekserët ose zëdhenësit e tyre, veçanërisht mercenarët që dalin nga radhët tona dhe kthehen në kolaboracionistë, bashkëpunëtorë me pushtuesit ekonomik vendas apo të huaj.

Qysh prej vitit 1961, – kur u publikua ai projekt me digë 220 m të lartë deri në lartësine 485 m. mbi nivelin e detit, një liqen artificial me sipërfaqe 100 km2, me gjatësi 100 km, që parashikon rezervuarin ujor më të madh në Europë, me 7 miliard m3 ujë, që përmbyt gjithë Pellgun e Dibrës , për popullin e Dibrës ai emër është kthyer në një sinonim të emrit Azrail (emrit të ëngjëllit të vdekjes për njerëzit dhe xhinët), sepse ai projekt i ka qëndruar popullit të Dibrës mbi qafë ashtu si shpata e Demokleut, duke menduar gjithnjë se kur të vinte ai çast, gjithë popullsia do të shpërngulej "me mace e me mi" e do të degdisej, nuk dihej se ku, duke u kthyer në muhaxhir. Përveç kësaj, projekti HEC-i Skavica, ka shërbyer si pretekst për të lënë në një prapambetje ekonomike mesjetare për 50 vjet rresht gjithë pellgun e Dibrës deri në atë shkallë saqë edhe rruga nacionale Kukës-Peshkopi (siç quhet rruga e Rinisë) pat mbetur ashtu siç pat qenë ndërtuar më 1946, nga aksioni vullnetar i Rinisë shqiptare, pa u shtruar qoftë edhe me një metër linear asfalt, pa bërë fjalë këtu për zonën e Fushë-Çidhnës, të cilën, për shkak të luftës civile që u bë në korrik 1944, në Fushë Alie, regjimi i asaj kohe e pat kthyer në zonë eksperimentale për zhvillimin e luftës së klasave deri në ekstremet më të fundit, ku, për pasojë, nuk u lejua as ndërtimi i një ure automobilistike jo vetëm mbi Drin, si kjo që ka filluar vitin e kaluar, 2015, por as edhe një urë këmbësorësh mbi përroin e Blliçes, për fëmijët e fshatit Laçes e të Blliçes që ndiqnin shkollën 7-8 vjeçare më pas dhe të mesmen bujqësore në Fushëalie, ndaj, me të drejtë, inxhinieri arkitekt Shaban Bitri, nga Blliçja që ka kryer shkollën 7 vjeçare në Fushëalie, urën që ndërtoi vet duke lidhur Fushëalien me Laçesen etj, në librin e tij autobiografik e ka quajtur "ura e andrrave".

2.Argumentet dhe arsyet se përse nuk u bë ai projekt në atë kohë nga sistemi monist, ne i kemi trajtuar në shumë shkrime tonat, qysh prej 12 vjetësh më parë. Shteti i asaj kohe i kishte të gjitha fuqitë ligjore dhe ekonomike për të bërë atë vepër. Enver Hoxha e anulloi HEC-in Skavica për këto arsye: Së pari, në aspektin ekonomik, Dibra është "Myzeqeja", hambari i zonës veri-lindore të Shqipërisë. Ky pellg ka mbajtur me bukë jo vetëm Dibrën, por edhe Lumën, Mirditën e Matin. Por për ne, dëmi ekonomik qëndron në plan të dyte, në krahasim me dëmin në aspektin gjeopolitik, historik dhe etnokulturor:

Në aspektin gjeopolitik, Dibra e Poshtme do të shpërbëhej, sepse pjesa lindore e saj do t'i bashkëngjitej pjesës tjetër të Dibrës që ka mbetur nën pushtimin serbo-sllav, qysh prej vitit 1913, kurse pjesa tjetër e Dibrës në anën perëndimore të Drinit të Zi, do të shpërbëhej duke iu bashkëngjitur, pjesërisht Kukësit, (Reç e Dardhë), pjesërisht Mirditës (Lura) dhe pjesërisht Matit (Çidhna, Muhurri, Katër Grykët e Luznia etj). Pra, nuk do të kishte më Dibër. Prandaj, nëse Fuqitë Evropiane, më 1913 e ndanë Dibrën në dy pjesë, tani vet shqiptarët Dibrën tonë po e asgjësojmë krejtësisht;

Në aspektin etno-kulturor dhe historik, përsëri dëmi është i pallogaritshëm, sepse nga përmbytja e këtij territori do të asgjësohej një qytetërim i tërë historik, një etni e tërë kulturore, do të zhdukej e gjithë Dibra me varret dhe historinë e saj.

Pra, qeveria e sistemit monist, edhe pse diktaturë e proletariatit, siç theksohej edhe me kushtetutë, dhe se në ato kushte askush nuk mund të pengonte ndërtimin e atij HEC-i, ajo e gjykoi se një projekt i tillë, nuk duhej zbatuar kurrëmë, prandaj e anulloi. Ndërsa po të ishte për rezistencën popullore të asaj kohe, atë gjë as nëpërmend nuk mund ta shkonte askush prej nesh, sepse do ta kapte "rryma elektrike", vetëm sikur ta kishte menduar një gjë të tillë. Ndërsa tani jemi në kushte të tjera historike. Siç dihet, pas vitit 1990, me ndryshimin e sistemit diktatorial dhe me ardhjen e sistemit demokratik, ndryshuan edhe ligjet. Nisur nga fakti se një ditë çështja e projektit të HEC-it Skavica do të dilte në rendin e ditës të programit të qeverive përkatëse në kohët e ardhme, qysh në vitin 2000, mua më lindi ideja për të krijuar një shoqatë "Për mbrojtjen e pronave dhe të mjedisit të Pellgut të Dibrës në luginën e Drinit të Zi", sepse një ditë do të dilte në skenë ai projekt. Pas rreth 2 vjetësh, së bashku me z.Nazmi Drizi dhe anëtarët e tjerët të kryesisë, e krijuam shoqatën dhe në vitin 2002 e ligjëruam edhe në Gjykatën e Tiranës, me vendimin e saj Nr.436. Me punën tonë modeste ne, si shoqatë, radhët e së cilës arrijnë deri në 5000 anëtarë, në bisedat dhe mitingjet tona të herëpashershme me popullin në kohë të ndryshme, me shkrimet sqaruese në shtypin e përditshëm dhe atë periodik nga anëtarët e kryesisë, si dhe me intelektualët dibranë, duke filluar së pari, nga Ali Hoxha, Abdurrahim Ashiku, Prof.Dr.Adem Bunguri, Prof.Vesel Hoxha, Bujar Karoshi, Nazmi Drizi, Murat Koltraka, etj., arritëm që planet e tyre për projektin HEC-i Skavica, t'ua prishnim dy herë, dy qeverive shqiptare dhe kompanive të huaja kontraktuese edhe në vitet 2004-2005 dhe 2008-2009 për këtë problem.

"... Allahu nuk e ndryshon gjëndjen e vështirë të një populli në një gjendjë të mirë, as nuk e ndryshon gjëndjen e dobët të këtij populli, deri sa ai të ndryshojë vetveten në përshtatje me gjëndjen në të cilën ecën. Kur vendos Allahu që ta lëshojë të keqen mbi një popull, nuk do të ketë asnjë që të mund ta ruajë këtë popull nga ndëshkimi i Tij, dhe nuk do të ketë asnjë që t'ia marrë përsipër çështjen këtij populli për t'ia larguar të keqen që i ka rënë" (Kur'an, sure Err-rraëd, ajeti 11)

Konkluzioni për rastin tonë konkret është ky, ne duhet të bëjmë përpjekjet tona, pastaj në fund e di Zoti se si vendos për këtë çështje. Nëse përpjekjet tona do të jenë për mirë, jo vetëm Zoti, por edhe historia do të na gjykojë për mirë, në të kundërtën, edhe Zoti edhe historia do të na ndëshkojnë, kurse brezat e ardhshme do të na mallkojnë.

Tani, së fundi, duke filluar në muajin janar 2016, janë intensifikuar përpjekjet dhe ka dalë në skenë përsëri çështja HEC-i Skavica, por në shumë variante. Shumë tratativa të fshehta apo të hapura janë bërë nga qeveritarë të ndryshëm me kompani të ndryshme, si në të kaluarën, ashtu edhe tani. Lidhur me kompanitë e huaja kontraktuese apo koncensionare, unë dua të bëj një sqarim: me çfarëdo shtetësie apo kombësie qofshin ato, apo të çfarëdo besimi qofshin, siç ka pas qenë një shprehje e hershme: "turq apo kaurrë" (dmth muslimanë apo të çdo besimi tjetër) duhet të kemi të qartë se ata janë individë të caktuar apo kompani private të caktuara, të cilët, si kudo në botë, luftojnë për interesat e tyre private për të gjetur e siguruar tregje pune, ndaj ato nuk përfaqësojnë politikën e shtetit të tyre përkatës. Prandaj të jemi të kujdesshëm që të mos ngatërrojmë politikat e shteteve të tyre ndaj nesh. Politikat grabitqare të kompanive private, të çfarëdo kombësie apo besimi qofshin ato, të mos i ngatërrojmë me politikat shtetërore të shteteve përkatëse. Në këtë aspekt, unë theksoj se edhe një kompani private shqiptare me të cilën, Shoqata "Çidhna dhe Kastriotët", është në konflikt se tenton të na thajë Setën për të bërë një HEC në Arras, për mua ai është pushtues, sepse, kushdo që kërkon të grabisë pasuritë e Dibrës, ai është pushtues (ekonomik), ndërsa çdo individ, qoftë qytetar i thjeshtë apo pushtetar lokal që bashkëpunon me ta në dëm të komunitetit dibran, për mua ata janë kolaboracionistë, bashkëpunëtorë me pushtuesin.

* * *

Duke u rikthyer në temën tonë theksojmë këtu se vetëm gjatë muajit janar e shkurt 2016 janë bërë disa biseda apo intervista televizive si dhe janë shkruar në shtyp disa artikuj të ndryshëm ku secili prej autorëve të tyre shpreh opinionin e vet nga këndvështrimi, sipas interesit personal lidhur me objektin, HEC-in Skavica, nëse oratori është person partiak apo i punësuar në shtet, ose mund të jetë edhe thjesht ortak e "zëdhënës" i ndonjë kompanie private.

Geri Selenica, nw njw serw shkrimesh gjatw kwtij fillim viti, kërkon me çdo kusht që mbi lumin Drin i Zi, në Dibër, të mos bëhet asnjë lloj HEC-i i vogël, as me dy diga, as me tri diga por vetëm varianti i parë, HEC-i i madh i vitit 1961, sepse nëse do të bëhëshin mbi Drin edhe HEC-e të tjera, ato do të pengonin realizimin e HEC-i Skavica e Madhe, me digën 220m në nivelin 485 m, i cili do të përmbytë gjithë Dibrën, nga bërja e të cilit ai llogarit të fitojë nga 100 milionë Euro në vit.

Por ajo që unë nuk mund të hesht është një deklaratë e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, z.Ilir Meta, i cili gjatë një intervistën televizive, pyetjes së gazetaritpër HEC-in e Skavicës, ai iu përgjigj me të njëjtat fjalë të ish-Kryeministrit Sali Berisha, disa vjet më parë, kur u përmbyt fusha e Shkodrës nga hapja e portave të hidrocentraleve mbi lumin Drin: "Ndërtimi i Skavicës shpëton Shkodrën nga përmbytja"..

Ndryshe nga ai, tregohet më i matur zëvendësi i tij, kreu i grupit parlamentar të LSI, z.Petrit Vasili, njëherësh edhe nënkryetar i LSI, i cili, edhe pse mendon se duhet të bëhet një HEC (Skavicë e Madhe), por kur vjen puna te pasojat e përmbytjes, ai shprehet më i përmbajtur kur thotë: "Pyetja shtrohet: A do të trajtohet kaskada e Drinit si një çështje kombëtare, apo si një problem i vogël lokal?"

Në këndvështrimin tonë, të gjitha kompanitë private, të huaja apo shqiptare, kanë politikën dhe synimet e tyre për të gjetur tregje, ndaj ata si të tilla duhen trajtuar, pra si palë kundërshtare.

Dikur, para viteve 1990, ne kishim një shtet, i cili edhe me kushtetutë quhej "Shteti i diktaturës së proletariatit" që pati shpronësuar gjithë qytetarët e tij, gjithë prona tokësore ishte shtetërore etj. Ndaj edhe vepra të tilla si HEC-et, minierat, hekurudhat, rrugët etj, ishin pronë shtetërore; i ndërtonte shteti dhe bëheshin për shtetin. Në këtë aspekt edhe ne, populli, ishim edukuar që interesin e përgjithshëm, pra të shtetit, ta vinim mbi interesin personal. Por sot, pas vitit 1990, ka ndryshuar situata, ndryshoi sistemi shoqëror, pra ndryshuan edhe ligjet. Sot asgjë nuk është shtetërore, por gjithçka është kthyer në private. Nuk ka më pronë shtetërore, sepse minierat dhe hidrocentralet janë kthyer në pronë private, ose u jepen me koncension apo me qira kompanive apo personave privatë të caktuar. E thënë shkurt, edhe"HEC-i Skavica e Madhe" apo "Skavica e Vogël", "Katundi i Ri" etj, tashmë nuk i ndërton shteti, por persona ose kompani private, kurse shteti (institucioni i ministrisë përkatëse) vetëm luan rolin e kontraktorit për të vjelur përqindjen e vlerës së objektit.

Në gazetën "Ballkan" datë 5 shkurt 2016, fq.6 shkruhen tituj e nëntituj të tillë: "Drini i Zi, Skavica, tre skemat për ndërtimin e hidrocentraleve". "Ministri Gjiknuri u shpreh dje se Skavicën do e ndërtojë KESH, ndërsa "Katundin e Ri" do e ndërtojë privati". Në gazetën "Sot", dt. 2 shkurt 2016, fq.19 shkruhet "Skavica, Katudi i Ri, dhe humbja 100 milion euro në vit!"

Vetëm këto tituj shkrimesh të ndryshme mjaftojnë për të krijuar një vizion për aferat korruptive që luhet në kurriz të pasurive, pronave dhe të vet historisë së qytetërimit të Dibrës me projektet të tilla si "Skavica e Madhe" apo "Skavica e Vogël" etj. Mbështetur vetëm në këto tituj shkrimesh, unë dua t'i bëj një pyetje drejtuar z.Petrit Vasili: "Për çfarë problemesh kombëtare u flitka në ato artikuj lidhur me Skavicën ?"

Përgjigjja më e saktë besoj se është kjo:

Në kurriz të Dibrës po thuren vetëm afera korruptive dhe po bëhët tradhëtia më e madhe kombëtare. Në këtë aspekt do të thoja se, nëse në kohën e Rilindjes Kombëtare në shek.XIX, rilindasit tanë të mëdhenj, S.Frashëri etj, Dibrën e kanë pas parashikuar për kryeqytet të Shqipërisë, sepse ajo është kërthiza e katër vilajeteve të Shqipërisë Etnike, ndërsa pas copëtimit të trojeve shqiptare në 1913, Dibra u nda për gjysëm, në dy pjesë, duke mbetur në periferi secila prej tyre në të dy anët e kufirit shqiptar. Pjesën e Dibrës së Madhe, që ka mbetur në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, pushtetarët serbo-sllavë duan ta mbysin duke e tharë edhe për pikën e ujit. Atyre nuk u dhimbset as Dibra dhe as dibranët, sepse ata janë pushtues, kurse pushtetarët tanë tregtarë, Dibrën tonë duan ta fundosin përjetësisht nën ujë, e ta shesin, vetëm për të mbushur xhepat e tyre. Kjo është e pakonceptueshme për ne.

***

Populli i Dibrës duhet të ngrihet i gjithi në këmbë për të mbrojtur trojet tonë me të gjithë mjetet ligjore, sipas traditës së të parëve tanë. Përfaqësuesi i kompanisë "StatKraft" në bisedën që kemi bërë me të ne në Tiranë, në fillim të vitit 2009, na ka sqaruar: "Në qoftë së edhe një pronar i vetëm nuk do të jetë dakord për tu shpërngulur, unë nuk i filloj punimet, edhe sikur shteti shqiptar të ma jepte lejen në dorë me firmë e me vulë".

Vellëzër dibranë! Mbajeni mend mirë dhe kurrë të mos e harroni këtë informacion që na ka dhënë "Stat Kraft" dhe mësoni se kështu janë ligjet e demokracisë europiane. Prandaj, të jeni vigjilentë që të mos bini në kurthe të mashtruesve!

Të nderuar shtetarë dhe pushtetarë lokalë të Dibrës, në pushtet dhe në opozitë! Ju bëj thirrje që të qëndroni të vendosur në mbrojtje të dinjitetit e të integritetit tuaj dhe të mbarë Dibrës e të historisë së saj dhe të mos harroni, se sipas kushtetutës qindra vjeçare (kanunit) të Dibrës, as tokën tuaj nuk mund ta shisni jashtë fisit tuaj, pa ia pirë kafen i gjithë fisi. Mos u nënshtroni as nga presionet apo joshjet që mund t'ju bëjnë. Shembujt pozitivë asnjë herë nuk kanë munguar nga atdhetarët dibranë në asnjë kohë për mbrojtjen e atdheut e të kombit dhe të nderit. Atdheu e dinjiteti mbrohen jo vetëm me pushkë, jo vetëm në kohë lufte, por edhe në kohë paqeje.

** Kryetar nderi i Shoqatës "Për mbrojtjen e pronave dhe të Mjedisit të Pellgut të Dibrës në luginën e Drinit të Zi" Botuar me shkurtime*

Për opinione dhe komente mund të na shkruani në adresën: <rrugaearberit@gmail.com>
OPINIONET DHE KOMENTET E BOTUARA NUK SHPREHIN DOMOSDOSHMËRISHT QËNDRIMIN E REDAKSISË

portret



Doktor Qatip Doda, specialisti i bimëve mjekësore dhe frutikultureës, që me shembullin e tij po ringjall traditën e frutikulturës në Dibër

Doktor Qatipi, shkencëtari i bimëve mjekësore

Nga **Osman XHILI**

Qatip Dodën tani e thërrasin të gjithë "Doktor". Ai është agronom nga profesioni, por e quajmë të tillë, pasi nuk ka vetëm një muaj që ka mbrojtur doktoraturën. Pasioni dhe vullneti i këtij njeriut arriti që ta merrte këtë titull në moshë 60 vjeçare, kur shumë të tjerë i kanë braktisur me kohë studimet. Tamam, ashtu siç thotë profeti: "Ndiqeni dijen nga djepi deri në varr". Po meqë e nisëm me këtë të fundit, le të hedhim pak dritë mbi disa aspekte të këtij punimi shkencor. Duhet thënë se përpjekjet e para nisën më herët, në vitet 2004 - 2007, kur filloi e mbaroi masterin e nivelit të dytë në Tiranë. Tematika ishte interesante: "Resurset gjenetike të bimëve aromatike mjekësore të qarkut Dibër ".

KULTIVIMI I BIMËVE MJEKËSORE

E zgjodhi këtë temë për dy arsye. Së pari, niveli i lartë i papunësisë në këtë rreth, bën që bimët mjekësore të shihen si një mundësi e madhe fitimi për fermerët e zonave rurale. Së dyti, mbledhja e tyre pa asnjë lloj kriteri po i çonte ato në një shkatërrim total, duke e bërë të domosdoshëm kultivimin e tyre nga dora e njeriut. Vlerësimi i tij nga komisioni qe gati maksimal, 48 pikë, nga 50 të tilla të mundshme.

Më pas vijoi me temën e doktoraturës. Mes bimëve aromatike mjekësore zgjodhi për studim Sherebelen, Salvae Oficinalis, ekotipin e Dibrës. Shumë elemente teknologjike të kësaj kulture u përfshinë në studimin e tij, distancat e mbjelljes, ndikimi i gëlqerizimit të tokës para mbjelljes, si dhe përqindja e vajit që do të rezultonte në përfundim. Në provë u vunë tre varjante. Ekotipi i sherebelës së Dibrës në gjendje të egër, ekotipi i Dibrës i kultivuar, si dhe kultivari hollandez. Studimet gati pesë vjeçare sollën rezultate interesante. Distanca më e mirë do të ishte 60 cm me 25 cm, kurse sasia e gëlqeres së hedhur duhej deri në 100 kunjtalë për hektarë. Analizat e vajit u bënë në fabrikën e Xhavit Hysenajt, në Maminas. Kryesonte ekotipi i egër me 2, 8 përqind, më pas varjanti i kultivuar i Dibrës me 2,4 përqind dhe i fundit kultivari hollandez me 2,2 përqind. Për nga vjelja, kishte përparësi mënyra me buqetë e realizuar me prerje me gërshërë, krahasuar me vjeljen me drapër. Mënyra e parë nuk dëmton sythat e bazës, duke mundësuar gati dyfishin e rendimentit.

Pas një luhatje të tregut të sherbelës, kohët e fundit lajmet po vijnë pozitive. Po rritet çmimi dhe interesi për të, një dritë dhe shpresë për fermerët që e kultivojnë këtë kulturë.

NGA SHKOLLIMI TE PUNA NË KRIJIMIN E FERMËS

Doktor Qatipi i mbaroi studimet e larta në Korçë, në vitin 1980, me një mesatare mbi nëntë. U emërua në kooperativën e Maqëllarës, ndër ekonomitë më të mëdha të asaj kohe në Dibër. Kaloi shumë pozicione pune, agronom, nënkryetar dhe përgjegjës sektori dhe gjithmonë u përpoq të japë më të mirën që mundej. Dy gjëra kanë mbetur akoma në kujtesën e tij, rendimentet e larta në grurë dhe fusha e Maqëllarës që vaditej me liqenin e Bllacës.

Disa vite të jetës së tij, Qatipi i kaloi si emigrant në Greqi. Jo pak herë provoi dhe punë të rëndomta bujqësore për të mbijetuar e ushqyer familjen e tij, fëmijët atë kohë të vegjël. Herë të tjera u vlerësua dhe në profesionin e specialistit të fushës që mbulonte, në krasitje agrumesh, vrojtues sëmundjesh të bimëve, apo pjesëmarrës në konsulta të ndryshme. Por, netëve të errëta, kur malli e merrte për fëmijët e familjen, shpesh e më shpesh pyeste veten dhe sa kohë do të vazhdonte kështu. Merr një vendim të prerë për tu kthyer përfundimisht në shtëpi. Kishte mjaft eksperiencë, por dhe pak para, të mjafta këto për të filluar një aktivitet të vogël bujqësor.



Disa vite të jetës së tij, Qatipi i kaloi si emigrant në Greqi. Jo pak herë provoi dhe punë të rëndomta bujqësore për të mbijetuar e ushqyer familjen e tij, fëmijët atë kohë të vegjël. Herë të tjera u vlerësua dhe në profesionin e specialistit të fushës që mbulonte, në krasitje agrumesh, vrojtues sëmundjesh të bimëve, apo pjesëmarrës në konsulta të ndryshme.

Filloi punë në drejtorinë e bujqësisë në Dibër si specialist i këshillimit. Në të njejtën kohë mbjell 7 dynymët e para me mollë. Ishin gjithsej 700 fidanë të llojeve Starking, Golden dhe Grin smith, që të gjitha këto me sistem mbështetës dhe me vaditje me pika. Më vonë shton dhe tre dynym të tjerë me mbjellje intensive me 1200 rrënjë gjithsej. Këta ishin dy varitete të reja, Brina dhe Çadëll, më rezistente ndaj kromës dhe sëmundjeve të tjera. Kështu, në total do të ketë një prodhim të përgjithshëm molle mbi 400 kunjtalë.

Tre dynymë të tjerë doktor Qatipi i ka të mbjella me qershi. Janë dy varitete, Burlat dhe Ferrovia në vitin e pestë të prodhimit dhe rezultatet duken mjaft të mira. Vitin e kaluar provoi dhe një dynym me qershi vegjetative, me distanca më të vogla dhe me sistem mbështetës. Deri tani çdo gjë po shkon sipas parashikimit. Po si për ta bërë më të plotë tryezën e frutave, Qatipi ka mbjellë dhe dy dynymë me rrush për konsum të freskët dhe përpunim. Është mbjellë në vendin që dikur quhej vreshtë, me një ekspozicion shumë të përshtatshëm. Të gjitha këto e çojne në 15 dynymë sipërfaqen e mbjellë me pemtore, duke i mbetur vetëm dy dynymë të lira për perime.

Zona e Maqëllarës po e bën traditë mbjelljen e shalqinit me plasmas të zi duke marrë rendimente mjaft të mira, mbi 50 apo 60 kunjtalë për dynymë. Doktor Qatipi ka vite që e kryen këtë proçes, bile duke alternuar dhe rreshta lakre mes shalqinit, duke shtuar ndjeshëm prodhimin dhe fitimin .

Nuk ka më tokë të tijën. Shtatë dynymë të tjerë i merr me qira për ti mbjellë me hasëll. Është një përzjerje e gatshme fare me burxhak, festukë, grurë dhe tërshërë që vjen nga Italia. Kjo masë e njomë kositet në qershor dhe është baras me dy kosë jonxhe dhe me të njejtën vlerë proteinike.Vetëm para ca ditësh e viztuam parcelën e mbjellë dhe të gjithë komponentët ushqimorë dukeshin të mrekullueshëm. I gjithë ky ushqim shkon për dy lopët Taranteze që japin mbi 30 litra qumësht në ditë secila. Viçat e tyre në gjashtë muaj arrijnë 300 kg peshë të gjallë. Para dy vitesh njëri prej tyre peshonte 437 kg, në moshën 7,5 muajshe. 10 koshere bletë dhe 3 – 4 dele e plotësojnë anën blektorale të medaljes.

Krahas gjithë kësaj ngarkese të madhe e thuaj të përditshme, që nga viti 2003, doktor Qatipi ka hapur një farmaci bujqësore në qendër të Maqëllarës. Farëra, fidana, plehëra, pesticide e plot shërbime të tjera afrohen këtu për fermerë të zonës e më gjerë. Me ndihmën e pakursyer të fondacionit Agrinet të Korçës, që drejtohet nga miku ynë i palodhur, Tomi Pikuli, fermerët kanë krijuar një shoqatë shumë aktive, duke koordinuar më mirë veprimtarinë e tyre. Farmacia bujqësore, veç funksionit të mirëfilltë, ka shërbyer dhe si bankë për fermerët, që sjellin paratë në fund të vitit, pasi kanë shitur prodhimet e tyre.

FAMILJA

Fëmijët e doktor Qatipit, dikur të vegjël, janë rritur dhe janë shkolluar që të gjithë. Rolandi, më i madhi, ka ndjekur rrugën e të atit. Ka mbaruar universitetin bujqësor në Tiranë për prodhim bujqësor dhe mbrojtje bimësh. Të dy së bashku menaxhojnë mjaft mirë farmacinë dhe fermën e tyre. Rolandi ka një shpirt të ndjeshëm e bujar. Mjafton ti thuash që shkolla e mesme e Maqëllarës don një sasi fare loliumi për mbjellje dhe ai e kryen sadakanë.

Po kaq i gatshëm është për të dhuruar pemë dekorative, me vlerë jo të paktë, në shkolla, xhami dhe institucione të tjera. Këtë vit, pret të bëjë dasmën me Denisën që studion për financë dhe ndoshta do të jetë një zë më shumë në planifikimin dhe menaxhimin e fermës. Vëllai tjetër, Klodiani, pas kolegjit të Kavajës mbaroi pesë vjet për diplomaci në Stamboll e më pas dy vjet master për marketing. Tani punon në Turqi në një firmë të fuqishme duralumini dhe po kryen doktoraturën. Vajza e vetme, Brunilda ka filluar punë si juriste, në bashkinë e qytetit, pasi mbaroi shkollën, masterin dhe një vit shkollën e avokatisë.

Por pas kuintave fshihet një mik dhe aleat i heshtur dhe i hershëm i doktor Qatipit, e shoqja e tij, Shpresa. 40 vjet ka shërbyer si infemjere dhe gjatë gjithë kohës nuk ka pasur vdekje foshnjore, një tregues shumë i rëndësishëm për këtë kategori punonjësish. Fjalët më të mira thonë për të banorët e fshatit Çerenë, të cilëve u ka shërbyer me shumë përkushim. Sot ajo vazhdon të jetë shumë aktive me punët e fermës, por dhe duke drejtuar një shoqatë grashë, që merren me gatime e punime tradicionale.

Doktor Qatip Doda flen shumë pak orë, punon fizikisht e mendërisht. Shoqatën e krijuar dëshiron ta ngrejë në nivelin e një kooperative të organizuar perëndimore. Po aplikon për të ngritur një dhomë frigoriferike, ku të ruaj mollën gjatë gjithë kohës për treg. Sigurisht, ajo do të shërbejë dhe për fermerë të tjerë , duke u ardhur në ndihmë në ndonjë situatë kritike. Shumë shpejt Qatipi mendon të shtojë tre hektarë të tjerë me mollë intensive, për ti dhënë fermës përmasa dhe dinjitet, si një model për zonën dhe komunitetin.

Ujërat termale të Peshkopisë dhe turizmi kurativ

Qendra balneologjike e Peshkopisë mund të bëhet një stabliment ripërtëritje, kurimi dhe turizmi e shquar edhe jashtë vendit,



Qendra balneare e Peshkopisë, Mars 2015. **Foto**: *Fatbardh Cena*

Nga **M.Sc. Fatbardh CENA**[2]

HYRJE

Shqipëria është mjaft e pasur me burime minerale e termale, të cilat kanë rëndësi të veçantë kurative në sajë të temperaturës së lartë dhe kripërave që përmbajnë. Ndër këto burime, mjaft të njohura dhe kurative janë edhe ujëratermale të Peshkopisë ose siç njihen "Llixhat e Peshkopisë". Pranë këtyre ujërave është ngritur një kompleks balnear kurativ, i përbërë nga kabinat individuale dhe disa kabinete teurapike. Këto burime veprojnë pozitivisht në organizmin e njeriut dhe shërbejnë për të kuruar disa sëmundje, sidomos reumatizmin dhe sëmundjet e lëkurës. Prezenca e tyre, përveç aftësive kuruese të sëmundjeve, ka bërë që zona përreth të marrë formën e një qyteze nga ndërtimet dhe hotelet e shumta duke u kthyer në një burim të ardhurash për shumë familje. Qendra balneare me vlerat e saj kurative, me baltë dhe pishinën me ujë termal, e ndodhur pranë bjeshkëve të larta të Korabit, i ka kapacitetet që të kthehet si qendra kurative dhe turistike më e rëndësishme në Shqipëri.

Kompleksi balnear kurativ i ujërave termale të Peshkopisë përbëhet nga 44 kabina individuale dhe gjashtë kabinete mjekimi si: kabineti i mjekimit me anën e baltës sulfurore, kabineti i fizioterapisë (mjekime me anë të rrezeve, kinezoterapisë dhe masazhoterapisë), mjekim me anë të lëvizjeve dhe masazhit të fërkimit, kabineti i gjinokologjisë, kabineti aerosal i terapisë (mjekim me anë të alucideve) dhe dy dhoma reaminacioni për trajtimin e rasteve urgjente. Ujërat termale të Peshkopisë bëjnë pjesë në listën e monumenteve të natyrës të rrethit Dibër, sipas VKM-së 676, datë 20.12.2002 "Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare". Përbëjnë një kompleks balnear që frekuentohet jo vetëm nga qytetarët shqiptarë, por edhe nga vendet fqinje.

POZICIONI GJEOGRAFIK DHE KUSHTET GJEOLOGO-NATYRORE.

Ujërat termale të Peshkopisë gjenden në pjesën verilindore të Shqipërisë duke bërë pjesë në ndarjen administrative të bashkisë dhe rrethit të Dibrës. Janë rreth 1.5 km larg qytetit të Peshkopisë, në pjesën lindore të tij. Përfshihen në zonën gjeologo-tektonike të Korabit. Kanë këto koordinata gjeografike: 41°42'10" gjerësi gjeografike veriore dhe 20°27'15" gjatësi gjeografike lindore. Temperatura e tyre luhatet 35ºC-43.5ºC dhe me prurje 14 litër në sekondë që burojnë nga thellësitë e masivit gjipsor të Bellovës. Ujërat e tyre përmbajnë 600 mg/l H_2S dhe 3800-4500 mg/l lëndë minerale (ujëra kaliumore-sulfatore).

Në përroin e Banjës, ndodhen katër burime pranë njëri-tjetrit. Këto burime lidhen me tektoniken e diapirit gjipsor triasik, i cili rrethohet nga një unazë e flisheve të Eocenit të Sipërm-Oligocenit të Poshtëm. Burimet lidhen me brezin tektonik sizmoaktiv Liqeni i Ohrit-Dibër. Me këtë brez tektonik lidhen edhe burimet termale të Banjishtes dhe të Kosovrastit në veriperëndim të Dibrës së Madhe në Maqedoni. Burimet kanë prurje të madhe. Midis tyre, ai që ka temperaturën e lartë, ka prurje 14 litër për sekondë ndërsa ujërat e burimeve të tjerëve janë më të ftohtë, deri në 12°C. Burimet dalin përgjatë kontaktit të gjipseve me flishin, i cili shërben si ekran. Kur gjipset zhyten nën nivelin e zonës së qarkullimit të lirë të ujit, vërehet prania e H_2S.

VLERAT KURUESE TË TYRE.

Vetitë kuruese të ujit termomineral merren me mënyrat e mëposhtme:

1.Me banjë në ujin termomineral për 10-15 minuta për këto sëmundje: reaumatizmat kronike, reumatizmat degjenerative, artralgjitë, radikualgjitë, neuritet kronike, spondilozat dhe spondilartrozat, neuralgjitë, tendinet, bursitet, gjendjet pas aksidenteve traumatike të reponura, disa sëmundje gjinekologjike si steriliteti primar dhe sekondar, hipoplazitë e uterusit, adneksitet kronike, endometritet kronike, disa sëmundje të lëkurës si psoriaza, sëmundjet mikotike të lëkurës, kolelitiazat, urolitjazat.

2. Me pirje të ujit termomineral: gastritet hiperacide e hipoacide, ulçerat kronike të stomakut dhe deudenit, konstipacionat kronike, kolitet kronike, cistopielitet e mikrourolitiazat.

3.Me gargarë e shpërlarje me ujë termomineral: laringitet kronike, tonsilitet e disa sëmundje gjinekologjike.

Njerëzit vijnë në ujërat termale të Peshkopisë edhe për një tjetër rrjedhë uji kulluese. Ai quhet Uji i Ftohtë i Llixhave dhe gjendet rreth 1 km larg qendrës balneare. Për të gjithë ato pacientë që reumatizmën e kanë në fazë fillestare, kështillohet qëndrimi disa minuta në këtë burim, i cili edhe në muajin korrik e ka temperataturën 10°C. Përveç ujit, kërkesat e shumta janë edhe për baltën e zezë që përftohet nga uji termal, e cila përdoret kryesisht për problemet reuzmatike, nga gratë për ngrohjen e vezoreve etj.

Numri i pushuesve të shtruar në vit është rreth 6000 veta (viti 2014) me cikël 10-14 ditë, ku mbi 500 prej tyre janë të ardhur nga jashtë Shqipërisë, kryesisht nga Maqedonia dhe Kosova. Periudha me numrin më të madh është atëherë kur temperaturat janë mesatare, pra në pranverë dhe vjeshtë.



Qyteza e Bellovës, monument kulture. © F. Cena, korrik 2015

VLERËSIMI EKONOMIK DHE FREKUENTIMI I TYRE

Mesatarisht për një person që kurohet 10 ditë, çmimi është 15000-20000 lekë ku përfshihet akomodimi, ushqimi dhe larja në vaskë. Shumë qytetar të lagjes "Llixha" i kanë kthyer vilat e tyre në bujtina për pushuesit në ujërat termale. Ato kanë ndërtuar shtëpitë e tyre në këtë zonë pas rrëzimit të sistemit komunist në Shqipëri dhe lëvizjes së lirë të popullsisë. Banorët e kësaj lagjeje janë kryesisht të ardhur nga fshatrat malore të njësisë administrative të Melanit. Pas migrimit të fuqisë punëtore dhe sigurimit të të ardhurave nga migracioni i jashtëm, një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë investuar në zonën pranë ujërave termale duke ndërtuar vila të shumta. Kryesisht vilat janë 2-3 katëshe, ku banorët jetojnë në njërin apartament, ndërsa dhomat e tjera i japin me qera për këto pushues. Kjo ka bërë që një numër i konsiderueshëm të vetëpunësohen në shërbime të ndryshme si transport të pushuesve, shitës pranë kësaj zone, prodhimin dhe tregtimin e produkteve artizanale të zonës etj.

Duke llogaritur numrin e pushuesve që kurohen çdo vit dhe shpenzimet ekonomike për një person, vëmë re që sigurohen të ardhura të mëdha për komunitetin e zonës apo dhe bashkinë në formë taksash. Llixhat e Peshkopisë me një menaxhim të mirë dhe me investime aty ku të jetë e nevojshme, kanë potenciale që të kthehen në qendrën kurative më të rëndësishme në Shqipëri. Një mundësi reale do ishte përfundimi i "Rrugës së Arbërit" e cila do e shkurtonte distancën me kryeqytetin në më pak se dy orë, pasi koha e udhëtimit në rrugën ekzistuese është afërsisht katër orë dhe në gjendje të amortizuar.

Qendra balneologjike e Peshkopisë mund të bëhet një stabliment ripërtëritje, kurimi dhe turizmi e shquar edhe jashtë vendit, fillimisht qoftë edhe në nivelet e qendrave balneologjike të Kosovrasitit dhe Banjishtes në zonën e Dibrës së Madhe në Maqedoni. Disa nga problemet aktuale të qendrës balneare të Peshkopisë janë: dëmtimet dhe çarjet e në rrjetin e ujërave termale, ndërtimet e reja e veçanërisht rreth burimeve termale, hapja e puseve të paligjshme duke vënë në rrezik cilësinë e tyre, rradhë e gjatë për futjen në vaska sidomos gjatë periudhës kur ka fluks pushuesish dhe që çojnë në domosdoshmërinë e shtimit të numrit të vaskave. Të gjithë kabinetet që funksionojnë dhe ato që mund të vihen në punë brenda mundësive të investimeve në material, kërkojne patjetër personel të infermierëve te specializuar sipas proçedurave terapeutike te veçanta.

Numri i pushuesve të shtruar në vit është rreth 6000 veta (viti 2014) me cikël 10-14 ditë, ku mbi 500 prej tyre janë të ardhur nga jashtë Shqipërisë, kryesisht nga Maqedonia dhe Kosova. Periudha me numrin më të madh është atëherë kur temperaturat janë mesatare, pra në pranverë dhe vjeshtë. Numri i tyre ka ardhur në rritje të vazhdueshme, ndërsa vitet e fundit vihet re një rënie e lehtë për shkak të krizës ekonomike. Ekzistenca e këtyre burimeve i ka dhënë edhe emrin lagjes ku ndodhen.

Zonat që dallohen më shumë për sjelljen e këtyre pushuesve janë kryesisht rrethet si: Shkodra, Malësia e Madhe, Mati, Tropoja, Puka, Kukësi, Mirdita, Lezha, Kurbini, Tirana, Durrësi, Fieri etj., por edhe nga Kosova dhe Maqedonia. Mbi 80% e tyre akomodohen nëpër shtëpitë private të banorëve që jetojnë përreth.

Gjithashtu janë ndërtuar dhe po ndërtohen disa hotele me kapacitete të mëdha dhe bashkëkohore për akomodimin e vizitorëve qoftë rreth qendrës balneare apo edhe në qytetin e Peshkopisë. Frekuentimi në këtë qendër balneare është gjithëvjetor. Numri më i lartë i pushuesve është në stinën e pranverës e konkretisht në muajt prill dhe maj ndërsa periudha me numrin më të vogël është gjatë periudhës më të ftohtë të vitit, e konkretisht në janar dhe shkurt.

Masivi gjipsor nga i cili dalin burimet termale përbën një kupolë diapirike me formë rrethore. Përbën një gjeomonument tektono-struktural i emërtuar "Kupola Diapirike e Bellovës". Në afërsi të qendrës kurative ndodhen edhe disa monumente natyre dhe kulture si shpella dhe burimet e Bellovës, Boroviku i Begjunecit-Rabdishtë, Qyteza e Bellovës, Gradishta e Peshkopisë etj. Gjithashtu me interes për turistët paraqiten edhe fshatrat malorë të njësisë administrative të Melanit si Zagrad, Bellovë, Cerjan dhe Rabdisht. Janë fshatra karakteristikë ku shtëpitë, çatitë e tyre dhe rrugët janë të gjitha prej guri të punuar nga mjeshtërit dibranë. Po ashtu mund të vizitohen edhe bjeshkët pranë këtyre fshatrave, me format e shumëllojshme dhe tërheqëse të relievit dhe kuzhinën tradicionale të pasur të zonës.

---

1. Artikulli i plotë është botuar në revistën shkencore Academic Journal of Interdisciplinary Studies. Rome, Italy 2016. Vol.5, No.1, ISSN 2281-4312 (online) fq.254-259. **Link**:http://www.mcser.org/journal/index.php/ajis/article/view/8976/8668
2. Shkolla Doktorale e Gjeografisë, Universiteti i Tiranës, email: cenafatbardh@gmail.com

Ç'kemi asaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Në fillim të kërkoj ndjesë që mungova numrin e kaluar. E di që je mërzitur shumë, por edhe unë u mërzita sepse nuk kishte lajme, veç sa protesta "me të vdekur" kundër Skavicës, një mësues që rreh nxënësit me shkelma dhe një tjetër që i vë litarin në fyt fëmijës, ndaj se shkrova fare...

Këtë muaj kemi ngjarje, të gëzuara madje.. Gani Abazi, ose De Biazi, siç i thoni ju europianët, shkoi një vizitë në Peshkopi. Për të parë Korabin, që po bëhet gati të ngjisë një kategori. U turr i madh e i vogël ta prisnin e ta përqafonin, të rinjtë ti merrnin selfie dhe autografe, ndërsa të rriturit kush e kush ti bënte një dhuratë: një pjatë jufka a një tas sultiaç... Gratë dhe vajzat zgjasnin kokën nga dritaret të shihnin idhullin e burrave të shtëpisë, që veç të shohin futboll është puna që dinë të bëjnë më mirë...

Bashke me Ganiun ishte edhe Duka. Premtoi stadiumin e ri. Me siguri i ka thënë ndonjë që bëj premtime, se janë mësuar dibranët, nuk kërkon kush llogari...

Ca vajza të reja dhe djem të rinj kanë marrë një iniciativë që deri më 28 nëntor, ditën e ngritjes së flamurit, të mbjellin në Lurë mbi 5 mijë pemë. Dhe ne, në vend që ti mbështesim, jemi bërë gati me shkrepse në dorë, tu vëmë zjarrin e t'i shkulim... "U banë ene cucat me majll pajshat n'malet tona!..." Me këtë rast u zbulua se 45 mijë pisha kishte mbjellë qeveria në Lurë, por se ku ishin mbjellë askush nuk e di...

Andej nga Bulqiza ia kemi nxjerrë tymin ca maleve, jo për ti djegur, por thjesht për të parë nëse zjarret ndizen vetë edhe në pranverë...

Iku dimri dhe erdhi vera. Bashkë me Ditëveren edhe Shëngjergjin. Por prap qeveria vazhdon me premtimet, edhe këtë muaj, edhe atë muaj... Me sa duket kemi për ta ngrënë çështjen e rrugës së Arbrit edhe një fushatë tjetër, siç e kemi ngrënë gjithmonë: *hallvë të ftohtë*... Ndoshta tani, që çështjen e kanë marrë çamët në dorë, mund të bëhet edhe *hallvë e ngrohtë*, se dibranët dhe çamët kanë treguar në shekuj se shkojnë shumë mirë me njëri-tjetrin...

Këtë muaj na erdhi në Dibër (të Madhe) për vizitë ambasadori amerikan... Ne të shtypit i shkuam pas në çdo takim, por kur erdhi puna te vizita që i bëri një biznesmeni dibrano-amerikanë, u larguam. Nuk e di pse, a na dha urdhër pushteti apo s'na premtoi dollarë Ibrahimi...

Andej nga Bulqiza ka pas ngjarje këtë muaj: vendosje tritoli dhe ndonjë prerje organesh gjenitale - fiks lajme për të hapur edicione lajmesh. Ama po pati ndonjë aksident në miniera apo larg qoftë - vdes kush, lajmet dalin me dy ditë vonesë, sa të përgatitet ngjarja që të gjithë të dalin të pafajshëm...

Qeveria pritet ta bëjë tenderin për Katundin e Ri. Protesta thuhet se do bëhen në Peshkopi. Por që njerëzit të vijnë, duhet të përhapen fjalë se do marrë pjesë edhe De Biazi, ndryshe nuk vjen njeri...

Ç'e zgjas edhe unë! Sikur është Dibra kërthiza e Shqipërisë! Një copë fshat është, dhe hiç mos kij dyshime! Këtë e tha një zonjë intelektuale - grua ministri!

Anekdota e muajit

Sapo kishte nisur fushata dhe në zonën e Ndërlumasit kishin vërshuar kandidatë për deputetë duke paraqitur programet elektorale. Por zgjedhësit e Ndërlumasit nuk ishin bindur akoma për kë do të votonin.

Shkoi një kandidat, i bindur se do fitonte dhe merr fjalën: "Këtu kanë ardhur shumë kolegë, por të gjithë ju kanë gënjyer. Unë nuk do t'u gënjej. Do t'ju bëj vetëm një premtim dhe atë do ta mbaj: do t'ju bëj urën! Por, mbajeni mend, unë vetëm urën do t'u bëj".

Ndërlumasit u ngritën në këmbë duke brohoritur. Njëri nga zgjedhësit u ngrit dhe me qetësi tha: Po si të besojmë ne more zotni? Dhe kandidati u përgjigj: Do ta filloj urën para ditës së votimeve!

Themelet e urës u hapën dhe populli besoi dhe i dha votën. Dy-tre muaj pas zgjedhjeve e inauguroi urën. Banorët ishin shumë të kënaqur dhe e shprehën kënaqësinë duke mbajtur në krah deputetin...

Një muaj pas inaugurimit deputeti i thotë një të besuari të tij që të vendosnin një tra tek ura që të mbledhim ca lekë.... Banorët e Ndërlumasit e pranuan.

Një muaj pas vendosjes së traut deputeti takoi banorët, dhe askush nuk u ankua. Atëherë deputeti vendosi të vendoste një tra edhe në krahun tjetër të urës...

Banorët e Ndërlumasit u mërzitën pak, por nuk e refuzuan taksën e re...

Pastaj deputeti vendosi që në krah të urës të ndërtohej edhe një barakë... Pasi të paguanin taksën, burrat do të futeshin në barakë, do t'u bëhej ajo puna, dhe pastaj ikin në punët e tyre...

Banorët prap nuk kundërshtuan. Atëherë deputeti vendosi të bënte edhe një takim tjetër me popullin. Në shesh ishin mbledhur shumë e më shumë popull, edhe gra, dhe të gjithë dukeshin të gëzuar!

- Hë, më thoni, a keni ndonjë hall tjetër, u tha deputeti!

Askush nuk fliste. Vetëm një djalë i ri u ngri e tha:

- Zoti deputet, ti rrofsh sa malet se me urën na i ke zgjidhur të gjitha hallet, me traun që vendose ia bëre mirë se nuk na mbetet lek në xhep kur dalim pazarit, dhe me koliben që ndërtove i ke dhënë zgjidhje edhe streseve tona! Por, pa të shqetësuar e pa të lodhur, a ka mundësi ti shtosh njerëzit brenda barakës se bëhet radhë e madhe dhe mbetemi vonë për punë!

Sipas një versionit të treguar nga Rruzhdi Bitri



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit
https://www.facebook.com/Rruga-e-Arb%C3%ABrit-259603234230025/

Bëj pajtimin tënd me

PayPal

përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.



MONOLOGU I RRUGËS SË ARBËRIT

Nga **ASTRIT GJUNKSHI**

Trokun e kuajve përmbi trupin tim
e ndjej unë sot, si afro gjashtë shekuj më parë.
Në krye printe Ai, Gjergji kryetrim
ndjekur gjithnjë pas nga treqind trima Dibranë.

Drejt Krujës si era, heroi nxitonte
Lirinë Arbërisë t'i sillte, si dielli çan errësirën.
Dhe unë, si arterie që jetën përcillte
Ndjehesha me vlerë që po mbartja dritën.

Tokat arbërore, ku kombi i moçëm jetonte,
nga Dibra në kryeqendër unë shkurt i lidhja.
Një sistem nervor që shkëmbim përçonte,
si rrugë me jetë ku mbartet tregu e dituria.

Dhe Dibra,
ku fabula thotë se mendja ishte ndalur pasi lindi,
arriti zhvillim që kush nuk e mendonte.
Stambolli po të digjej, thonin njerëzit njëzëri,
vetëm Dibra e Madhe mund ta zëvendësonte.

Arbëria mbetej pjesa vitale e kombit
edhe kur kombi ndodhej në ditë të vështirë
të varfër e të pasur çdo ditë më bekonin
që jetën lehtësoja të bëhej më e mirë.

Troku i kuajve u ndërpre një ditë mbi trupin tim,
kur në skenë dolën mjetet me rrota,
dhe më shmangën djallëzisht dhe paramendim,
me një rrugë trefish, larg Dibra nga kryeqendra.

Dhe për dekada me rradhë, trupi im përgjumur mbeti
derisa një ditë të bardhë demokracia Arbërinë gjeti.
U gjallërova kur ca udhëheqës thonin fjalë solemne :
"Do të bëhet Rruga e Arbërit", sapo pushtetin ta merrte.

Do rinohesha, do kthehesha në një rrugë të gjërë,
që Dibrën e Madhe e të Vogël, dhe Dibranët në Tiranë
shumë afër do t'i sillte, dhe Arbërinë e Iliridën mbarë.
Mirëqenia do të rritej, mendja me dijen do vinte pranë.

Gëzim ndjeja kur përditë po lulëzoja nga puna,
dhe ëndrrat dëgjoja për të ardhmen më të lumtur.
Porse... nuk vazhdoi gjatë. Pjesë-pjesë, copa-copa
mbeta rrugëve si rrugë. Dhe politika ka humbur.

Politikë e humbur, si rëra në përrua,
vetëm kur vijnë zgjedhjet kujtohet për mua,
Gjithnjë veç premtojnë, por me lugë të zbrazur.
Dhe Arbërit presin me zemër të plasur.

S'mund të më ndërtojnë, apo duket s'duan?
Mos vallë duan Arbërinë, Dibrën, ta mbajnë larg, të harruar ?
Mos bashkimi, dituria rrezikon vërtet
që klanet bunkerizuar të vijojnë punën e vet ?

Po dëgjoj për peticion, por politika s'po kujtohet !
Në mbretërinë që ka ngritur, duket se çdo gjë harrohet.
Dhe e dij që, jo fort larg, stinë e zgjedhjeve do vijë.
Çdo dëgjoj unë atëhere, veç premtime përsëri ?

Tirana, më 4 Prill 2016.



Numri 1, maj 2006 — Numri 119, mars 2016

"Rruga e Arbërit" është një gazetë e lirë.

Kontribuo edhe ti për lirinë e saj me vetëm një pajtim!

Gazeta "Rruga e Arbërit" këtë vit mbush dhjetë vjet nga dalja e numrit të saj të parë dhe çdo muaj përcjell informacione, komente, opinione, reportazhe, recensa dhe rubrika të tjera për artin, kulturën, historinë dhe gjithçka që ka të bëjë me qarkun e Dibrës.

Gazeta është një botim i pavarur dhe këtë e ka dëshmuar gjatë këtyre dhjetë viteve me integritet dhe profesionalizëm.

Redaksia mbetet gjithmonë e hapur për sugjerimet tuaja, jo vetëm në trajtimin e tematikave, por edhe për të shkruar mbi veprimtari, individë apo organizata që veprojnë, kontribuojnë apo kanë lidhje me qarkun e Dibrës.

"Rruga e Arbërit" është një gazetë e lirë dhe liria e saj është e garatuar jo vetëm nga redaksia, por edhe nga lexuesit e saj, të cilët ndodhen larg vetëm një pajtim.

Gazeta shpërndahet në Tiranë, Durrës, Burrel, Klos, Bulqizë, Shupenzë, Maqellarë, Peshkopi dhe Dibër e Madhe në versionin print dhe në të gjithë botën përmes emailit në versionin PDF.

Një pajtim vjetor në Shqipëri dhe Dibër e Madhe, si deri më tani, kushton 600 lekë. Në Europë 10 Euro, në SHBA dhe vendet e tjera 15 USD.

Pajtimet jashtë Shqipërisë janë vetëm në versionet PDF dhe mund të kryhen përmes PayPal.

Për më shumë informacion:
Email: rrugaearberit@gmail.com
Tel: 00455 68 65 08 441.
WhatsApp: +355 68 65 08 441
Viber: +355 69 20 68 603
www.rrugaearberit.com
Bej "Like" dhe "Share"
Qëndro me gazetën #rrugaearberit më pranë #Dibrës!

Rruga e Arbërit - aty ku fjalët nuk i merr era!

Njoftim

Në kuadrin e 155 vjetorit të lindjes së Elez Isuf Ndreut - Nderi i Kombit, Bashkia Peshkopi, nën kujdesin e kryetarit të saj, z. Shukri Xhelili, do të organizojë një veprimtari në muajin qershor 2016.

Veprimtaria parashikon mbajtjen e kumtesave :

1 - Jeta dhe vepra e Elez Isuf Ndreut

2- Kontributi i Elez Isufi në mbrojtje të trojeve shqiptare

3 -Lufta e Elez Isufit për demokratizimin e vendit

4- Elez Isufi në traditën gojore

5- Bashkëveprimi i Elez Isufit me atdhetarët kosovarë Isa Boletini, Bajram Curri, Hasan Prishtina dhe Hoxhë Kadriun.

6-Përshëndetje: nga Kosova-nipi i Hasan Prishtinës, nipi i Isa Boletinit dhe mbesa e Hoxhë Kadriut, nga Prefektura e Dibrës, Qarku Dibrës, Komuna e Dibrës së Madhe, Bashkia e Bulqizës, nga familja (pasardhësit e Elez Isufit).

Plani i masave parashikon dhe veprimtari letrare e këngë për Elez Isufin. Po sot iu bë propozim Këshillit Bashkiak të Dibrë për dhënien e titulli "Qytetar Nderi" Elez Isufit.

E gjithë veprimtaria mbyllet me homazhe tek varri i Elez Isufit në Sllovë dhe bustit në Peshkopi.

Të gjitha individët, organizatat, shoqatat apo biznesmenë që dëshirojnë të kontribuojnë në këtë veprimtari mund të kontaktojnë me zotin **Moisi Murra**, në nr. tel: 068 38 93 020.

SHTËPIA E LIBRIT FLETA XXI BOOK HOUSE PESHKOPI

LIBRI PRANË JUSH

LIBRARIA FLETA XXI, PRANË MUZEUT, PESHKOPI
Email: fletaxxi@gmail.com

Bëj pajtimin tënd me PayPal

përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA
është vetëm në versionin PDF.

BOTIME NGA AUTORË DIBRANË



Agron Tufa: Thembra e Akcilit
Botimet M&B. ISBN: 978-9928-172-62-4
Çmimi: 800 lekë



Ramiz Gjini: Pëllumbat e rrugës - roman
Botimet M&B. ISBN: 978-9928-172-56-3
Çmimi: 700 lekë



Naim Berisha: Shpresa - roman
Botimet M&B. ISBN: 978-9928-172-59-4
Çmimi: 500 lekë



Mevlud Buci: Alegoria e Dibrës
Botimet M&B. ISBN: 978-9928-172-34-1
Çmimi: 1200 lekë

cyan magenta yelloë black

reportazh

Të pathënat e udhëtimit emocionues me De Biazin në Dibër

Vetëm **me fitore në Europian** mund t'ua **shlyej borxhin** e mikpritjes suaj





Armando Duka: "Këta njerëz e meritojnë një stadium dhe ne do të bëjmë të pamundurën..."

Gjatë gjithë rrugës, trajneri i kombëtares pyeste për historinë e Dibrës, për karakteristikat e kësaj zone. Pyeste për fushën e Torviollit, të luftërave të Skënderbeut, pyeste edhe për këngën e Hajredin Pashës. Nuk ngopej së mësuari për historinë e kësaj treve.

Nga **Defrim METHASANI**

Eshtuna e 23 prillit ishte një ditë e bukur dhe me diell. Drejt Peshkopisë, aty ku do të luhej një nga ndeshjet e rëndësishme të kategorisë së parë, ajo mes Korabit dhe Erzenit, u nisëm së bashku me trajnerin e kombëtares shqiptare Giani De Biazi, Presidentin e Federatës Shqiptare të Futbollit Armando Duka dhe Sekretarin e Përgjithshëm të FSHF-së, Ilir Shulku.

Ishim të bindur se vizita në Peshkopi do të kalonte në një atmosferë të mrekullueshme - ashtu siç dinë dibranët, por emocionet nisën që në Bulqizë. Ndaluam të drekonim në një lokal mes pishash, edhe pse nxitonim për të kapur ndeshjen në stadiumin Korabi. Porositëm disa gjëra karakteristike të zonës së Bulqizës dhe djemtë që shërbenin treguan klas të lartë. Jufkat, sheqerparja, pse jo edhe dhallti, ishin vërtet ato gjëra që trajneri italian i kombëtares shqiptare nuk i kishte provuar kurrë. Mbeti i mahnitur. Në lokal, për fat, ishte edhe një festë familjare. Një djalë ishte bërë synet, dhe sipas traditës së këtyre anëve, një dasëm e vogël po bëhej. Por sapo e panë De Biazin, të gjithë dolën jashtë.

"Ata kanë festë, - tha De Biazi. Shkojmë ne atje, të mos ua prishim gëzimin".

Mora mikrofonin dhe pasi e prezantova mes duartrokitjesh, përshëndeti shqip. Ata u mrekulluan, ndërsa trajneri i kuqezinjve mori në krah djaloshin... Çfarë kujtimi! Djali ishte jetim. Nëna e djalit, e cila fliste shumë mirë italisht, u afrua, dhe e mrekulluar nga kjo surprizë, tha: "As dasma e këtij djali nuk do më shijojë më shumë".

Gjatë gjithë rrugës, trajneri i kombëtares pyeste për historinë e Dibrës, për karakteristikat e kësaj zone. Madje edhe kish lexuar. Duka, me një italishte të saktë dhe unë ashtu si për t'u kuptuar, sqaronim gjithçka. Pyeste edhe për drurët, pyjet, fushën e Torviollit, të luftërave të Skënderbeut, pyeste edhe për këngën e Hajredin Pashës. Nuk ngopej së mësuari për historinë e kësaj treve. Dhe respekti më rritej më shumë pas çdo pyetjeje të tij

Ndërsa afroheshim drejt Peshkopisë, një makinë policie kishte dalë tek ura e Topojanit, aty ku bashkia e re e Dibrës kufizohet me Bulqizën. Me sirenat dhe autokolonën e gjatë që ish bërë me makina, u futëm në stadium. Mijëra njerëz thërrisnin në kor emrin e tij. Vajzat e skuadrës së volejbollit kishin bërë gati buqetat me lule dhe me mbishkrimet përkatëse për De Biazin, Dukën dhe Shulkun. Ëmbëlsirat tradicionale erdhën si shenjë mikpritje, sapo ata shkelën në atë tribunë modeste.

Disa tavolina dhe karrige ishin shtuar enkas për miqtë specialë që për herë të parë vizitonin Dibrën. Nënkryetari i bashkisë Sali Tërshalla i uroi mirëseardhjen, ndërkohë që i dhuroi edhe emblemën e Bashkisë së Dibrës. Më pas, në një atmosferë që rrallë e kisha parë të ndodhte, unë ftova De Biazin të fliste para sportdashësve dibranë. Në mikrofon foli sërish shqip. Pas tij foli edhe Presidenti Ii FSHF, Armando Duka. Ai, i emocionuar si rrallëherë, premtoi edhe për stadiumin e ri.

"Këta njerëz e meritojnë një stadium dhe ne do të bëjmë të pamundurën..."

Në dhjetëminutëshin e parë të lojës, në qiell fluturoi një banderolë ku shkruhej bukur mes tullumbaceve: "Grazie De Biazi! Faleminderit Duka!". Mbeti pa fjalë sa e pa dhe u ndje vërtet i mahnitur.

"Sa bukur, - tha, - një mrekulli... Se besoja kurrë këtë pritje".

Po kaq i lumtur ishte edhe Duka. Në pushim doli pas tribunës, sepse dhjetëra e qindra njerëz donin foto e autografe prej tij. Nuk u lodh dhe nuk u mërzit kurrë.

Ndërsa me pyeste për malin e Korabit, për lartësinë dhe shumë detaje të tjera, unë i ofrova pranë yllin e futbollit dibran, Shpëtim Toska, dhe një relikte të FSHF ia dorëzoi vetë ai. I tregova për Toskën dhe u ndje keq, për historinë e viteve kur ai luajti, që nuk arriti dot ta vesh atë bluze krenarie që sot na përfaqëson në Francë 2016... Me pas u ul, por ndeshja s'mund të niste, pa shijuar edhe një tjetër surprizë. Albert Damzi, një tifoz i veçantë i Korabit, solli një çifteli me mbishkrimin e emrit të tij dhe skuadrës së Korabit, madje interpretoi disa minuta me këtë instrument tipik të Veriut. Ai e mori dhe kërceu si fëmijë nga dhurata...

Në pjesën e dytë pati gola dhe i bëri përshtypje Guri, 22-vjeçari, sulmuesi shkodran që luan për Korabin dhe është golshënuesi më i mirë. Kërkoi ta takonte dhe bashkëbisedoi me të. I pëlqeu gjatësia, finesa dhe zgjuarsia, por më shumë mosha e tij e re...

Pas ndeshjes, iu kisha premtuar tifogrup "Arbërit" të bënin foto me De Biazin. Ai zbriti me mua në fushë dhe aty qindra njerëz e rrethuan nën pushtetin e një rrethimi dashamirës dhe respekti të pamasë. Qeleshja ishte dhuratë nga tifozi i vjetër Rrem Fida.

Pas ndeshjes, ndalesa qytetare ishte në një prej lokaleve me emër, ku iu rezervua një tjetër drekë, tashmë me ushqime bio të zonës së Dibrës. Duke qeshur më thotë: "Defrim, po ta dija, do të merrja edhe një stomak tjetër me vete..."

Më pas, vendosa t'i bëj një tjetër surprizë, ta dërgoj në Dibër të Madhe. Me vete kishim presidentin e klubit sportiv Korabi atje, Urim Lleshi, të cilin e ftova për të respektuar miqtë. Ai bëri një telefonatë dhe thuajse i gjithë qyteti, sfidoi shiun dhe erdhën në lokalin ku do prisnin miqtë nga Tirana. Më shumë ishin të rinj, të cilët i dhuruan edhe simbolet e skuadrës, fanellën, shallin dhe dhurata të tjera. Ai njeri nuk lodhej dhe nuk përtonte asnjëherë...

Kryetari i komunës Rruzhdi Lata rezervoi një darkë dhe një dhuratë me simbolin e komunës Dibër e Madhe për De Biazin, Dukën dhe Shulkun.

Lokali ku shkuam për të darkuar ishte në dalje të qytetit, disa kilometra, por njerëzit vinin me makina sa e merrnin vesh që ka ardhur trajneri i kombëtares shqiptare.

Interesante ishte ardhja e një grupi vajzash, të cilat kishin marrë taksi për të ardhur aty...

Detaje dhe moment të tilla nuk shpëtonin për t'u fiksuar nga fotoreporteri Fehmi Lleshi, i cili ndiqte hap pas hapi këtë udhëtim emocionues të trajnerit italian, kaq popullor në Shqipëri.

Si pa kuptuar shkoi mesi i natës dhe duhej të udhëtonim drejt Tiranës, tashmë të mbushur si asnjëherë tjetër me këtë emocion që vështirë të vijë në një shkrim të vetëm.

De Biazi, ndërsa po largohej, për t'ju kthyer respektin të pranishmëve të shumtë, premtoi:

"Unë jam "borxh" me ju me këtë pritje që më rezervuat, ndaj ju them, që vetëm fitorja në Evropian mund t'jua shlyente "borxhin"....







Kufi!

Nga **Dionis XHAFA**

Vendi ku jam rritur nuk ka qenë vendlindja ime, sepse prindwrit e mi ishte zhvendosur nga një vend tek tjetri pak përpara se të lindja unë. Kisha qenë vetëm dy vjeç kur kisha ardhur këtu dhe sigurisht që vendlindjen nuk e mbaja mend e ndaj ky vend më ishte bërë më i dashuri nga të gjitha vendet e planetit. Vendi ku u rrita ishte një qytezë me emër të çuditshëm dhe se ashtu si të çuditshëm e kishte edhe natyrën e cila e rrethonte. Quhej Maqellarë dhe se nga emri vetëm si vendbanim shqiptar që nuk dukej.

Dikush më kishte thënë se ishte emër me prejardhje sllave kur në këtë vend andej nga vitet 1913-1914 ishte bërë luftë e madhe mes serbësh dhe shqiptarësh, por edhe betejë mes vetë shqipove të kohës për hesapve të pushtetit. Kjo qytezë ndodhet diku mes dy qyteteve më të rëndësishëm të rrethit dhe të qarkut të Dibrës – mes Peshkopisë dhe qytetit të mbetur jashtë kufirit të Republikës së Shqipërisë.

Vendi ku u rrita kishte një veçanti tepër të rëndësishme dhe disi element romantik më dukej: Kufirin! Maqellara, që mua më tingëllonte gjithnjë si ndonjë emër italian ishte qyteza që ndante qarqet me të njëjtin emër në shtete të ndryshme: Këtej Dibër e andej ne e quanim "Dibër e Madhe" – këtej Shqipëri e andej Maqedoni.

Ky është vend ku po të ecësh në maja e në shkrepa rrëzë Korabit ose poshtë në fushat e Drinit të Zi mundeshe që ashtu pa dashje të shkelje tokat nën territorin e shtetit tjetër.

Madje si kufi ndarës natyror më dukesh se ishte maja e malit mbi qytezë – një grumbull krepash e shkrepash që formonin një si kokë majmuni.

FSHATRAT NË FUSHË

Veç se nuk kam lindur në Maqellarë dhe se nuk e kam të shënuar në pasaportë, por se e njoh shumë mirë atë vend dhe njerëzit që e banojnë atë. Njerëzit këtu janë nga të rrallët – ata të cilët punën e vënë parësore dhe mbi gjithçka tjetër, pa ditur të thonë se u lodha.Kush e njeh zonën, nuk mundet të mos ketë dëgjuar se këtu banojnë njerëz tepër punëtor dhe të sakrificës.

Zona është e madhe pasi ish-komuna ka qenë një perimetër i gjërë dhe përfshinte diku tek 22 fshatra, njëri më interesant se tjetri. Maqellara është vendi ku e vjetra përzihet dhe ndërthehet keqas me modernitetin dhe se pa frikë mund të konsiderohet "qytezë", megjithëse disi e përçunduar nga ndërtimet pa kriter.

Kurse në fshatrat përreth Maqellarës më është ruajtur tradita dhe jo gjithçka e lënë trashëgim nga të parët është rrënuar e shkatërruar. Madje është ruajtur diku me kujdes dhe diku me fanatizëm.

Të lezetshme dhe me plot hijeshi ishin çezmat e vjetra në mes të fshatit, të cilat diku punonin dhe diku tjetër kishin dalë jashtë çdo lloj funksioni.

Akoma dhe më interesante ishin çezmat, të cilat kishin disa govata prej druri ose prej betoni, e kjo e fundit ngjante si ndonjë vaskë e madhe krejt natyrale.

Këtu shpesh gratë e fshatit mbushnin shtambat me ujë ose lanin qilimat në ujë të ftohtë. Qëllonte në jo pak raste që gjatë shkundjes së qilimit këtë ta mirrte me vete lumi. Gurrat e këtyre fshatrave e kishin ujin akull të ftohtë.

Nw njw atmosferë interesante: nga njëra anë ishte gurra e ftohtë sa nuk bëhej dhe nga ana tjetër ishin kazanet me ujët valë.

Gratë pasi lanin qilimat në ujin e ftohtë, i shtinin ato në ujin valë të kazanit.Veçse qilimi nuk ka shpirt, por se dukej si një njeri, i cili lahet njëherë me ujë të ftohtë dhe menjëherë më pas i lëshon vetes ujë të nxehtë përvëlonjës.

Natyra ishte fantastike.Më shfaqej përpara syve gurra e cila e çante më dysh një mal të tërë me pyje përreth dhe që rrugëtimin e vet e mbaronte në Dri.

Ekzistojnë ndër fshatra edhe "burimet e shenjta" ose siç i quajnë disa zona të Dibrës "izvoret" e këto janë vende ku thuhej se po të lahesh në ato vende bekohesh.

Edhe vetë e kam përjetuar këtë lloj "bekimi", jam larë e lagur me atë ujë burimi që rridhte nga thellësia e barkut të malit dhe se në fëmijëri i besoja besytnisë së zonës.

Shkurt ishte një oaz, një pamje e mrekullueshme me ajër të pastër dhe një mjedis krejt idilik. Kjo ishte bukuri fine, krejt natyrale, ku nuk kishte ndërhyrë as zezonja dhe as fëlliqësia.

Bukuri që Zoti apo Natyra e kanë ndërthurrur krejt në mënyrë magjepsëse. Bukuri e një zone të rreptë e cila gërshëtohet mjaft bukur me mjedisin romantik natyror.

FSHATRAT NË MALE

Në Maqellarë, si antipod i Drinit është Korabi. Kështu edhe si antipod i fshatrave që shtrihen në fushë e në Luginë të Drinit janë fshatrat kodrinor e malor që shtrihen buzë Korabit ujëvarërave e shkëmbenjve të malit tonë kryelartë.

Kam shëtitur rrezikshëm në adoleshencë në fshatrat e largët buzë Korabit. Aty ç'nuk mundesh të gjesh.Aty gjen humnera, vende të thepisura, shpate, tunele, gropa dhe shpella.

E kam shëtitur këtë zonë në të hyrë të pranverës, por se çudia është se në fushat e pakta atje në Korab edhe në mars e në prill gjendet borë. Vetëm e imagjinoja sesa i egër mundet të jetë dimri këtu. Më dukesh tamam si Olimpi ky Korabi ynë.

Kjo sepse kur shkoje pranë një shpelle tregonin se këtu natën vijnë arushat dhe se ajo e madhja të shqyente nëse ia prekje arushat e vogla. Kur hasëm një humnerë, tregonin se këtu një djali i kishte rrëshkitur këmba, ishte bërë copë-copë atje në hon dhe se më tej njerëzit rreth tij kishin ndezur zjarr për tia ngrohur trupin.

Kur hasje një barishte të keqe mbi një shpatë mali të rrezikshëm thonin se një djalë duke u përpjekur të ngjiste malin, duke u kapur prej barishtesh, ajo ishte këputur dhe djalit as trupi nuk i ishte gjendur.

Por edhe atje në majë të malit kur u ngjitëm dëftonin se këtu ushtarët maqedonas e kishin vrarë një bari shqiptar. Madje thonin në mënyre makabre dhe krejt brutale.

Dy ushtarët-rojë nga ana tjetër e kufirit kishin zënë në fall se kush e godiste bariun, ai e fitonte lojën.

Jeta e një njeriu për ata ushtar-rojë ishte thjesht një lojë, e cila luhej me armë të vërteta..

Fshatrat këtej në male e në kodrina janë një mozaik më vete. Ata përmbajnë brenda vetes legjenda, mite, përrallëza të cilat qarkullojnë ndër sheshe e ndër rrugica të këtyre vendbanimeve.

Edhe fshatrat malorë, sikundër ato në fushë kanë çezmën në qendër të vetes si një relike e kohëve shumë më të vjetra, ndoshta atëherë kur Zotat ishin ato që tregoheshin se rrinin ndër male.

Edhe ndër këto fshatra ka shtëpi që ruhen të ndërtuara me pite prej balte apo me të tjera përmbajtje, që gjenden me shumicë këtyre anëve.Fshatrat kodrinorë ngjajnë si të fshehura në brezaret e kodrave dhe se prej secilën gëlon jetë e se më tej e gjitha kjo shndërrohet në aktivitet të përditshëm jetësor e shpirtëror.

FEJA, FJALA, BESA

Banorët e këtyre anëve kanë veçanti dhe karakteristika që përbëjnë vlera për zonën, krahinën, por edhe republikën e pse jo më gjërë.

Ndërsa është dëgjuar se në Veriun e Shqipërisë ruhen me fanatizëm zakone dhe tradita të së shkuarës, në Maqellarë ka tradita që ruhen – por se fatkeqësisht koha i ka venitur shumë prej tyre.

Një tipar i veçantë ndër dibranë në disa zona kam vërejtur se është feja.

Përpos fesë, në brumosjen morale të banorëve edhe fjala zë vend të rëndësishëm. Fjala dhe besa e fisnikëron dibranin.

Këta dy elementë sidomos e fisnikërojnë njeriun e këtyre anëve. Njeriu që i ka të tilla cilësi, përzier me qetësi përgjithësisht ndodh të jetë më i nderuari në komunitet.

Sigurisht që një njeri që të nderohet në këto anë jo doemos duhet të besojë në Zot, por të ketë elementë si dituria, qetësia, fjala e pakët e me vend si dhe besa.

Patjetër që edhe të thënit e të vepruarit drejt. Personi i cili mashtron apo që nuk e ka elementin e drejtësisë, fjalën e dhënë, besën nuk është se dënohet – por se ndodh që të diferencohet nga shoqëria.

KUFIRI FIZIK DHE MENTAL

Kufiri në Bllatë lidh Shqipërinë me Maqedoninë dhe është aty në mënyrë fizike, mundet krejt i përhershëm. Ky kufi është pjesë e pandarë e njerëzve të këtushëm.

Ekziston ndër banorë kufiri i brendshëm dhe i afërt, por edhe i jashtëm dhe i largërt. Kufiri mental i brendshëm është ai se akoma ka disa robërira për gjininë e dobët dhe se akoma qëndron mentaliteti që rri hijerëndë dhe i plotfuqishëm.

Thashethemet, të thënat dhe të pathënat, përfoljet dhe përgojimi në segmente të shumta është i gjallë.

Morali dhe forca e zakonit qëndrojnë hijerënda e kokëlartë.

Imoraliteti në këtë zonë dënohet nga shoqëri e gjërë dhe po e them këtë pa qenë në gjendje të them nëse kjo është gjë e mirë apo e keqe – thjesht është veçori e zonës ku jam rritur.

Morali i zonës sidoqoftë ka shumë fuqi, madje të jashtëzakonshme. Duket se kjo është vazhdimësi e traditës së zonës pasi këta njerëz e njohin kufirin e jashtëm dhe "botën" jashtë në mos më tepër se çdo zonë tjetër e Dibrës.

Këta banorë kanë shkelur për punë në Greqi, Itali, Gjermani e deri në Francë e në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në kufirin këtej ku është territorialisht Shqipëri më së shumti ikin nëpër shtete fqinje dhe jo kaq larg; ndërsa përtej në zonën e Maqedonisë më shumë kanë ikur drejt SHBA-ve.

Tipar pra i zonës është se pavarësisht se kanë parë botë me sy, me sa duket modernitetit i marrin më të mirën dhe ia injorojnë të ligën.

Thithin pjesën se jetojmë në kohë të materializmit dhe se për këtë duhet punuar fort ndershmërisht dhe nga ana tjetër e injorojnë imoralitetin që ka përfshirë sidomos perëndimin.

E kjo padyshim është vlerë e shoqërisë së kësaj zone, ku njerëzit pavarësisht arratisë në kërkim të parasë mbajnë të paprekur moral e traditë.

4 prill 2016

Udhëtim në kohë përmes fotografisë

E kam me vete Dibrën time

E kam me vete Dibrën time. Nuk e lash atë ditë korriku '96. Nuk mund ta lija. Ishte dhe është e imja. E si mund të lihet një jetë nga jeta jote dhe të ikësh, të marrësh arratinë "Nëntë male kaptuar", si në legjenda?

Ika pa i thënë lamtumirë, pa u marrë ngrykë me njerëzit e gjakut tim, me njerëzit që më deshën dhe më duan, me njerëz që më bënë dhe i bëra vëlla e motër?

Ika natën...

E mora me vete vendlindjen e vendpunën e time pesëdhjetë e pesë vite jetë. E mora në kujtime që nuk mi ndali greku atë ditë të 21 korrikut 1996 në doganën e Kakavijës. Edhe po të mi kërkonin, edhe po të ngulmonin, edhe po të më ndalonin, nuk mi merrnin dot, nuk mund t'i shkulnin dot, janë rruaza të kuqe të gjakut, deje të padukshme të shpirtit.

E kam me vete Dibrën time. E kam në mijëra negativë filmash fiksuar që nga Stebleva në Reç, nga galeritë e kromit të Bulqizës në ato të Balgjait, nga liqenet e Lurës dhe Kacnisë në Ponairin në kurorë të Korabit...

Oh sa rinohem tash që i shoh dhe i jetoj si dikur...

E kam edhe në dhjetëra blloqe shënuar që nga viti 1974, mbush me njerëz e me fjalët e tyre që më ngjallin mall e dashuri...

Fotografia, që me dëshirën e madhe e kërkoja midis mijëra negativash, më erdhi e para.

E doja shpirtërisht sepse njeriu në fotografi (1975) tash doktor profesor i shkencave mjekësore, Nazmi Koçi ma zgjoi kënaqësinë që po përjetoj duke udhëtuar nëpërmes fotografive Dibrës mbarë. Më dhuroi një skaner të ri profesional...

Ndonëse larg, 20 vite larg, kam me vete Dibrën time.

Po ua përcjell lexuesve të "Rruga e Arbërit" për të jetuar të djeshmen e për të ndërtuar të ardhmen...

Abdurahim Ashiku
Athinë, 29 prill 2016



Mjeku Nazmi Koçi gjatë punës (1975)



Kostarët e Bjeshkëve të Vleshës



Veterineria Gjystine Rajta në livadhet e Krej-Lurës.



Minatorët



Barinjtë e Korabit



Heronjtë e Trebishtit



Mësuesi i Fushë Çidhnës

Rruga e Arbërit nr. 120

veprimtari

Ditë olimpike në shkollën "**Sarina**"

Nga **Zabit LLESHI**



shkolla "Sarina" ka nxënës ekselentë në mësime, të dalluar në veprimtaritë sportive e fizkulturore, si Renatao Sula, Gledis Asllani, Zurie Kupa, Edlira Lama, Bernaldo Kaja, Samel Hoxha, Ergi Hoxha, Elton Dega, Gerti Duka, Arsemina Meraj, Emanuela Pupa, Pamela Menaj, Launora Cahani, Rudina Besa

Shkolla 9-vjeçare dhe e mesme jo publike "Sarina 2002" është ndër shkollat e dalluara në qarkun e Tiranës. Ajo tashmë ka një përvojë 14-vjeçare në procesin mësimor dhe edukativ. Këtë e trgojnë rezultatet gjithnjë në rritje të nivelit të nxënësve, duke siguruar dije të qëndrueshme në zbatimin e kurrikulës parauniversitare. Tregues pozitiv gjithashtu janë regjistrimet në shkollat e larta të maturantëve të kësaj shkolle. Në vitin shkollor 2015-2016 më shumë se 90% e tyre filluan universitetin brenda e jashtë vendit.

Një traditë mjaft të mirë e përvojë pozitive kjo shkollë ka krijuar në veprimtaritë kulturore e sportive. Krahas veprimtarive të planifikuara gjatë këtij viti shkollor, java olimpike në ditët e para të muajit që kulmoi më 6 prill u kthye në një manifestim të bukur fiskulturor sportive. Drejtori i shkollës Qazim Karaj dhe Presidenti i saj z.Liman Hoxha krijuan kushte për zhvillimin sa më optimal të këtij aktiviteti. Kështu, sipas një programi të veçantë, e gjithë dita u mbulua me aktivitete të tilla nga klasat e pesta deri në të dymbëdhjeta.

Programet e hartuara me garat e vrapimeve, gjimnastikës, lojëra sportive, tërheqje litari, loja shahuetj, vunë në lëvizje shoqatat sportive për t'u paraqitur sa më denjësisht klasat, skuadrat përfaqësuese etj, me moton: "Më shpejt, më lart, më fort". Të gjithë nxënësit morën informacion për lëvizjen olimpike., si një lëvizje e paqës e miqësisë e mirëkuptimit, midis popujve dhe vetë sportistëve.

Vrapimet e gjata çelën festën sportive nga nxënësit e 9-vjeçares. Sipas klasave e moshave, vendet e para i ndanë Elvira Dapi, Jurgen Hasani, Oligert Skarra, Kevin Cahani, Danjela Gjediaj, Ijad Himallari, Eriselda Ahmeti, Arbër Matraxhi, Erida Matraxhi, Alban Çejku dhe Griselda Bjeshka. Për shkollën e mesme fitues në 600 m u shpallën Endion Matraxhi dhe Avjola Shima. Në vrapimet e shpejtësisë vendet e para i morën Kristi Hoxha dhe Kristina Duçollari.

Lojërat sportive filluan me futbollin mes klasës 8a dhe 9a, 6a me 7b, vab me 6b. Fitues u shpallën klasa 9a, 7b, 6a dhe përfaqësuesja e klasave 5ab. Për vajzat, klasa e 6a fitoi me të 6b.

Në pushimet e ndeshjeve u vunë përballë tyre klasat paralele për djem dhe vajza në tërheqjen e litarit, ku u ndoq me interes e emocione loja e forcës tërheqëse midis skuadrave përfaqësuese. Klasat 7b, 6b, 5b për djem dhe 6a, 7b, 9a për vajza, u shpallën fituese të garës.

Një grup vajzash nga shkolla e mesme dhe klasave të 6-ta ekzekutuan një kompleks ushtrimesh gjimnastikore, me elemente të programit të edukimit fizik në gjimnastikë. Në përbërje të këtij grupi ishin: Romina Hoxha, Igla Morina, Suela Daku, Marsela Elezi, Arlinda Çera, Ermir Veseli.. Mjeshte e sportit në gjimnastikë Auela Hoxha, nxënëse e klasë 12, u dorëtrokit gjatë nga sportistët e vegjël, kur ajo demonstroi në tapetin e gjelbërt ushtrime të vështërisë së lartë.

Në gjysmën e dytë të ditës matën forcat midis tyre sportistët e shkollës Mesme në ndeshje basketbolli djem e vajza të maturave, ku spikati loja e klasës 12a për djem dhe 12 b për vajza. Gjatë lojës u manifestua sjellje sportive për t'u admiruar, ndërmjet të cilëve ishin: Behar Doda, Leo Kaca, Ergi Hoxha, Anisa Xhafa, Isma Kurti, Klementina Mema, Elida Pepkola, Gledis Asllani etj.

Ndeshjet e baketbollit u pasuan me ato të volejbollit, ku vajzat e klasës 9a u ndeshën me ato të të 9b dhe klasa e 10 u ndesh me klasën 11. Ishte një lojë me nivel teknik të kënaqshëm , ku u dalluan Enada Basha, Kristina Marashi, Arlinda Muslia, Enada Bralika, Selma Himallari, Launora Cahani, Rudina Bera, Pamela Menaj etj.

Ndue Kolndreu, mësuesi i pasionuar me shahun, ndihmoi për mbarëvajtjen e një minikampionati që u zhvillua në një nga sallat e shkollës së mesme. Kampionët e shahut Erixhon Rika, Kristina Duçollari, Elton Dega, Leo Kaca, Albana Sela, vazhdojnë të tërheqin pas vetes shumë djem e vajza në këtë lojë të bukur sporti si Denald Vukaj, Samul Laze, Enest Sula, Rei Mustaqja etj. Mjaft të rinj të shkollës Mesme në kohën e lirë ushtrojnë lojën e pingpongut. Armando Suli e Nderim Makishti, Petrit Selmani, shquhen për konkurencë të forte në ndeshjet e zhvilluara në këtë lloj sporti zbavitës.

Mësuesit e edukimit fizik Nafie Lleshi e Maks Hoxha (mësues praktikant), së bashku me mësuesit kujdestarë, ishin në krye të zhvillimit të veprimtarisë. Ata vlerësuan deri në detaje orët e takimeve, gjykimin e lojërave, disiplinën e rregullin deri uniformat sportive. Gjithashtu ata përgatitën komunikatat, ku nën patronazhin e mësuese Shpresës, Plomento Çanga herë pas hera jepte rezultatet e lojërave dhe fituesit e garave, duke nxitur sedrën sportive për rezultate sa më të mira.

NXËNËS TË MIRË SPORTISTË TË DALLUAR

Pa mburrrje themi, se shkolla "Sarina" ka nxënës ekselentë në mësime, të dalluar në veprimtaritë sportive e fizkulturore, si Renatao Sula, Gledis Asllani, Zurie Kupa, Edlira Lama, Bernaldo Kaja, Samel Hoxha, Ergi Hoxha, Elton Dega, Gerti Duka, Arsemina Meraj, Emanuela Pupa, Pamela Menaj, Launora Cahani, Rudina Besa etj. Disa prej tyre janë drejtues të shoqatave sportive, shembull në organizimin e lëvizjes fiskulturore në shkollë dhe kanë kontribut të rëndësishëm për nxitjen e interesave tek të rinjtë për t'u marrë me fizkulturë e sport. Ata janë dhe do të mbeten krenaria e shkollës "Sarina".

Një pjesë e nxënësve stërviten me ekipet e kryeqytetit, sipas moshave, si Aurela Hoxha në gjimnastikë, Jurgen Përzhilla në karate, Oksana Batishaj dhe Kristina Duçollari janë pjesëmarrëse në disa turne ndërkombëtare në shah, Henri Kaci në not etj. Në futboll, Kevin Cahani, Arbër Matraxhi, Indrit Muçodemi, Reald Xhelili, Islam Kolgjini, Rigers Hoxha, Paulo Përlalaj, Irgen Hasani, Rei Musteqja, Miftar Kuçi, Alban Çejku, Kristi Kume, Hamdi Picari, Mikel Bralika, Petrit Selmani, janë sportistë cilësor me të ardhme. Në volejboll dallohen Iris Lleshi, Igla Morina, Nderime Methasani etj. Këta nxënës dhe të tjerë, janë të avancuar në përvetësimin e programit të edukimit fizik, prandaj mësuesit përpiqen të punojnë me programe të avancuara në shërbim të rritjes së rezultateve në sported që ushtrohen bashkë me përgatitjen e tyre për gjykimin e lojërave sportive si dhe organizimin e veprimtarive në klasë, komunitet apo qendra administrative ku do të punojnë në një të ardhme të afërt.

Për të realizuar këto objektiva vetë shkolla ka dhënë ndihmesën e saj me terrenet sportive, sigurimin e bazës materiale për të gjitha llojet e sportit. Ditët Olimpike e treguan më së miri përgatitjen cilësore të nxënësve.





studim

GJUHA E URRREJTJES

Nga **Xhafer MARTINI**

Shkrimtari Xhafer Martini ka përfunduar monografinë për Arbën Xhaferin duke marrë për studim të gjitha intervistat e tij botuar në dy libra dhe në shtypin e ditës ose në televizor.Krahas shumë problemeve që Arbën Xhaferi i trajton me kompetencë dhe profesionalizëm, është edhe ai për Gjuhën Shqipe që në këtë monografi zë një kapitull të veçantë. Këtu poshtë po japim një pjesë të këtij kapitulli, që ka të bëjë me përdorimin praktik të gjuhës dhe që mban titullin "Gjuha e urrejtjes".



"Në shumicë, - thotë Arbën Xhaferi, - familjet shqiptare nuk përdorin këtë gjuhë të urrejtjes, kanë sjellje të kulturuar, kanë respekt ndaj njeri-tjetrit.
... kur futesh në rrafshin politik, njerëzit xhindosen dhe përdorin fjalë që as në ëndërr nuk do të përdornin kundër komshijve të tyre. Çfarë do të thotë kjo gjuhë e urrejtjes?

Arbën Xhaferi e shikon gjuhën në dy rrafshe: në zhvillimin e saj historik dhe në rrafshin e përdorimit të saj në praktikë që ka të bëjë me kulturën e të folurit.Në këtë shkrim do të trajtojmë vetëm aspektin e fundit. Gjuha është mjet komunikimi, ajo u shërben njerëzve për të bashkëvepruar në procesin e të gjitha veprimtarive jetësore. Gjuha ka shumë aspekte të përdorimit. Funksioni i përdorimit publik të gjuhës është më i rëndësishmi. Kjo është gjuha e fjalimeve publike, bisedave, debateve e të tjera forma të komunikimit që transmetohen nga mjetet e komunikimit, si edhe gjuha e librave, gazetave, revistave dhe çgo gjëje tjetër të shkruar. Në të gjitha rastet dhe mënyrat e shprehjes së saj, gjuha duket sikur është "indiferente", por në të vërtet është si thika, që, në dorë të kriminelit i merr jetën njeriut, kurse në dorë të kirurgut, i shpëton jetën atij. Prandaj ajo varet nga përdorimi që i bëjmë.

Arbën Xhaferi gjatë këtyre njëzet e pesë vjetëve të pluralizmit politik i ka bërë pështypje të keqe përdorimi i gjuhës së urrejtjes me anën e të cilës njerëzit i drejtohen njeri-tjetrit. Shembullin më të keq e japin politikanët, analistët, gazetarët dhe në përgjithësi ajo që quhet elitë, e cila, më shumë se kushdo tjetër, po i bën varrin Shqipërisë. Shoqëria jonë gjatë këtyre 25 vjetëve të fundit është çmendur fare. Njerëzit e lëndojnë njeri - tjetrin me fjalët më të ulëta. Fyerja është më e rëndë se vrasja. Fjala vret më shumë se plumbi. Plaga e plumbit mund të shërohet ose harrohet, kurse palga që hap fjala as shërohet dhe as harrohet kurrë. Fjala, siç e thamë, ka funksion të dyfishtë: kur është e ëmbël, e ndershme, e sinqertë, të lumturon dhe të jep krah për të fluturuar, kur është e hidhur, të helmon shpirtin dhe ta bën jetën të zezë. Këto dy anë të fjalës ka pasur parasysh Hans Joachim Lansch kur shkruan: "Fjala ka peshë, fjala ka ngjyrë.Fjala ka aromë. Fjala ka temperaturë. Fjala ka tingull. Fjala ka thellësi. Fjala ka naltësi, gjanësi, ngushtësi. Fjala asht pejzazh. Fjala vepron, fjala flet, fjala hesht, fjala asht e gjitha. Fjala merr frymë, fjala frymëzon. Fjala vret nëpërmjet shpirtit që qëndron në të, fjala jep jetë. Fjala është fillimi i gjithçkaje, thelbi i gjithçkaje." [1] Një analist shkruan se gjuha e politikanëve, e liderve partiakë, gjuha e komentatorëve të televizioneve dhe e shtypit, është shumë agresive dhe e papërmbajtur. Ajo ndez pasionet më të egra tek njerëzit, zgjon bishat që flenë në thellësi të qenies. Ky është "diskursi denigrues e përçmues, diskursi që konflikton e ndjek që fjalët të shndërrohen në bomba, autobomba, shigjeta homerike, në leva me të cilat thyhen kokat...diskursi që synon atentate, ekzekutime publike e verbale, që në ekstrem ka për synim restaurimin e diktaturës". [2] Stefan Cvajgu në monografinë për "Zhorzh Fushenë" ka edhe një frazë si kjo: "Faji i revolucionarëve francezë nuk qëndron, pra, në etjen e tyre për gjak, por në fjalimet e tyre të përgjakura; ata e bënë këtë marrëzi vetëm për të entuziazmuar populin, për t\i provuar vetes se ishin radikalë; ata krijuan zhargonin e tyre të gjakosur dhe vazhdimisht flisnin përçartë për tradhëtarë e gijotinë." [3] Karakterin e dyfishtë të gjuhës, në varësi të përdorimit, e ka dhënë shumë bukur në vjershën "Kujdes me fjalën" edhe poeti Dritëro Agolli:

"Me fjalën rrjedhin përrenj me mjaltë,
Pikojnë çezma me helim të zi.
Kujdes me fjalën, zonjëz me çantë,
Kujdes me fjalën dhe ti, zotëri.
Nga fjala humbën Judë dhe Pilatë,
Strategë, mbretër, mbretëri,
Kujdes me fjalën zonjëz me çantë,
Kujdes me fjalën dhe ti, zotëri". [4]

Kjo nuk do të thotë aspak të mos kritikojmë, madje ashpër, kur kjo është e nevojshme. Kjo nuk do të thotë që të biem në kompromis me të keqen, me atë që na pengon për të ecur përpara e çfarëdo natyre qoftë dhe kundër cilitdo që e shfaq atë. Kur flasim për gjuhën e urrejtjes dhe e dënojmë atë, nuk jemi për "gjuhën e drunjtë", që nuk thotë asgjë.Kësaj mënyre të shprehuri populli i thotë "as mish, as peshk". Pra, gjuha e urrejtjes është tjetër. Përdorimi i kësaj gjuhe krijon një klimë terrori, pasiguri për të gjithë, dhe më në fund, kaos, rrëmujë dhe luftë civile. Arbën Xhaferi si një dijetar i madh dhe i urtë e kritikon shumë ashpër klasën politike shqiptare këndej dhe matanë kufijve shtetërorë, por ai asnjë nuk shanë, asnjë nuk urren. Ai për ngjarjet e vitit 1997 që e shkatërruan në themel vendin, fajson klasën politike shqiptare,e bën atë fajtore të plotë për rrënimin e Shqipërsë dhe humbjen e jetëve të mijëra njerëzve. Gjuha e urrejtjes në një afat të gjatë dhe përfundimtar ka për qëllim të restaurojë të kaluarën, të kthejë të kaluarën, duke refuzuar të tashmen dhe tendecat e saj. Kur gazetar Robelli e pyet Arbën Xhaferin se cili është personaliteti politik më i urryer historik, ai thotë se është Haxhi Qamili. Haxhi Qamili nuk ka qenë filozof e mendimtar, por në rrugën ku hyri, për qëllimin që u përdor, deshi të restaurojë të kaluarën, të kthejë Baba dovletin prapë në Shqipëri. Është njësoj, thotë Arbën Xhaferi, sikur sot haxhiqamilët shqiptarë që jetojnë matanë kufijve shtetërorë të përpiqen të restaurojnë Jugosllavinë, kurse haxhiqamilët në Shqipëri të restaurojnë komunizmin. Haxhiqamilizmi, si përpjekje për të restauruar të kaluarën është, është traditë shumë e hidhur

Haxhiqamilizmi me pak fjalë është ideologji e revanshizmit, e kthimit mbrapsht. Politikanët tanë janë me vetura të shtrenjta dhe jetojnë në luks dhe pasuri, venë në dorë orë dhjetramilionshe, përdorin celularë të shtrenjtë, presin dhe qepin kostume të modës së fundit, por, sipas gjykimit dhe paralelizmave që heq Arbën Xhaferi, për derisa përdorin gjuhën e urrejtjes, që prodhon fatkeqësi, kaos dhe luftë civile, janë feudalë dhe haxhiqamilistë. Ne themi se ndërtojmë demokracinë, shprehet Arbën Xhaferi, por nuk kemi hequr dorë as nga Haxhiqamilizmi dhe as nga Enverizmi.

Diktatura përdorimin e gjuhës së urrejtjes që mbillte frikë dhe pasiguri, e kishte platformë politike të menduar mirë. Qëllimi i saj ishte që njerëzit të jetonin në një ankth të vazhdueshëm, nën trysninë e frikës dhe të terrorit. Shprehjet më të përdorshme ishin: "të jetojmë si në rrethim", "të jetojmë si në luftë", "t\u bëjmë ballë një koalicioni me armiq" e të tjera. Në përshtatje me këtë klimë tmerri vinte edhe veprimtaria praktike: roje gjithandej, në të gjitha institucionet, shkollat, qendrat e punës dhe të prodhimit, kudo ku kishte një ndërtesë ose një derë. Këto pasoheshin nga zboret raskapitëse, alarmet e vazhdueshme, ku populata, gra dhe fëmijë, grumbulloheshin dhe futeshin nëpër tunele si dhentë në shtrungë dhe i linin aty derisa asfiksosheshin. Të përjavshme ishin aksionet "revolucionare" që u merrnin njerëzve të vetmen ditë pushimi që kishin; shumë të shpeshta dhe të mërzitshme ishin mbledhjet, format e edukimit ku lexoheshin librat më të mërzitshëm dhe më terrorizues në botë. Të gjitha këto bëheshin për t\i mbajtur njerëzit në tension, në alarm. Pse veprohej kështu? Këtë e shkakton mungesa e perspektives, humbja e shpresës, humbja e besimit tek vetja, dhe, për të mos rënë në greminë, përpiqesh të ruash statu quonë. Por ruajtja e statu quosë është tragjike. Statu quaoja për Enver Hoxhën ishte ruajtja e pozitës së tij, sundimit të tij, me çdo çmim. Autori Brend Fischer shkruan: "Me sa duket ai kishte kuptuar se që të mbante pushtetin duhet të rrënjoste mendësinë e luftës dhe t\i mëshonte nocionit të pranisë së armiqve kudo, të brendshëm dhe të jashtëm. Lufta duhej mbajtur gjallë sikur të kishte përfunduar një ditë më parë. Mendësia e rrethimit, e cila erdhi dhe u bë një tipar i qenësishëm i ideologjisë së Enver Hoxhës dhe karakterizoi regjimin e tij deri në ditën e vdekjes së tij, më 1985, mund të vihet re, pjesërisht, edhe në plenumin e Beratit, në nëntor të vitit 1944." [5]

Kjo gjuhë e urrejtjes, vëren Arbën Xhaferi, nuk është e natyrës së shqiptarit, e traditës tonë kombëtare dhe familjare, ku, përkundrazi, sundonte maturia, vetëpërmbajtja dhe dashuria për njeri-tjetrin. "Në shumicë,- thotë Arbën Xhaferi,- familjet shqiptare në Shqipëri nuk përdorin këtë gjuhë të urrejtjes, kanë sjellje të kulturuar, kanë respekt ndaj njeri-tjetrit. Mirëpo, çuditërisht kur futesh në rrafshin politik, njerëzit xhindosen dhe përdorin fjalë që as në ëndërr nuk do të përdornin kundër komshijve të tyre. Çfarë do të thotë kjo gjuhë e urrejtjes?" [6]

Përse përdoret kjo gjuhë në politikë? Përdoret se politika nuk është në shërbim të popullit, ajo ka njëzet e pesë vjet që nuk po e ndryshon gjendjen, por vetëm po e keqëson. Por, pavarësisht nga kjo, çdo politikan don të mbaj vendin që ka, nuk don t\i humbasë të mirat që gëzon. Në Shqipëri luftohet të ruhet gjendja ekzistuese, statu quoja, e kuptuar si sundim i këtyre partive politike me anë të alternimit të pushtetit. Pikërisht për këtë arsye politikanët fabrikojnë gënjeshtra, mashtrime. Për mosrealizime, por mosmbajtjen e fjalës së dhënë para elektoratit, faji i hidhet opozitës. Ky është armiku i sotëm.Por, kundër armikut, siç thotë tradita e diktaturës, duhet luftuar fortë, edhe me bateritë e fjalës. Le të jetë fjala sa më e hidhur, sa më vrastare. "Çfarëdo të thotë kjo gjuhë e urrejtjes?-pyet Arbën Xhaferi dhe përgjigjet: "Mendoj se është zëvendësim për mungesën e ofertës politike, është një mungesë e projekteve të vërteta për rimëkëmbje ekonomike, shpirtërore të Shqipërisë dhe, meqë duhet të futen në zgjedhje, atëherë potencohen mangësitë e sajuara artificialisht të kundërshtarëve." [7]

Për këtë të arsye zgjedhjet në vendin tonë, edhe sikur të jenë vërtet të lira dhe demokratike, nuk nuk prodhojnë zgjidhje për hallete popullit. Populli nga këto zgjedhje nuk fiton asgjë. Arbën Xhaferi me të drejtë thotë: "Mendoj se me këtë mënyrë nuk fitohen zgjedhjet, por fitohet vetëm një mandat për të vazhduar më shumë këtë lloj satanizimi të njeri-tjetrit." [8]

---

1) Gazeta "Fjala", 16-17 shkurt 2003
2) Migjen Kelmendi: "Carere Patria" –mungesa e atdheut-, f. 76, pa vit botimi.
3) Xhafer Martini: "Kanun", Tiranë 2013,f. 127
4) Dritëro Agolli: "Pelegrini i vonuar", tiranë 1993. (Vjersha "Kujdes me fjalën")
5) Brend Fischer: "Diktatorët e Ballkanit", Tiranë 2009,f.273
6) Rudina Xhunga: "12 porositë e Arbën Xhaferit" (intervista), Tiranë 2012,f. 184
7) Po aty
8) Po aty

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?
SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!
< rrugaearberit@gmail.com >

Me rastin e
60 vjetorit të vdekjes

Besimtari, *qëndrestari dhe* **firmëtari** *i pavarësisë* **Hafiz Sherif Langu**

Nga **Mevlud BUCI**, *studiues*

Figurat e ndritura të Dibrës, provat e tyre për Çështjen Kombëtare janë të shumta ndaj kërkojnë vëmendje, vijimësi studimore dhe vlerësime sa më të thella e të plota. Një nga rilindësit e fundshekullit XIX dhe e gjysmës së parë të shek. XIX është edhe prijsi i besimit, mendimtari dhe firmëtari i pavarësisë kombëtare në Kuvendin e Vlorës më 28 Nëntor 1912 Hafiz Sherif Langu (Imami). Jo rrallë herë është folur e cituar veprimtaria e këtij atdhetari, por në këtë shkrim modest (sigurisht mund të shkruhet për mjaft ngjarje, bëma e prova të këtij vigani të lidhur me vendlindjen, Dibrën e Madhe me kohën e Çështjen Kombëtare. Shembëllimi atdhetar, ndihmesa për gjuhën shqipe, për besimin e për problemet e ngjarjet e rëndësishme kombëtare, përpjekjet në ndihmë të vazhdueshme të përparimit, lirisë, vëllazërimit dhe çështjes së pavarësisë. Duke patur rastin e 60 vjetorit menduam të shfaqim disa mendime mbi jetën e veprën e tij të paharruar, deshëm të shlyejmë edh enjë detyrim human për të në kuadrin e 100 vjetorit të pavarësisë ku fotoja e tij e rrallë më erdhi me vonesë nga Dibra e Madhe.

***

Hafiz Sherif Langu (Imami) u lind në Dibër të Madhe në vjeshtën e vitit 1870 në një familje të shquar për dashuri ndaj kombit, diturisë, vëllazërimit e përparimit, për çështjen e gjuhës amtare dhe kulturën e fesë islame në dobi të atdheut e të edukimit të brezave. Si nip i Selim bej Rusit, u mëkua me dashuri për dije, u ndihmua prej tij në stadet e shkollimit. Pasi kreu më 1883 në Dibër shkollën e ulët në gjuhën shqipe, familja e dërgoi për studime në Manastir. Gjatë shkollimit dhe më pas Hafiz Sherif Langu (Imami) u njoh me atdhetarë e rilindas të shquar, të cilët luajtën rol në formimin atdhetar duke bërë që ky të përkushtohet besimit, Dibrës, përparimit, çështjes kombëtare. Faktet dëshmojnë se ky atdhetar e besimtar i shquar ndihmoi edhe për shpërndarjen e abetareve në Dibër e më gjerë.

Shembëllimi prej rilindësi e organizatori u pa në të gjitha ngjarjet e rëndësishme që kaloi Dibra. "Hafiz Sherif Langu, - shkruan Atli Imami – nën ndikimin e Said Najdenit, alias Hoxhë Vokës, Kadri Fishtës, Shaqir Dacit, edhe pse ishte imam në lagjen Dervish Mustafa të Dibrës, nuk e pengoi aksioni i shpërndarjes së abetareve në Dibër e më gjerë. Ai, madje, bashkë me patriotët e tjerë dibranë, më 27 shkurt 1899 merr pjesë në Kuvendin e Madh të Dibrës". I përkushtuar për besimin dhe për ngjarjet e kohës Hafiz Sherif Langu Imami ishte ndër anëtarët kryesorë të degës së organizatës xhonturke e saktësuar "Bashkim e Përparim" (me qendër në Manastir) synimi i të cilës ishte të përmbyste despotizmin dhe formën e regjimit të sulltan Hamidit. Është fakt se Dibra e dibranët qenë kundërshtarë të flaktë ndaj politikës turke për shkollat në gjuhën tonë amtare. Qenë të shumtë atdhetarët që kundërshtuan e luftuan për dritën e diturisë. Kështu në fund të dhjetorit 1908 u krijua në Dibër të Madhe Klubi Atdhetar "Bashkimi", i cili luajti rol parësor e mjaft me rëndësi për problemet kombëtare të kohës. Me të drejtë shkrimtari e atdhetari i shquar Haki Stërmilli ka pasqyruar emrat e shumë patriotëve më në krye kryetarin e klubit "Bashkimi", Hafiz Sherif Lanun.

Me nismën e veprimtarëve të këtij klubi më 1909 u dërguan në Elbasan, normalistët e parë si Haki Sharofi e Maliq Daci, ku më parë që Osman Muglica, ndërsa Hafiz Sherif Langu u dërgua për t'u përgatitur në një kurs. Veprimtaria e Hafiz Sherif Langut si në fushën fetare, politike



e atdhetare nuk u zhvillua vetëm në rrethinat e Dibrës dhe të Manastirit, por ajo shtrihet në Mat dhe Elbasan. Në Elbasan bashkëpunoi me Aqif Pashën, Luigj Gurakuqin, Aleksandër Xhuvanin e disa atdhetarë të tjerë.

Ndihmesa e Hafiz Sherif Langut ishte e madhe, e rëndësishme dhe mjaft efektive për gjuhën shqipe, për besimin e veprimtaritë në ndihmë të kombit. Fakti që ky korife i mendimit dhe i veprimit atdhetar së bashku me atdhetarin Shefqet Daiun, si përfaqësues të Elbasanit, shkuan në administratën osmane në Manastir për të nxjerrë leje për hapjen e shkollës Normale në gjuhën shqipe në Elbasan. Në Manastir, atdhetari Fiqiri Rusi, që ishte e punësuar pranë kësaj administrate, ndihmoi në miratimin e autorizimit, që u kurorëzua me hapjen e kësaj shkolle në vitin 1909.

Krahas ndihmesës për shkollat shqipe, Hafiz Sherif Langu Imami luajti rol të madh në përgatitjen e Zhvillimin e Kongresit të Dibrës më 23 korrik 1909. Po këtë vit ky atdhetar i guximshëm e i përkushtuar (më 1909) së bashku me Hajdar Blloshmin shkon në Starovë në mitingun e organizuar atje për çështjen e gjuhës shqipe kundër politikës së xhonturqve dhe qëndrimit të disa pseudoatdhetarëve duke bërë kështu një akt të rëndësishëm në dobi të dritësimit të çështjes së gjuhës tonë amtare. I kudondodhur, pranë popullit në ndihmë të fesë e të besimit, për përhapjen e diturisë e organizimin e atdhetarëve, bashkëpunëtor dhe ndihmës e prijs i palodhur për çështjet më kulmore të kohës në ndihmë të Dibrës e të kombit. Midis plot ngjarjeve vlen të theksojmë atë të marsit 1912 ku u organizua me patriotët dibranë mbledhja e Klubit "Bashkimi" të Dibrës, ku u hartua plani i kryengritjes që kishte ardhur nga Komiteti i Manastirit. Në hartimin e këtij plani morën pjesë Vehbi Dibra, Sherif Langu, Ismail Strazimiri, Sheh Sula Ismail Haki Peqini. Burrë i urtësisë, i kuvendeve dhe i veprimit, kurdoherë organizator e bashkëvperues, i vendosur dhe i shquar për udhën e besimit e të përparimit Hafiz Sherif Langu (Imami) la gjurmë, të cilat ndihmuan në ecurinë e patriotëve për gjuhën shqipe, për organizimin kundër osmanëve, për ngjarjet shumë të rëndësishme në Dibër e jashtë saj, Manastir, Elbasan, Mat e gjetkë. Hafiz Sherif Langu bashkë me Haxhi Vehbi Dibrën, dy predikues të njohur fetarë të Dibrës, u zgjodhën delegatë të Kuvendit të Vlorës dhe vendosen firmat për pavarësinë e Shqipërisë, të kombit tonë, i cili siç e thoshte Çajupi:

500 vjet me pahire, lidhur këmbë e
duar me zinxhirë,
Të ngrihem të dëftojmë trimëri
Ja të vdesim, ja të rrojmë, për liri,

Mbetet vërtet një ndihmesë e çmuar fakti sesi në maj të vitit 1913 kryetari i Qeverisë Vlora, kryetar i Pleqësisë (senatit) Haxhi Vehbi Dibra e ngritën një komision të veçantë të përbërë nga Hafiz Sherif Langu (Imami), Tajar Tetova, Ahmet Dakli dhe Ismail Strazimiri me detyrë qe në Dibër e Mat të organizojnë pushtetin vendor për të rezistuar kundër pushtuesve barbarë serbë. Vendimet e Fuqive të Mëdha e preken shumë atdhetarin e flaktë Sherif Langu. Shpërngulja e dibranëve nga Dibra në Tiranë Elbasan e gjetkë për t'u shpëtuar barbarive serbe e rriten më fort urrejtjen e qëndresën. As vuajtja as burgu në fund të vitit 1913 dhjetë muaj e gjysmë në Elbasan nuk e mposhtën besimtarin e atdhetarin Sherif Langu.

Nga viti 1913 (15 dhjetori, e deri më 31 dhjetor 1917 Hafiz Sherif Langu (Imami) kreu detyrën e kadiut (gjykatësit) në Qarkun e Dibrës. Me vendosmëri e përkushtim për vendlindjen prej 14 dhjetor 1920 e deri më 31 mars 1928 shërbeu si imam në Dibër duke vazhduar deri më 7 janar 1933. Prej kësaj date (7 janar 1933) e deri më 20 maj 1928 ushtroi detyrën e gjykatësit e Sheriatit të Dibrës Madhe. Patriot i vendosur, besimtar e burrë i urtësisë, i pajtimit dhe i rritjes së besimit e të vëllazërisë në prill 1941 ndërmori nismën për themelimin e Qendrës Unike Fetare me seli në Tiranë. Ky atdhetar e kreu me devotshmëri edhe detyrën e kryetarit të këshillit të Ulemave në Shkup (prej datës 20 maj 1938) deri në prill 1941, si përfaqësues i gjithë shqiptarëve të besimit islam në trevat e Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi.

"Feja dhe atdheu, - shkruan Magistër Ruzhdi Lata, te Kongresi i Dibrës, f. 134, - si dy shtylla të forta të përcaktimeve ideologjike të njeriut gjatë historisë janë ngatërruar, konfrontuar, identifikuar me qëllim nga armiqtë tanë me çka e kanë dëmtuar rëndë Lëvizjen Kombëtare. Këto dy koncepte, si vlera plotësisht të barabarta, i gjejmë edhe më herët te predikuesit fetarë edhe patriotë dibranë, te mësuesi i parë i shkollës së parë shqipe, te Said Najdeni – Hoxhë Voka i Dibrës, ashtu siç u bënë edhe nxënësit e tyre shpirtërore, islamistët e islamologët Haxhi Vehbi Dibra dhe Hafiz Sherif Langu". Në shkurt të vitit 1945 pushteti i kohës, pra, shteti monist e dënoi atdhetarin Hafiz Sherif Langun me 10 vite burg për agjitacion e propagandë, ku përse u kishte shkruar gjithë imamëve të Komunitetit Mysliman në Shqipëri që të mos u besojnë fjalëve të komunistëve se ata ishin ateistë në fund të vitit 1942. Më 20 shkurt 1950 lirohet nga burgu. Më pas jetoi edhe 6 vjet në gjendje shumë të rëndë si nga ana shpirtërore ashtu edhe ajo ekonomike e shëndetësore. Firmëtari i pavarësisë personaliteti i rrallë e organizoi për gjuhën shqipe, prijës i nderuar i besimit burrë i urtësisë e kurdoherë i pasionuar për çështjen kombëtare, kurrë nuk u mposht nga vështirësitë. Atdhetar e islamolog, burrë me dinjitet, i sakrificës dhe i besimit la gjurmë në Dibër të Madhe, Manastir, Elbasan, Mat e mbi të gjitha si firmëtar i shquar i pavarësisë në Kuvendin e Vlorës më 28 nëntor 1912. Më 9 mars 2016 u mbushën plot 60 vjet qëkurse ky flakadan i besimit, i gjuhës shqipe e i flamurit u nda nga jeta. Dibra, kombi dhe mbarë brezat që nderojnë historinë e figurat e ndritura kurrë nuk do ta harrojnë këtë vigan të diturisë, të besimit e të qëndresës firmëtarin e pavarësisë Hafiz Sherif Langu (Imami) të Dibrës së Madhe.

REFERENCAT

Ali Imami "Hafiz Sherif Langu Imami, një jetë e tërë në shërbim të atdheut dhe të fesë f. 1999 (Kongresi i Dibrës, 1909-2004).

Sejfi Vllamasi "Ballafaqime politike në Shqipëri" 1897-1942, Tiranë 2000 faqe 54.

Dr. Arian Kadiu "Dibra e Madhe", Tiranë 1996.

Qemal Rusi "Drita Islame", korrik 1993, nr. 9, faqe 3.

Gafur Zoto "Dibra dhe etnokultura e saj", Dibër 1995 vëllimi II, faqe 21.

As. Prof. Dr. Qazim Xhelili "Vehbi Dibra personalitet dhe veprimtar i shquar i Lëvizjes KOmbëtare", Tiranë 1998.

Kultura islame, Tiranë, viti III nr. 10-11.

Mr. Rruzhdi Lata "Roli i predikuesve fetarë në Kongresin e Dibrës" (1909), f. 134.

Përpara mësuesit **Ismail Erebara** të gjithë jemi nxënës

Nga **Ruzhdi LATA**



Të nderuar pjesëmarës, vllezër e motra, të nderuar bashkëqytetar. Me të vërtet në këtë aktivitet është paksa e vështirë njeriu të gjejë fjalë e të flas. Them është e vështirë se është një porosi shenjtë. Njeriu në jetë duhet të gjejë një pozicion, ose të jetë nxënës ose të jetë mësues. Aty ku ka mundësi të jetë mësues dhe të ushtroj aktivitetin p.sh. ai që nuk mund të jetë mësues është mitë të kaloj në statusin e nxënësit. Unë mendoj sot në një formë tjetër për mos ndonjë keqkuptim para të nderuarit jemi nxënës dhe do flasim si nxënës.

Nëse bëhet fjalë për një përsonalitet që thesari i aktivitetit të tij në tërë jetën faktorizon të jetë mësuesi im. E uroj zotri Faikun e zonjën Hatixhe që aktivitetin e bërë e kanë shënuar në letër. Ne shumë flasim dhe pak shkruajmë e ky shkrim nesër do të këtë më shumë vlerë se sot që flasim ne.

Po ndjej një kënaqësi të veçantë që u përurua libri për zotin Ismail Erebara për një arsye, bashkëqytetarët tonë e dijnë kurse vllezërit tonë nga Tirana besoj se nuk janë njohur për një aktivitet të bërë në këtë sallë se është krenari në jetë kur thuhet një intimitet e vijushmëri.

Para disa muajsh në këtë sallë ne kemi bërë një promovim që bëhej nga një studiuese franceze për Jashar Erebarën, e sot falenderoj Faikun dhe Hatixhen që bëjnë promovimin për Ismail Erebarën, po e bëjnë vetë, kështu kush njeh veten njeh dhe perëndinë. E ne këto ditë kur të tjerët interesohen për Jashar Erebarën të paktën ne dibranët jo vetëm për Jasharin por edhe për Ismailin. Po kjo bën edhe një thesar që kemi të bëjmë me një familje dibrane që zë vendin e duhur në vazhdën e në rrjedhën e historisë, sigurisht kur ndonjë studiues të bëjë vetë krahasimin me kontradiksion punën e Jashar Erebarës në Shkup me punën e Ismail Erebarës në Peshkopi. E vështirë të flasish për mësues. Mësuesi ka peshën e vet në histori, ka vlerat e veta e kështu që flasim dikush na ka mësuar dhe ata duhen përkujtuar. Mësuesit na kanë mësuar. Por është interesante një gjë që e dijnë dibranët, që se e bëjnë një vlersim të Dibrës në pikpamjen arsimore është shumë interesante. Dibranët i gjen gjithkund në botë për kafshatën e bukës, ku është interesant ku kanë shkuar punë të parë dhe peshë më të rëndësishme i dhanë arsimit. Të gjithë kombet e tjerë kan punuar për thesare pasurie, dibranët për thesar shkollimi. Kjo është një realitet historik dhe Ismaili e ka pasur të vështirë por bën punën e të parëve tanë.

U mbajtë Kongresi i Manastirit, këto në Shqipëri studjohen nga qeveritarët. Një mësues nga Dibra, prani jonë nuk kemi mësuar sa duhet, ne jemi krenaria në mezin e atyre qenë Hoxhë Muglica edhe Kurt Balla kantribuan për Normalen e Elbasanit. Nxënësit e parë që morën pjesë në Normalen ishin Medat Cami, Irfan Uruci etj. Kështu që Dibra e don arsimin, e vazhdon dhe na ka mbetur amanet dhe jo vetëm që ta vazhdojmë por edhe ta mbrojmë e të rikujtojmë vlerat e atyre që na mësuan dhe nuk ka kënaqësi më të madhe kur dikënd për arsimin ashtu si sot kujtojmë zotrin në fjalë dhe ata që dëgjuam, që na kanë mësuar mirëpo çfarë mund të bëjmë ne më shumë se një faleminderit. Shumë mirë Ismailit faleminderit i thotë historia prandaj le të mbetemi në vazhdën e historikut dibran, gjithë atyre që kontribuan për arsim, normalisht edhe për të nderuarin Ismail Erebara.

**Kjo fjalë e kryetarit të komunës së Dibrës së Madhe është mbajtur në promovimin e librit "I përkushtuari", kushtuar Ismail Erebares.*

folklor

"Natyra e vuri njerëzimin nën pushtetin e dy sundimtarëve bashkëkohorë, të dhimbjes e kënaqësisë. Vetëm ato na japin shenjë ç'duhet bërë."
Jeremy Bentham

"OJ FUSHA E KORABIT", pasthirrmë dhimbje, thirrje shprese

Nga **Ermira B. SHEHU - TOCA**

Kënga "Oj Fusha e Korabit", është një poemë autobiografi e blegtorëve të Kalasë Dodës, një krijim me vlera të çmuara informacioni në rrugën e jetës dhe zhvillimit shekullor të tyre.

Jeta e banorëve të bashkësive blegtorale të krahinës së Kala e Dodës, ka udhëtuar midis dy të kundërtave, dhimbjes e kënaqësisë. Këto dy përjetime të njeriut, të formuluara që në lashtësi nga Aristoteli, në sentencën e njohur "Knaqësia e dhimbja janë shtysat më të mëdha të jetës shoqërore" kanë qenë "Thimos" siç e shpreh Platoni ose "Sedra" siç i thonë blegtorët e Kalasë Dodës, motivi që ata të mundin instiktin e mbijetesës për të krijuar atë sistem vlerash që kanë përcaktuar identitetin e tyre. Kjo"Sedër" që ka motivuar zhvillimet e jetës në Kala të Dodës, pasqyrohet mbrekullisht në këngën legjendë "Oj Fusha e Korabit"e cila këndohet, ndigjohet e shijohet në mjedise burrash e grashë, jo vtëm në fshatrat e kësaj krahine edhe pse kanë kaluar ndoshta mijra vjet.

Që në vargun e parë, kënga fillon me pasthirrmën "Oj Fusha e Korabit", duke e animizuar atë, duke i dhënë jetë, duke e bërë qënje të gjallë, pjesë të jetës së tyre. Po ku gjindet kjo fushë dhe ç'farë përfaqëson ajo për blegtorët e Kalasë Dodës, e në veçanti të fshatit Radomirë. Mali i Korabit shënon lartësitë më të mëdha të vargmalit me të njejtin emër i cili fillon nga lugina e lumit Drini i Bardhë në veri e deri në grykën e lumit Radika në jug. Nga perëndimi lartësitë e vargmalit të Korabit zbresin në luginën e Drinit të Zi dhe nga lindja bashkëngjiten me lartësitë e maleve të Sharrit, kurse në pjesën jug-lindore, lartësitë e këtij vargmali zbresin në luginën e lumit Radika.

Lartësitë e Malit të Korabit kurorëzohen me tri majat e tij më të larta, të cilat shënojnë edhe lartësitë më të mëdha të maleve shqiptare. Ato duken si tre alpinist që presin medaljet në përfundimin e garës së ngjitjes. Në qendër, duke shënuar edhe lartësinë më të madhe 2754m mbi nivelin e detit, qëndron maja e Korabit. Në verilindje të saj me 2725 m lartësi mbi nivelin e detit, qëndron maja Portat e Korabit, e cila është edhe maja më e bukur e këtyre lartësive dhe në jugëperëndim të lartësisë qëndrore, konkuron Maja e Moravës e ngjitur në lartësinë 2716 m mbi nivelin e detit. Kofiçenti i lartë i pjerrësisë me të cilin janë ngritur këto maja, ka sjell një reliev tepër të thyer e të ashpër, veçanërisht në mbulesën gëlqerore, duke formuar maja të mprehta të cilat rrëshqasin në hone e gremina të panumërta, por kanë krijuar edhe mrekulli natyrore nga më të bukurat, jo vetëm në vargmalin e Korabit, por edhe në të gjithë bukuritë natyrore të maleve shqipëtare, madje edhe atyre të Ballkanit.

Një ndër këto mrekulli natyrore, madje më e mrekullueshmja e bjeshkëve të Korabit është Fusha e Korabit. Në lartësinë 1900 m mbi nivelin e detit, duke patur në juglindje fillimin e ngjitjes së majave të Korabit dhe në veriperendim kapërcimin pindarik në Rrafshit e Sorokolit, me një gjerësi mbi një km dhe gjatësi rreth katër km, verës mbuluar me qylimin e barit alpin, të quajtur fang dhe dimrit nën mantelin e bardhë të borës pesë mujorshe, mbretëron kjo kryezonjë e bjeshkëve të Korabit. Kjo govatë gjigande natyrore e cila fillon në Derzën e Korabit, aty ku shënon lartësia 1950 m mbi nivelin detit e deri në Kodrën e Staneve, një distancë rreth 2 km,emërtohet Rrafshja e Epër, e cila është edhe pjesa më e bukur e Fushës së Korabit. Në mesin e fushës, baraslarguar nga katër drejtimet e saj, me ujë si kristal, buron Gurra e saj me një prurje mbi 500 l/orë, një dhuratë tjetër kjo e Natyrës, që e banë qylimin e blertë të barit të lulëzuar, të duket përrallore.

Kodra e Staneve e cila e ka marrë këtë emër pasi këtu vendosen stanet e deleve të Radomirës, në formën e një dige me lartësi rreth 10 m dhe gjerësi mbi 100 m, (është një bredashje morenike, e cila tregon edhe origjinën akullnajore të Fushës së Korabit) e ndanë atë në dy pjesë pothuajse të barabarta, Rrafshja e Epër dhe Rrafshja e Poshtëme. Edhe Rrafshja e Poshtëme vazhdon me të njëjtat përmasa deri në shkëmbenjt e Shpellave mbi Radomirë. Në dallim nga Rrafshja e Epër e Korabit, Rrafshja e Poshtëme ka një reliev më të alternuar me një zbritje graduale në drejtim të fshatit Radomirë.

Identiteti i njeriut formohet në proçese historike dhe nuk mjaftojnë vetëm resurset natyrore, gjenetika apo origjina e banorëve. Zhvillimi arrihet nga njerzë të motivuar e të guximshëm që besojnë tek ky zhvillim më shumë se frika nga pasojat e veprimit të tyre.

Bjeshkët e Korabit ku janë vendosur e jetojnë banorët e 15 fshatrave historik të Kalasë Dodës, përveç bukurive natyrore, u dhuroi banorëve të këtyre krahinave edhe Delen Rudë, këtë mbarësi që begatoi jetën e këtyre banorëve jo vetëm nga ana ekonomike por edhe shpirtërore. Shtrirja e këtyre bjeshkëve në një reliev luginash e shpatesh akullnajore të mbuluara me qylimin e barit alpin që lulëzon në gjashtë muajt e verës si dhe me burimet e panumërta që freskojnë çdo pëllëmbë të saj, krjuan kushte tepër të favorshme që banorët e kësaj krahine të merreshin me mbarështimin e deles rudë.

Shtegëtimi i blegtorisë për dimërim në zonat e ngrohta bregdetare, përbënte një nga aktivitetet jetike më të rëndësishme të banorëve të bashkësive blegtorale të Kalasë Dodës, nëpërmjet të cilit sigurohej ekzistenca e dhenëve, burimi kryesor i jetesës se këtyre banorëve. Deri në vitin 1912 banorët e bjeshkëve të Korabit, shtegëtimin e bagëtive e realizonin në kullotat e fushës së Selanikut, kurse në vitet pasardhëse me bllokimin e kësaj rruge, pasojë kjo e luftës së parë ballkanike dhe asaj botërore, blegtorët e Kalasë Dodës, filluan shtegëtimin e deleve në kullotat e bregdetit Adriatik dhe kryesisht në zonat Tiranë-Durrës dhe Lezhë-Shkodër.

Rrugët dhe veprimet e përbashkëta të blegtorëve dhe përballimi i vështirësive duke ndihmuar njëri tjetrin, krijuan lidhje të sinqerta dhe të qëndrueshme të cilat reflektoheshin edhe në familjet e tyre, duke u kthyer në zakone tepër njerëzore e fisnike, të cilat do të quheshin "Zakonet e Dheut."

Ndër zakonet me vlera të veçanta dhe pothuajse unike në të gjitha trojet tona kombëtare, që u radhitë në vargun e traditave të banorëve të Dheut të Kalasë Dodës, është edhe pozita që mori gruaja në jetën e banorëve të kësaj krahine. Vetëm tek banorët e fshatrave të Dheut të Kalasë Dodës, "turpi më i madh për burrin është ngarkimi i gruas me barrë në shpinë" ku në fshatrat e malësisë është diçka normale, madje një detyrim për gruan. Vetë natyra e përpunimit të produkteve blegtorale, si të bylmetit, të përgatitjes së rrobave të shtrojes e të veshjeve, të cilat realizoheshin pothuaj krejtësisht me punimin e leshit të deles, si dhe kujdesi për familjen, e vinin gruan në punë që përcaktonin statusin e saj, jo si robinë, siç shprehet dikush që nuk e njeh jetën, traditën e vlerat e saj, në këtë krahinë, por si bijë në familjen e babës dhe si bashkëshorte, si nënë e si zonjë shtëpie në familjen e burrit.

Dhimbjet fizike e shpirtërore që u sillte blegëtorve, shtegtimi i bagëtive ishte një dramë e vërtetë në jetën e tyre. Ajo përfshinte ndarjen, hidhërimin, mallin, por edhe kthimin, gëzimin, emocionet e pritjes për më të dashurit e tyre. Gjashtë muajt e dimrit, ata, e kalonin jetën të ndarë nga familjet e tyre duke përballuar vështirësi të panumërta fizike e shpirtërore. Peshë të madhe të kësaj dhimbje, përjetonin gratë e këtyre blegëtorëve, të cilat, poeti anonim, me vargje brilante i përshkruan në këngën "Oj fusha e Korabit", teksti i së cilës nuk është vetëm një poezi por është edhe një tablo epike me një dramë të pa shprehur, por lirisht të nënkuptuar. Që në vargjet e para të këngës, me pasthirmën *"Oj Fusha e Korabit / Taj na erdhe hakit, / Taj na dave shtratit"*, animizohet Fusha e Korabit, i jepet jetë asaj, se vetëm duke i dhënë shpirt ajo do të ndjente peshën e madhe të dhimbjes që u kishte shkaktuar. Në një vështrim të përciptë, ndarja nga shtrati, nuk duket se mund të jetë aq e dhimbështme sa të fajsonin Fushën e Korabit, këtë mrekulli, me të cilën ishte lidhur jeta e tyre. Po, a nuk ngjajnë vargjet e kësaj kënge me vargjet e Shekspirit në Tragjedinë e Makbethit, ku e fajson atë për mëkatin më të madh që kishte bërë: "Makbethi vrau gjumin, vrau pafajsinë, vrau banjën trupkapitëse, vrau shtratin e shenjtë bashkëshortor".

Gruaja e blegtorit në Kala të Dodës i njihte vështirësitë e shtegëtimit dhe me shprehjen "o njera un-o" që përsëritet pas ç'do vargu të këngës, "Oj fusha e Korabit", nuk qan vetëm hallin e saj që do të përballoi gjashtë muajt e dimrit, *"s'janë një ditë e dy, / janë gjashtë mujt e zi"*, e vetme e larg gëzimeve njerëzore, por edhe të burrit të saj, i cili larg nga familja, i djegur nga malli për gruan, prindërit dhe fëmijët, si dhe meraku për jetën e tyre, do ta kalonte dimrin në kushte tepër të vështira moti e jetese. Por duke e ditur se nuk mud të bënin pa këtë shtegtim, ajo jo si qaramane por me përgjegjësinë e bashkëshortes është gati ta ndjek në rrugën e shtegëtimit, burrin saj, për t'ja lehtësuar vështirsitë *"Si t'ishte sebepi, o njera un-o / T'më mirrshe me veti / Bukën ta gjatujë / Koliben ta rujë"*.

Ky shqetësim largimi ishte i përvitshëm, si një ritual që gjithmonë do të ndodhte, ditën e Shën Mitrit, me 24 nëntor, dita kur niseshin shtegtarët me kopetë e tyre në kullotat dimërore në fushën eSelanikut. Ky merak do ta shoqëronte atë edhe në shtrat kur binte në gjumë, edhe në mëngjes kur shikonte Korabin, në se ishte i vrenjtur, edhe në magje kur gatuante dhe mendonte kaçamakun e barive me të cilin ata ushqeheshin. Këtë merak e shpreh, të ngritur në artë, autori anonim i kësaj kënge me pyetje retorike dhe premtimin, se me mendë e me shpirt ajo ishte gjithmonë pranë tij: *" Shajvi si po bije o njera un-o, / Ferexhe a kije / Ferexhja ba kllajë / Fugje me ni dllajë / Ferexhja e shkurtë / A t'mërdhajhin gjujtë / Ferexhja e vjetër / T'baj dada ni qetër / o njera un-o"*.

Vargjet e këngës "Oj fusha e Korabit"nuk shprehin vetëm vuajtjet e barinjëve të Korabit dhe vashave të tyre. Si këngë e jetës së këtyre banorëve, si poezi me vargje të ndërtuara mjeshtrisht, ajo shpreh edhe shpresë e gëzim, gëzim që pritej e do të vinte ditën e Shëngjergjit për të lumturuar zemrat e vashave, fëmijëve dhe prindërve, por edhe të Fushës së Korabit. *"Po na çelën shpenra , / Nuk na hihet mrena / Banja si t'ja bajsh / Për Shënxhexh t'na vajsh, / Me dhenë e me shqerra / Të na gzohet zemra."*

Për banorët e bashkësive blegtorale të Kalasë Dodës, viti kalendarik konceptohet në dy stinë: Vera dhe Dimri, seicila me nga gjashtë muaj. Dita e Shëngjergjit është dita e parë e vitit dhe kremtohet me 6 maj. Këtë ditë kthehen blegtorët nga shtegëtimi dhe kremtohet me këngë e rite me origjinë deri edhe pagane, në dëshirën për të patur një vit të mbarë blegtoral.

Me vargje homerike ndërtuar me figura letrare nga më të gjeturat, kënga pasqyron, si në një legjendë, gëzimin e ardhjes së shtegtarëve, duke emërtuar edhe vendet me shenjë, nga ku ata do të njoftonin ardhjen.*"Kur të dalish n'atë kep / Dixhe ni fishek / Te ura e Radikës / Duel ylli i dritës / Te ura e Izvajrit / Topi i tranafajlit"*.

Kënga "Oj Fusha e Korabit", në saj të tekstit poetik dhe të melodisë, si jehonë bjeshkësh, të fyejve që e shoqërojnë, të japin emocione të papërshkruara, por edhe krenarinë që ke genin e atyre njerëzve të mrekullueshëm të cilët ndërtuan jetën e tyre në bjeshkët e Korabit me aq sakrifica e dinjitet. Thellimi në njohjen e mëtejshme të vlerave të kësaj kënge, të cilat janë të pafundme do të sillte studime e krijime artistike me vlera të veçanta kombëtare. Të shpresojmë që ky shkrim i imi modest, të jetë nxitje.

** Autorja është mësuese e Historisë dhe Gjeografisë në Gjimnazin "Ismail Qemali", Tiranë*

Oj Fusha e Korabit, - o njera un-o
Taj na erdhe hakit, - o njera un-o
Taj na dave shtratit - o njera un-o
Shkove kapërceve, - o njera un-o
Krajet si se thkeve - o njera un-o

Kur t'përcolla t'ajë, - o njera un-o
S'më hihej në shpajë, - o njera un-o
Kur hina në odë, - o njera un-o
U lava në lotë, - o njera un-o
Kur bana më ra , - o njera un-o
Dush qasa tu ka, - o njera un-o

Si t'ishte sebepi, - o njera un-o
t'mirrshe me veti, - o njera un-o
Si t'vajshem me taj, - o njera un-o
rrëgzinat t'i lajë. - o njera un-o
Bukën t'a gjatujë - o njera un-o
Koliben t'a ruajë - o njera un-o

Shkuen gjemt e ri, - o njera un-o
Lanë orgjaçet n'zi, - o njera un-o
S'janë ni ditë e di, - o njera un-o
Jan'xhasht' mujtë e zi, - o njera un-o
Kto xhashtë mujtë edimnit, - o njera un-o
T'i shkrujë n'qosh t'çilimit, - o njera un-o

Shkove u harrove - o njera un-o
Ni letër se çove - o njera un-o
Ni letër ni kartë - o njera un-o
T'a rujë dada n'arkë - o njera un-o

Shajvi si po bie, - o njera un-o
Ferexhe a kije, - o njera un-o
Ferexhja ba çullë, - o njera un-o
Fugje me ni gjur, - o njera un-o
Ferexhja e shkurtë, - o njera un-o
A t'mërdhajfin gjujtë, - o njera un-o
Ferexhja e vjetër, - o njera un-o
T'baj dada ni qetër, - o njera un-o

Si na çeli shpenra, - o njera un-o
Nuk na hihet mrena, - o njera un-o
Banja si tja bajsh, - o njera un-o
Për Shënxhexh të vajsh, - o njera un-o
Me dhenë e me shqerra, - o njera un-o
Të na gzohet zemra, - o njera un-o

Kur t'dalish n'atë kep, - o njera un-o
Dixhe ni fishek, - o njera un-o
Te ura e radikës, - o njera un-o
Duel illi i dritës, - o njera un-o
Te ura e Izvajrit, - o njera un-o
Topi i tranafajlit, - o njera un-o
Si na erdhë Shënxhexhi - o njera un-o
Me sheja për brezi - o njera un-o.

Poeti Agim Vinca na kujton dhe kritikun, historianin dhe studiuesin e letërsisë shqipe, sepse përmes këtij libri kalojnë haptazi hija e Lasgushit, si dhe ajo e Dritëroit"...

Poezia e Vincës, *dritë për shpirtin e popullit të tij*

Nga **Valeria DEDAJ**

Gjithçka zuri fill një natë të ngrohtë vere, fund korriku në mbrëmjen e quajtur 'Lexim me qirinj', teksa unë në orët e vona të natës duhet t'i lexoja publikut poezitë e mia në shqip, ndërsa në frëngjisht të njëjtat i deklamonte Sharlota, një aktore sharmante dhe inteligjente, e cila i kuptoi shpejt vargjet e mia...". Kështu nis rrëfimi i poetit të mirënjohur, Agim Vinca, i cili dëshirën e tij të kahershme, qysh nga mosha 27-vjeçare, për të botuar një libër në Tiranë e bëri realitet. Në kuadër të kalendarit të përbashkët kulturor, Shqipëri- Kosovë, në ambientet e Ministrisë së Kulturës, Vinca promovoi librin me poezi "Kambanë në qafë", botuar nga "Édition du Petit Véhicule", Nantes (Nantë), Francë. Libri është botim dygjuhësh: shqip-frëngjisht dhe përmban dyzet poezi, të përkthyera nga Aleksandër Zoto.



Ai na tregon se ndërsa botuesi i "Édition du Petit Véhicule" bënte prezantimin në Jug të Francës, i kërkoi që të lexonte poezinë "Plepat e vendlindjes", në të cilën ai flet për bashkëfshatarët e tij dhe për qëndresën e tyre jetike në brigjet e Drinit të Zi. Më pasi i kërkoi që të dëgjonte edhe poezitë e tjera, si "Mali i thatë", "Udhëtimi i fundit i motrës sime", "Të shkosh në Pogradec", "I jashtëzakonshëm", '"Zotë që i kalojnë kufijtë pa pasaportë, edhe atëherë kur kufijtë janë të pakalueshëm", ashtu siç ishte dikur kufiri Shqipëri-Kosovë, por dhe për burgun famëkeq, që i ka rënduar, si 'Kambanë në qafë'". Ky projekt nuk do të dilte në dritë pa mirëkuptimin e mikut të tij të vjetër, përkthyesit Aleksandër Zoto, i cili sipas poetit, ka bërë një punë, sikundër vetëm ai di ta bëjë. Vinca nuk harron të falënderoi as piktorin Anastas Kostandin Taso, i cili me plot 13 ilustrime i ka dhënë librit një dimension të ri.



Libri mban numrin rendor 27. Ky numër është domethënës për poetin, veçanërisht kur ndodhet në Tiranë. "Kur shkela për herë të parë në jetë në Tiranë isha 27 vjeç. Ishte viti 1974 dhe unë kisha botuar vetëm një libër 'Feniksin' (1972), të cilin kur ia dhashë njërit prej kolegëve, që na shoqëronin në bibliotekën ku punonim ne nga Kosova më tha: 'Duhet të jeni shërbëtor i artit dhe i shkencës'. Tani pas kaq 40 e ca vjetësh është rritur numri im i botimeve dhe akoma më shumë ai i viteve dhe i thinjave, gjithsesi ëndrrat nuk janë shuar, as kur janë ndeshur me andralla, sepse kryesorja është që të mos thinjesh në shpirt. Për botuesin e 'Édition du Petit Véhicule', poezia e Agim Vincës është dritë vëllazërore dhe e afërt me shpirtin e popullit të tij. Metaforat e tij janë goditëse dhe tërheqëse, lirizmi i tij është drithërues, poeti është një shqyrtuar i madh, një shtegtar i përjetshëm, vatra e të cilit u ofron kalimtarëve një sofër bujare.

Përkthyesi Zoto, titullar i çmimit "Jusuf Vrioni" në pamundësi për të qenë në Tiranë, nëpërmjet një letre rrëfen se me Vincën është njohur në vitet '80. "Aftësia ime përqendrohet në tingëllimin dhe në ngjashmërinë brenda gjuhës së mbërritjes. Ajo që më bën përshtypje në brendinë e kësaj antologjie është fakti se i pasqyron poetikisht horizontet e punës thelbësore të poetit, duke i gërshetuar dhe harmonizuar midis tyre. Pajtohen pjesë me frymëzim shoqëror apo nga jeta vetjake, me tone të revoltuar luftarakë dhe të mallëngjyer, plot dashuri për tokën amtare dhe të afërmit. Poeti Agim Vinca na kujton dhe kritikun, historianin dhe studiuesin e letërsisë shqipe, sepse përmes këtij libri kalojnë haptazi hija e Lasgushit, si dhe ajo e Dritëroit", thotë ai.

Gjatë përurimit të librit në mjediset e Ministrisë së Kulturës në Tiranë folën shkrimtari Besnik Mustafaj, si dhe studiuesja Feride Papleka. Ndërsa aktorët e Teatrit Kombëtar recituan poezi nga libri në shqip dhe në frëngjisht. (shekulli.com.al)

Mjeku **Ramazan Buci** *nderohet me titullin* **"Nderi i Qarkut Dibër"**

Nga **SHAQIR SKARRA**

Më datën 10 mars 2016, në qytetin e Peshkopisë, Këshilli i Qarkut Dibër organizoi ceremoninë për dhënien e titullit "Nderi i Qarkut" mjekut të njohur pediatër Ramazan Buci. Salla ishte mbushur plot me miq, shokë, qytetar të ndryshëm e koleg të Ramazanit. Kishin ardhur specialist të fushave të ndryshme, intelektual por dhe qytetarë të ndryshëm nga zonat ku kishte punuar për vite me radhë Ramazani. Në këtë ceremoni festive merrte pjesë prefektja e qarkut zonja Donika Hysenaj, kryetari i qarkut Hajri Laçi, kryetari i bashkisë Burrel Nezir Rizvani, kryetari i bashkisë Klos Basir Çupa, kryetari i bashkisë Bulqizë Melaim Damzi, kryetarja e këshillit bashkiak Dibër Lulzime Dani, drejtori i spitalit rajonal Peshkopi Beqir Bici.

Qarku i Dibrës e vlerësonte mjekun pediatër Ramazan Buci me titullin më të lartë "Nderi i Qarkut" pas disa nderimeve dhe vlerësimeve që i kishin bërë më parë si: "Qytetar nderi" i komunës Reç, "Qytetar nderi i komunës Arras, "Medaljen e mirënjohjes" nga spitali i Peshkopisë me rastin e 85 vjetorit të këtij spitali.

Ramazan Buci është ndoshta mjeku që ka lënë gjurmë të mira tek të gjithë kudo ku ka punuar. Ende në Reç sot të flasin me respekt dhe admirim për të pasi pasi gjithmonë në shërbim të njerëzve ka qëndruar, ai nuk e pati problem ta prishte gjumin edhe në orët e vona të natës, për t'iu ndodhur pranë të sëmurëve të cilët kërkonin ndihmën e tij.

Ramazani ka mbaruar studimet e larta në Fakultetin e mjekësisë në vitin 1972-1977 dhe është diplomuar mjek i përgjithshëm. Në vitin 1989-1991 ka përfunduar specializimin pranë spitalit pediatrik si pediatër. Ka punuar në Qendrën shëndetsore Fushë-Çidhën, Qendrën shëndetsore Reç, mjek pediatër në spitalin rajonal Peshkopi, drejtor i kujdesit shëndetsor parësor Dibër. Aktualisht është mjek pediatër pranë qendrës shëndetsore Nr 7 Tiranë si dhe drejtor i kësaj qendre.

Dekorimi i mjekut Ramazan Buci nga ana e Qarkut Dibër erdhi si rezultat i një pune të madhe dhe të gjatë po thuaj në të gjitha zonat e Dibrës ku vlerësimi qytetar ka qenë maksimal. Titulli "Nderi i Qarkut' i jepej me motivacinonin "Për kontributin e dhënë në shërbimin e kujdesit shëndetsor parësor në Qarkun e Dibrës, për ndjenjën e lartë të humanizmit dhe profesionalizmit si mjek pediatër në spitalin rajonal Peshkopi".



Kryetari i Qarkut Dibër zoti Hajri Laçi duke i dorëzuar titullin e lartë "Nderi i Qarkut" mjekut pediatër Ramazan Buci ndër të tjera foli për ndihmën dhe kontributin që ka dhënë Dr Ramazani në të gjitha fshatrat e Dibrës ku ka shërbyer por në veçanti edhe në spitalin rajonal Peshkopi si në mjediset e brendëshme të këtij spitali por edhe në mjedisin rreth tij. Edhe të pranishmit e tjerë sollën mbresa e kujtime nga puna e pa lodhur e mjekut Ramazan Buci, një titull ky i vonuar por më së fundi u vlerësua puna, sakrifica dhe mundi i tij për vite me radhë në shërbim të njerëzve nga njera zonë e Dibrës në tjetrën, duke u treguar gjithmonë i papërtuar.

Ramazani gjatë kohës që punonte në Qendrat shëndetsore Fushë-Çidhën dhe Reç ka bërë një punë të madhe për rritjen dhe forcimin e shërbimit shëndetsor në fshatra pa lënë jashtë dore kujdesin e vazhdueshëm që bëhej edhe në spitalet përkatëse. Gjithmonë aty ku shërbeu Ramazani u rrit edhe cilësia e shërbimit ndaj pacientëve. Ramazani në fushën e mjekësisë ka kryer një sërë studimesh me mjaft vlera shkencore si:

-Studimi mbi depistimin e sëmundjeve tumorale dhe endocrine në zonën e Fushë-Çidhnës Dibër.

Ramazan Buci është mjeku që ka lënë gjurmë të mira tek të gjithë kudo ku ka punuar. Ende në Reç sot të flasin me respekt dhe admirim për të pasi pasi gjithmonë në shërbim të njerëzve ka qëndruar, ai nuk e pati problem ta prishte gjumin edhe në orët e vona të natës, për t'iu ndodhur pranë të sëmurëve të cilët kërkonin ndihmën e tij.

-Studimi mbi distrofinë dhe rachitin në zonën e Reçit Dibër.

-Studimi mbi Astma brochiale dhe mjekimi i krizës në repartin e pediatrisë në spitalin e Peshkopisë.

- Studimi diarretë aukte në spitalin e Peshkopisë, reparti i pediatrisë.

-Është kualifikuar në kursin mbi "Planifikimin dhe menaxhimin e shërbimit shëndetsor në rreth, i mundësuar nga Ministria e Shëndetsisë dhe Ambientit në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe Universitetin e Mont-Realit Kanada.

Dr.Ramazan Buci ka mbrojtur gradën shkencore "Doktor i shkencave mjekësore. Ishte antar i këshillit bashkiak, Njësia Nr 11 Laprakë, kryetar i këtij këshilli dhe sot antër i këshillit bashkiak Tiranë. Në fund për të pranishmit u shtrua një koktej nga miq e koleg të tij.

portret

Hajri Shehu i përket sërës së njerëzve që quhen *"heronj të heshtur"*. Dijet e tij në lëmin e gjuhë shqipe dhe në gjuhën angleze janë me të vërtetë enciklopedike.

Hajri Shehu, një personalitet i heshtur i gjuhësisë shqiptare

Nga **Prof.dr. Eshref YMERI**

KUSH ËSHTË PROF.DR. HAJRI SHEHU

Ka lindur më 10 qershor 1942 në fshatin Vleshë të qarkut të Dibrës. Ka mbaruar shkollën e mesme pedagogjike në qytetin e Peshkopisë. Gjatë vitit 1961 ka qenë student i Institutit të gjuhëve lindore në Moskë. Pasi Hrushovi i ndërpreu të gjitha marrëdhëniet me vendin tonë, ai u kthye në atdhe dhe në vitin 1965 i përfundoi studimet e larta në degën e gjuhës angleze të Fakultetit të historisë dhe të filologjisë të Universitetit të Tiranës. Në periudhën mes viteve 1965-1966 dhe 1968-1970, ushtroi detyrën e mësuesit të gjuhës angleze në qytetin e Peshkopisë. Meqenëse gjatë kësaj periudhe kishte shfaqur interesim të veçantë në lëmin e studimeve gjuhësore, drejtori i Institutit të gjuhësisë dhe të letërsisë, prof. Androkli Kostallari, u interesua në strukturat përkatëse shtetërore për ta tërhequr në Institutin në fjalë. Kjo u bë e mundur në vitin 1971, kur ai filloi punën në sektorin e leksikografisë të Institutit të gjuhësisë dhe të letërsisë pranë Akademisë së Shkencave. Në këtë Institut ai punoi vite të tëra (1971-1993, 1997-2010), deri sa doli në pension.

Është për t'u përmendur fakti që prof.dr. Hajri Shehu është marrë intensivisht edhe me përkthime nga anglishtja në shqip dhe me redaktime përkthimesh nga arabishtja në shqip në Organizatën Ndërkombëtare Islamike të Ndihmës (International Islamic Relief Organization), e cila e ka rezidencën në Arabinë Saudite dhe një zyrë në Shqipëri. Këtë lloj aktiviteti e ka ushtruar në vitet 1993-1995. Si një specialist i shkëlqyer i gjuhës angleze, prof.dr. Hajri Shehu pati tërhequr edhe vëmendjen e katedrës së gjuhës angleze të Universitetit të Tiranës, e cila e ftoi në detyrën e pedagogut të anglishtes në vitet 1995-1997.

Gjatë viteve të punës në Institutin e gjuhësisë dhe të letërsisë, prof. dr. Hajri Shehu vendosi lidhje me Shtëpinë botuese të Oksfordit (Oxford University Press). Ai është anëtar i Euroaleksit (Shoqata Evropiane e Leksikografëve), si edhe i "Alex Nash Fellowship of Albanian Studies" pranë Universitetit të Londrës.

Prof. dr. Hajri Shehu ka një aktivitet mjaft të pasur shkencor. Ai është bashkautor dhe autor i 22 fjalorëve të gjuhës shqipe dhe të fjalorëve anglisht-shqip, shumica të botuar dhe ca në dorëshkrim që po përgatiten për në shtyp.Është autor i disa monografive dhe i më shumë se 40 artikujve shkencorë, kushtuar problemeve të gjuhës së sotme letrare shqipe, të leksikologjisë, të leksikografisë dhe të fjalëformimit, të botuar në revista të tilla shkencore, si *"Studime filologjike"*, *"Studia albanica"*, *"Gjuha jonë"*, *"Gjuha shqipe"*, *"Lexicography"* (Oxford).

Prof.dr. Hajri Shehu është autor i disa zërave për Fjalorin enciklopedik shqiptar, si edhe i më shumë se 30 referateve shkencore që i ka mbajtur në Institutin e gjuhësisë dhe të letërsisë, në Katedrën e gjuhës shqipe të Fakultetit të historisë dhe të filologjisë të Universitetit të Tiranës dhe në sektorin shkencor të Akademisë ushtarake.

Aiështë autor i disa kumtesave shkencore, të cilat i ka mbajtur në konferenca dhe kongrese kombëtare dhe ndërkombëtare



që janë zhvilluar në Tiranë, në Prishtinë, në Ohër, në Oksford, në Teheran etj.

Duhet theksuar fakti që Prof.dr. Hajri Shehu ka skeduar fjalë të gjuhës shqipe nga 100 mijë faqe librash të ndryshme për pasurimin e fondit leksikor të gjuhës shqipe pranë Institutit të gjuhësisë dhe të letërsisë. Në të njëjtën kohë, ai ka drejtuar dhjetra ekspedita gjuhësore në shumë qëndra banimi të vendit tonë për vjeljen e fjalëve të panjohura nga thesari i gjuhës së popullit.

Meqenëse në vitet e para të punës së tij pati ushtruar detyrën e mësuesit të gjuhës angleze, ai i ka kushtuar vëmendje punës për përgatitjen e teksteve mësimore. Ai është autor i disa teksteve të gjuhës angleze për shkollën fillore. Në shumë organe ai ka botuar një sërë artikujsh studimorë, kushtuar mësimdhënies në shkollë. Në shtypin e përditshëm dhe periodik ai, gjithashtu, ka pasë botuar shumë artikuj popullorë-shkencorë, kushtuar përsëri mësimdhënies në shkollë.

Puna përkthimore dhe redaktoriale ka qenë një pasion i përhershëm në veprimtarinë shkencore të Prof.dr. Hajri Shehut. Ai ka përkthyer dhe redaktuar 10 mijë faqe nga letërsia islame. Në disa revista ka botuar *"Treguesin e Kuranit"*, artikuj studimorë dhe parathënie për librat që i kushtohen Kuranit. Ai, po ashtu, është autor artikujsh publicistikë dhe reportazhesh, të botuar në disa organe shtypi.

Për të kënaqur kërshërinë e lexuesve,nga aktiviteti shkencor i prof.dr. Hajri Shehut, të pasqyruar në jetëshkrimin e tij, këtu poshtë po rendis vetëm listën e fjalorëve, të përgatitur si autor dhe si bashkautor, që përbëjnë një kontribut të jashtëzakonshëm në leksikografinë shqipe dhe në leksikografinë dygjuhëshe.

"Fjalor shumëvëllimësh i gjuhës shqipe", vëllimet II, III (vepër në dorëshkrim) (bashkautor)

"Fjalor i gjuhës së sotme shqipe", Tiranë, 1980 (nderuar me çmimin e Republikës) (bashkautor/shkronjat *D* (pjesërisht), *E, Ë, F, P*/ pjepër / prridhje, *V*/ 270 f.)

"Fjalor i shqipes së sotme", Tiranë 1984 (bashkautor / 165 f.)

"Fjalor i shqipes së sotme", Tiranë 1984 (sistemim e përpunim i frazeologjisë së gjithë Fjalorit / mbi 4000 njësi)

Prof. dr. Hajri Shehu ka një aktivitet mjaft të pasur shkencor. Ai është bashkautor dhe autor i 22 fjalorëve të gjuhës shqipe dhe të fjalorëve anglisht-shqip, shumica të botuar dhe ca në dorëshkrim që po përgatiten për në shtyp.Është autor i disa monografive dhe i më shumë se 40 artikujve shkencorë, kushtuar problemeve të gjuhës së sotme letrare shqipe, të leksikologjisë, të leksikografisë dhe të fjalëformimit, të botuar në revista shkencore...

"Fjalor i shqipes së sotme", Tiranë, 2002 (bashkautor / 216 f.)

"Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe", Tiranë, 2004 (bashkautor / 314 f.)

"Fjalor i gjuhës shqipe", Tiranë, 2006 (bashkautor / 179 f.)

"Fjalor i gjuhës shqipe" (për shkollën) (vepër për shtyp) (bashkautor)

"Fjalor i gjuhës shqipe" (për shkollarë të vegjël) (vepër për shtyp) (bashkautor)

"Fjalor i termave të artilerisë (shqip-anglisht-rusisht)", Tiranë, 1987 (bashkautor dhe bashkëredaktor)

"Fjalor i termave të prapavijës (shqip-anglisht-rusisht)", Tiranë, 1987 (bashkautor dhe bashkëredaktor)

"Fjalor themelor i termave të bujqësisë", Tiranë, 2006 (bashkëredaktor)

"Fjalor anglisht-shqip i fjalëve të urta" (vepër në dorëshkrim) (redaktor)

"Fjalor frazeologjik sinonimik anglisht-shqip" (vepër në dorëshkrim) (autor)

"Fjalor anglisht-shqip" me rreth 400 emërtime bimësh (vepër në dorëshkrim) (autor)

"Fjalor arabisht-shqip", Tiranë, 2009 (bashkëredaktor)

"Fjalor anglisht-shqip", Tiranë, 2010 (autor / 834 f.)

"Fjalor persisht-shqip", Tiranë, 2010 (bashkëredaktor)

"Fjalor me fjalë e shprehje popullore nga Ujemuja", Tiranë, 2014 (autor / vepër për shtyp)

"Fjalor tematik bashkëbisedimor anglisht-shqip (vepër në dorëshkrim)

"Fjalor anglisht-shqip i thënieve dhe i njësive frazeologjike" (bashkautor me të birin, Bledarin; vepër për shtyp)

"Fjalor xhepi anglisht-shqip dhe shqip-anglisht" (bashkautor me të birin, Bledarin; vepër për shtyp)

Gjatë kohës që ka punuar në Institutin e gjuhësisë dhe të letërsisë, prof.dr. Hajri Shehu ka gëzuar respektin e të gjithë kolegëve-gjuhëtar. Respekt të veçantë ushqente ndaj tij drejtori i Institutit të gjuhësisë dhe të letërsisë, prof. Androkli Kostallari, i cili e vlerësonte së tepërmipër punën e tij këmbëngulëse, të heshtur dhe me cilësi të lartë.



E kam njohur profesor Hajriun që gjatë viteve studentore. Takimet tona kanë qenë dhe janë mjaft të shpeshta që kur ai vazhdonte punën në sektorin e leksikografisë të Insitutit të gjuhësisë dhe të letërsisë. Më bënte shumë përshtypje, ashtu si edhe deri tani, natyra e tij e heshtur, modestia shembullore, ngohtësia e shpirtit. Me vite kisha krijuar bindjen e patundur se ai i përket sërës së njerëzve që quhen *"heronj të heshtur"*. Dijet e tij në lëmin e gjuhë shqipe dhe në gjuhën angleze janë me të vërtetë enciklopedike.

Vitin e kaluar, Prof.dr. Hajri Shehu botoi një vepër shkencore mjaft të rëndësishme, që përbën një tjetër kontribut me shumë vlerë në fushën e studimit të leksikut dhe të leksikografisë së gjuhës shqipe. Vepra titullohet: *"Studime për leksikun dhe leksikografinë e sotme shqipe"*. Librin e ka botuar Qendra e studimeve albanologjike, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë. Shtypshkronja "Kaltrina". Tiranë, 2015. Vepra ka një vëllim prej 364 faqesh. Recezent i librit është prof.dr. Thanas Feka.

Shënim: Në numrin e ardhshëm do të botojmë një recensë rreth këtij botimi të ri.

Bëj pajtimin tënd me

PayPal

përmes emailit

<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:

Në Shqipëri: 600 lekë.

Në Europë: 10 Euro.

Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA
është vetëm në versionin PDF.

Shënime për vëllimin poetik të
Astrit Balliut "Jeta nuk do gjumë"

Poetika e emigacionit në shprushitjen e rrënjëve…

Nga **Qazim D. SHEHU**



Dy librat e autorit japin shenja të mira dhe flasin për profilin e një poeti me këmbë në tokë që vjen modestisht, pa bujë, ashtu siç na vjen ky poet nga emigracioni, po ku emigracioni e bën që të shprushitë përmes mallit të tij rrënjët e vendlindjes, ato rrënjë që përbëjnë forcën identitare të çdo njeriu dhe krijojnë natyrshëm krenari të tij në jetë.

JETA NUK DO GJUMË
Astrit Balliu
Botimet M&B
ISBN: 978-9928-172-71-6
Faqe: 152
Çmimi: 500 lekë

Sa herë më ka qëlluar rasti të lexoj poezi të poetëve shqiptarë, emigrant, si për rastësi apo në vijimësi, më ka ndodhur të vërej një shqetësim që sillet në dy kahe, në pengun e mallit të vendlindjes dhe në jetën e emigrantit që do, po nuk mundet të vijë në vendlindje. Kjo, në një aspekt ideotematik dhe estetik përbën një risi tematike dhe ngre shtratin e një uni të ri në poezinë shqipe, në kohrat e reja moderne. Kështu më ndodhi edhe me librin e Astri Balliut, poet emigrant në Greqi, që, këto ditë përuroi librin e ri në gjimnazin "Ibrahim Rugova" të Kamzës , në prani të miqve dibranë si: Baftjar Gazidede, Ramazan Ilnica, Fatime Kulli - poete, Jahe Fida - poet, Bujar Karoshi - botues, të mësuesve Zoje Bushgjoka, Fatbardha Muça, Arjana Metalia dhe të mjaft nxënësve të talentuar të kësaj shkolle.

Redaktore e librit është Luljeta Dishi-Prençi, drejtoreshë e kësaj shkolle, njëherit mësuese letërsie. Astrit Balliu zgjodhi pikërisht atë mjedis ku krahas poezisë kërkoi të ndante ca çaste çmalljeje dhe takimi me njerëzit që i do dhe i ka takuar dikur e, gjen rastin që përmes poezisë t`i takojë sërish. Kështu, do theksuar se poezia si gjithnjë bëhet një faktor promovues dhe afrues i shpirtit njerëzor, ajo sjell gjithnjë jo vetëm një përafrim vlerash dhe nevojë për identifikim dhe komunikim. Takimi mori një vlerë të shtuar nga moderator i njohur Dëfrim Methasani dhe regjisori e aktori Fran Vukaj, i cili me poezitë e recituara arrit t`i afrojë ato më tepër drejt një timbri deshifrues të komunikimit dhe afërsisë, duke i dhënë fjalës një vlerë të re.

Më bën përshtypje fakti se Astrit Balliu duke qenë nga Muhuri i Dibrës, edhe pse ka kaluar një kalvar vuajtjesh dhe pengesash në jetën e tij emigratore, ai përherë e ka ruajtur atë kthjelltësi dhe qetësi të natyrës së dibranit, bart në vargun e tij mençurinë e fjalës dibrane dhe ruan të pastër tonusin e ndikimit të folklorit dhe të nervit shqiptar, aq e vështirë sot, kur dihet se emigrimi bart edhe rreziqet e trysnisë së një qytetërimi tjetër në harmoni me qytetërimin global. Motivi i atdheut bëhet motivi mbizotërues në poezinë e tij që gërshetohet harmonikisht me atë të vendlindjes. Citojmë: " Ç`më mori malli për ty fshat, / Ç`të mori malli ty për mua / I mjeri unë ç`e pata fat, / larg teje të jem, sado që s`dua…".

Atdhedashuria mbetet si provë e ekzistencës dhe e vijimësisë, si rritje e individit dhe kredo morale, ajo nuk është një patetikë e zbrazët dhe inkonjito, përkundrazi mbetet e besueshme dhe nuk ka nevojë as të mistifikohet dhe as të kalojë në grafikët e një propagande të zbrazët. Ky motiv për poetin është një motiv shqetësues prej nga ai përcakton kredon e qenësisë së tij dhe përcakton spontanisht obkjektivat e poezisë së vet.

Duke jetuar në Greqi, në atdheun e Seferisit, Ricosit, Kavafasit, Elitisit e të sa poetëve modernë të sotëm, patjetër që ai i ka lexuar ato, po më së shumti poeti nuk e harron dhe e mbart me vete atdheun e vet si "një plagosje", po të perifrazonim Seferisin, sepse atdheu për një emigrant është shumëçka , sidomos kur ai ëndërron shpesh që edhe vendi i vet t`u ngjajë vendeve të përparuara. Në këtë kontekst ai e shikon njëherit edhe segmentin e ëndrrës dhe përvijimin e motos së individit duke e shprehur atë në titullin: "Jeta nuk do gjumë", ajo përherë bëhet e bukur dhe krijon forcë dhe kuptim kur jetohet vrullshëm dhe me synime të qarta. Në këtë mënyrë, në të këtë titull, sado të zakonshëm, ai shpreh në nëntekst edhe suksesin dhe përvojën e atyre emigrantëve që ditën njëkohësisht të ballafaqohen me një botë të huaj, sa pritëse aq edhe sfiduese, duke krijuar konceptin kryesor të një jete të jetuar me dinjitet dhe kredo morale. Kështu jepet formatimi i njeriut, këndet e ndryshme të individit të cilat si prizma lëvizës ndriçojnë dhe lënë në gjysmë hije zona të ndryshme të shpirtit njerëzor. Dhe dashuria kthehet në një kryemotiv tek ky poet, ajo bëhet fjala dhe motori gjenerues i gjithçkaje të mirë dhe të bukur. Ajo tek ky poet bëhet shprehëse e ndjenjave të sinqerta dhe ndjenjat e sinqerta e mbartin atë në një lojë pa hile.

Dashuria për atdheun, dashuria si koncept patriotik, dashuria si koncept filozofik, dashuria për njerëzit e afërt, për gjithçka që i përket së kaluarës dhe së tashmes, për gjithçka që shtrohet në një dëshirë të sinqertë për të ardhmen. Sepse poeti beson se gjithçka është e bukur, e sinqertë, fluide dhe transparente, nëse ne mendojmë pozitivisht dhe pranojmë po ashtu për gjërat që njohim dhe që duhet të na përkasin natyrshëm. Çdo modë apo përpjekje për tejkalim të vetvetes, nuk sjell veçse denatyrim dhe asfiksi. Kjo i ka sjellë edhe një varg të sinqertë, të thjeshtë, komunikues, larg nevojës për të bërë bujë e për t`u dukur, gjë e mirë për një poet që i futet rrugës së vështirë të poezisë me forcat e veta; po kështu në vëllimin e tij ndjenja mbetet e përmbajtur dhe e zjarrtë , ajo është e ngrohtë dhe komunikuese.

Në organizimin strofik dhe ritmik duke ruajtur rimat dhe kadencat e duhura, poeti në bashkëveprim edhe me redaktoren Luljeta Dishi-Prençi ka arritur të performojë një varg të skalitur dhe një varg që rrjedh qetësisht e me dallgë të hovshme si valët e Drinit të Zi, që kalon përmes trevës së Dibrës. Duke shkruar për gjëra që i njeh, apo që i mungojnë, si: gjuha shqipe në një vend ku flitet një gjuhë tjetër, peizazhet e bvendlindjes vijnë me një etje të tjetërllojtë në poetikën e Astrit Balliut.

Në përgjithësi i qëndron besnik skalitjes së fjalës, gjë e rëndësishme për një poet serioz, di ta masë atë dhe ta vendosë në rendin e duhur të shprehjes, di të ruajë sensin e masës dhe të krijojë një arkitekturë të thjeshtë të ngrehinës së vjershës duke ruajtur raporte të ndërtimit të saj. Si një poezi e frymëzimit nga fakti jetësor, shpesh ajo vjen përmes minifabulave të gjetura dhe të goditura, kështu motivohet ndjenja përmes një perceptimi shqisor dhe mendimor të natyrshëm, dhe ky motivim e jep aq bukur shpirtin njerëzor, mallin brengën, pritje, kohën si vektorizim i së shkuarës dhe kohën si pritje për të ngritur një çerdhe dëshire në substancë të së mirës. Poeti nuk shtiret, nuk moralizon, por poezia e mbart moralin duke ruajtur pikërisht atë që ndërtohet tek e mira në kontrast me të keqen dhe vuajtjen. Përditshmëra bëhet nxitje dhe qëllim, për të ecur përmes saj në obkjektivat tona , pa harruar gjithnjë anën burimore të gjërave, nga vijmë dhe ku shkojmë. Poezia e tij sa bëhet kushtimore, duke përmendur emra vendesh dhe njerëzish, aq bëhet edhe intime dhe në tendencën e saj për të kapur aspekte të jetës së thjeshtë, gjithnjë brenda shqetësimit poetik të një njeriu që gjithnjë rreket dhe mundohet ta thotë diçka, ashtu siç e mendon dhe e do ai ta shprehë.

Në përfundim, ne mund të themi se poeti Astrit Balliu, me librin e dytë: "Jeta nuk do gjumë" sjell një poezi që lexohet me endje, të strukutruar me një verb të thjeshtë dhe në natyrën e të shprehurit ndiesor, larg pompozitetit dhe manisë për t`u dukur. Pas librit të parë me poezi "Princesha ime" në librin e dytë ai tregon rritje dhe zgjerim të frymës tematike dhe të gamës së vështrimit. Duke qenë se ai është i ri dhe poezinë e shkruan nga nevoja për t`u shprehur dhe se ka për të thenë, besimi se ai do vijë me libra të tjerë ngjan i sigurtë.

Dy librat e autorit japin shenja të mira dhe flasin për profilin e një poeti me këmbë në tokë që vjen modestisht, pa bujë, ashtu siç na vjen ky poet nga emigracioni, po ku emigracioni e bën që të shprushitë përmes mallit të tij rrënjët e vendlindjes, ato rrënjë që përbëjnë forcën identitare të çdo njeriu dhe krijojnë natyrshëm krenari të tij në jetë. Poezia e tij shkruhet dhe vjen përmes estetikës së vargut të thjeshtë, të rrjedhshëm, kualitativ në ndjenjë dhe me një perceptim të qartë, pa ekuivoke. Ajo është poezia e atdheut të munguar, po që nuk mungon kurrë, sado që je larg tij, sidomos kur atdheun e do dhe kërkon afërmendsh edhe ti dashurinë e tij, të njerëzve të tu, farefisit shokëve, miqve….

Botim i ri



MARGARITARI I KURORËS
Osman Xhili
Botime M&B, 2016
Faqe 272
ISBN 978-9928-172-70-9
Çmimi: 500 lekë

Feja islame është një kurorë plot shkëlqim, kurse ne, besimtarët, jemi diamantet e saj.

Jo thjesht për zakonin që e duan librat, por vërtet e pamë të nevojshme t'i thoshim nja dy fjalë, t'i sqaronim disa gjëra, para se lexuesi të hyjë në brendësi të librit.

Së pari, e kemi titulluar librin kështu, jo për të zgjedhur një titull bombastik, porse, vetë feja islame është si një kurorë plot shkëlqim, kurse ne, besimtarët, jemi diamantet e saj. Haxhi, Ahmet Çaushi është njëri prej nesh, është njëri prej këtyre diamanteve, që përpiqet çdo ditë të jetës së tij të shtojë mirësitë.

Së dyti, ai këmbënguli që të mos shkruhej e të mos botohej libri, sa ai ishte gjallë, por dhe unë këmbëngula fort për dy arsye.

Desha që libri të shohë sa më parë dritën e botimit, për ato histori e dokumenta të shumta që përmban dhe nuk doja që të hapja letra e arkiva, kur e kisha të gjallë arkivin e mund ta shfrytëzoja për bukuri.

Së treti, tregimet në libër kalojnë nga veta e parë, në vetën e tretë dhe anasjelltas. Nuk ka qenë një lapsus, por më dukej sikur në atë formë e mënyrë tingëllonte më origjinale dhe ishte më e këndshme për lexuesin. Gjykojmë që libri është përtej një monografie të thjeshtë, pasi aty ka kapituj për ardhjen e kosovarëve, për pajtimin e gjaqeve, për ndërtimin e xhamive, të huajt për islamin e plot episode të tilla, që janë të gjitha të dokumentuara e të protokolluara. Të gjitha këto pasqyrojnë atë punë titanike të haxhi Ahmetit me shokë, që, në fakt, është dhe historiku i myftinisë së Dibrës në harkun kohor të këtyre viteve. Sidoqoftë, fjalën e ka lexuesi dhe ai di ta thotë më së miri gjykimin për veprën që ka në dorë. I urojmë haxhi Ahmetit dhe familjes së tij jetë e shëndet, duke kontribuar akoma për shoqërinë e komunitetin që e rrethon.

Autori

homazh

Rakip Sinani, një jetë që meritoi pavdekësinë

Nga **Halil TEODORI**

Mjafton një çast për tu bërë hero, por duhet një jetë e tërë për t'u bërë njeri i denjë, thotë një sentencë e shkrimtarit francez, Pol Brjul. Ai, erdhi për të jetuar nje jetë dhe në këtë përmendore që e ngriti me më të mirën nga vetja ai u bë një njeri i denjë, njeri i denjë për respekt, për kujtesë dhe për mirënjohje. Sepse është shembulli i tij, është gjithçka ai ishte dhe dha, ajo që jetësoi tek ne të gjithë, ne që jetuam me të.

I tillë ishte Rakip Sinani, i cili u nda nga jeta më 7 Mars 2009. I tillë ishte ai, ai që iku dhe la gjithçka kishte më të shtrenjtë, për të merituar pavdekësinë. Ai, ai që diti të ishte, të bënte dhe të jepte si pakkush. Me urtësi dhe maturi, me përkushtim e vetëmohim, ai u përpoq me mish e me shpirt që të kontribuonte pa kursim dhe me vendosmëri çështjes kombëtare shqiptare. Mirënjohje për krejtçka skaliti në memuarin e gjithë shqiptarisë, jo vetëm si mësues por dhe si oficer karriere. Ai la pas shume mbresa, sepse ishte mbi të gjitha një humanist i pashembullt, një njeri i mirë.

Rakip Sinani ishte një intelektual i mirëfillte, i cili njohu me mirë se gjithkush historinë e Dibrës, veçanërisht vendlindjen e Gjergj Kastriotit (Skenderbe), duke u përshtatur me vendin ku jetoi e punoi si ushtarak.

Ishte një studiues i traditës dhe i modernes, mbasi njihte shume mirë këtë nga që kishte studiuar artin ushtarak. Unë jam krenare për Rakip Sinanin, jo vetëm se u lindem dhe u rritem që të dy në të njëjtën treve, Smollik (Zerqanit), por se ai është pjesë e asaj elite intelektuale Dibrane qe i ka dhënë historisë me punën dhe veprën e tij. Predikoi për misionin, bashkoi grigjën rreth idesë së shenjtë dhe besimit dhe tani merr udhën e përjetësisë, duke lënë pas kujtime, vetë shpirtin, frymën e misionit, që ende se ka mbaruar.

Rakip Sinanin u lind në vitin 1938, në një familje me tradita atdhetare dhe patriotike. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje. Ishte një nga nxënësit më të përgatitur dhe me paraqitje shembullore në mësime.

Shkollën e mesme e mbaroi në Tiranë " N. N. Gjoka" në vitin 1955.

Kur mbaroi shkollë punoi si mësues në Lejçan, Ostren i Madh, Smollik dhe Lladimeric, ku frymëzoi brezat me dëshirën për të marrë dije dhe arsim, për të besuar se gjithçka në emër të së ardhmes dhe progresit vjen nëpër të vetmen rrugë, atë të dijes.

Në vitin 1967 mbaroi shkolën e bashkuar Tiranë. Dhe punoi si oficer në repartet e ish brigadës së Peshkopisë.

Nga viti 1988 deri në vitin 1992 ka kryer detyrën e shefit të personelit në degën ushtarake Diber.

Rakip Sinani ishte jo vetëm një oficer i thjeshtë por një ushtarak historian. Si ushtarak profesionist ka bërë hulumtime shkencore në fushën e historisë në këndvështrimin ushtarak.

Ai ka botuar disa libra.

Më të përmendurat janë:

"Betejat e Skënderbeut", "Kujtime historike", "Dibra dhe dibranët në faqen e historisë", "Kështjellat në vitet 1443-1468", "Kryengritja e armatosur e dhjetorit 1924 (Lufta në Kalanë e Dodës dhe, Peshkopi), "Lufta e Penestëve me Maqedonët 169 p.e.s, Lufta e Penestëve me romakët", "Betejat e Skënderbeut", "Kryengritja e Dibrës në shkurt të vitit 1714", "Nëntë Malete e Dibrës gjatë sundimit osman", "Një vështrim gjeografik: Treva e Dibrës, Kështjellat e Dibrës: fortifikatat mbrojtëse, "Beteja e Pollogut 22 prill 1453", "Beteja e Ursarës në Itali",tetor 1461, "Beteja e grykës së Radikës", "Kryengritja e Dibrës në gjysmën e shek XVI", "Tri betejat e Skëndërbeut në Dibër", "Ata ishin nga Dibra" etj....

Gjithashtu autori ka lënë në dorëshkrim një vepër mjaft të vyer që së shpejti do të shohë dritën e botimit, e cila titullohet "Njëzetepesë betejat e Skëndërbeut".

Një sërë dorëshkrimesh të tjera të karakterit historik, toponimet e vendit dhe shkrime të tjera. Vepra e tij dëshmon dhe vërteton katërcipërisht jo vetëm origjinën dhe përkushtimin e tij të palodhur, por dhe ballafaqon atë me të drejtën dhe detyresën e secilit nga ne për të bërë dhe për të dhënë më të mirë në emër të vlerave dhe traditës, në emër të kombit dhe flamurit, në emër të etërve dhe amanetit.

Por, pikërisht, atëherë kur ai kishte dëshire të jetonte më shumë dhe të rijetonte në gjithçka magjinë e të bukurës, krenares, të shijonte gjithë këto të mira që i solli puna e ndershme, si dhe në kulmin e punës për të shkruar historinë, Rakipi shuhet si një qiri. Ndarja e beftë nga jeta nuk na e merr të gjithin me vete harrimi, ikja, përtëritja, vazhdimësia.

Na lë diçka të shenjtë te të gjithë ne. Na lë veprën, të cilën e endi me pasion e përkushtim, na lë kujtimet që i endi me më të mirën dhe më të virtytshmen e tij, na lë imazhin e një fisniku që ikën dhe rivjen për të qenë gjithnjë ai që ne kemi njohur, ai që ne kemi dëshiruar, ai që në kemi dashur dhe respektuar.

Ai iku për të mbetur gjithnjë mes më të dashurve të zemrës, ndoshta iku për të mbetur ashtu siç nuk do ta donte, por jeta kështu është, iku për të mbetur dhimbje dhe pikëllim, boshllëk dhe mungesë te fëmijët që i deshi aq shumë, nipa e mbesa, bashkëshorten e nderuar, miqtë, shokët e dashamirës të shumtë nga gjithkah ku e njohën si njeri dhe si vepër.

Vdiq me 7 Mars 2009 për të mbetur gjithnjë i gjallë në kujtesë, në vendlindjen.

***

Sapo kalon Strikçanin një fshat në lindje të Zerqanit të Dibrës, lë në anën e majtë Lubaleshin dhe rrugën automobilistike që të çon drejt e në Smollik, në vendlindjen e Rakip Sinanit.

Udhëtimi përnga "Fushat e Lubaleshit", padyshim është një kahje për ta përshkuar si në rrugëtim i përshtatshëm, por gjithashtu një mundësi për të depërtuar brenda kësaj magjie që shfaqet e bollshme dhe krahëhapur, e cila sa vjen e të përpin brenda vetes, si në një joshje dehëse.

***

Smolliku është një fshat kodrinorë ku si një prej gurëve më të çmuar të këtij xherdani mund të përmendim bukurinë e natyrës, trashëgiminë mbresëlënëse kulturore dhe përzemërsinë e njerëzve.

Kush dëshiron ta zbulojë Smollikun i duhen jo shumë ditë. Dëshirat nga mundësia i ndan vetëm një hap. Është ky hap të cilin e gjen gjithkush në dëshirimin e tij dhe vullnetin për ti dhuruar vetes një emocion dhe sentimenteve një impresion. Përgjatë rrugës së re në anë të lumit të Okshtunit nga e majta shtrihet Smolliku. Historia është e lashtë. Dëshmime të ndryshme, të vërtetuara përmes faktesh bindëse bëhet fjalë se banorët e këtushëm janë autokton. Para shekullit të XV banorët kanë qenë të gjithë të besimit Katolik dhe Ortodoks.

Përballë fshatit në anën lindore të tij gjendet fshati Kojovec me një kala të lashtë, rrënojat e së cilës dëshmojnë për qëndresën që këto banorë i kanë bërë hordhive të barbarëve. Jo shumë larg prej aty, pak më shumë se 300 metra distanc shtihet lumi. Në qindvjeçarin e kaluar ka funksionuar dhe një hidrocentral i vogël që jepte dritë për një pjesë të banorëve, natyrisht familjeve të privilegjuara. Lumi gjatë dimrit është pothuajse i pakalueshëm, për shkak të reshjeve të shumta që bien dhe prurjeve që sjellin përrenjtë. Por në stinën e verës, këtu natyra dhe panorama piktoreske garantojnë mundësinë e një atraksioni vërtetë çlodhës, për banorët, të rinjtë, por edhe për ata që duan ti dhurojnë vetes një mundësi ndryshe relaksi.

***

Shtëpi dy-tre katërshe, të mbuluara me tjegull,diku diku rrasa guri, pothuajse të ndërtuar të gjitha në 100-vjeçarin e kaluar disa prej këtyre shtëpive janë rinovuar por ka dhe nga ato që kanë nisur të dëmtohen seriozisht, për shkak se banorët janë shpërngulur në Tiranë mbas viteve '90, duke i lënë ata pa mirëmbajtje. Deri në vitin 1990 fshati ka pasur rreth 80 shtëpi. Shkolla 8-vjeçare dhe ajo e ciklit të ulët kanë funksionuar gjithë kohën në këto anë. Fshati ekonominë e saj e ka mbështetur tek resurset bujqësore dhe blegtorale. Specifika e veçantë e natyrës ka dhe dhe banorin e saj në këtë habitat që është dhija dhe delja. Fruta të shumëllojshme, si rrushi, qershia, molla, mani, dardha, pjeshka, arra, geshtenja.. etj e shtojnë bujarinë e natyrës dhe duarve të palodhura të punëtorëve në këto anë. Disa kultivarë të frutikulturës për arsye të kushteve më të favorshme atmosferike piqem më shpejt se në zonat përreth, duke e bërë këtë vend të privilegjuar.

Po kështu dhe zarzavatet dalin më herët me prodhimet e tyre. Dimrave, si kudo në lartësitë e relievit malor, bora troket me putrat e saj të bardha, por zemra e ngrohtë e këtyre banorëve dhe klima e përcjellin më herët bardhësinë, për t'i lënë vendin pranverës që vjen e begatë, shumëngjyrëshe dhe prehërplotë.

Lumi është i pasur më peshk të llojit troftë, me një shije karakteristike që e bën atë shumë të veçantë dhe të preferuar. Një veçanti e Smollikut është mani i zi. Pothuajse të gjithë banorët e kanë nga një të tillë në pronën e tyre, si një relike. Ai është i Smollekut dhe i tillë mbetet për shkak se askund nuk gjendet një kultivar i tillë identik.

Kjo pasuri e natyrës është më e themeltë dhe më e plotë në të qenin thesar ngase kjo zonë, ky prehër natyre ka përkundur dhe lartësuar në kujtesën e brezave njerëz të urtë dhe punëtorë duarartë. Ndërtimet me prirje të një stili arkitekturave të vjetër muzeal janë lartësuar bashkë me vitet në këto anë. Vetë Sinanët kanë vlerat e tyre të padiskutueshme. Ata janë njohur dhe vlerësuar për punës dhe dijen. Një elitë e gjerë intelektualësh ka dalë nga fisi i tyre, për të dhënë më të mirën, më të vyerën jo vetëm në Dibër por në gjithë Shqipërinë. Nga votra e Sinanëve do të përmendja, përveç Rakip Sinanin dhe elitën tjetër të intelektuale, si Rruzhdi Sinani, Lulzim Sinani, Shpresa Sinani si dhe Sanije Sinani ka mbaruar në Stamboll dhe është diplomuar në fushën e Ekonomis. Eneida studion në mjeksi. Pa harruar këtu dhe të devotshmin dhe të gjithë përkushtuarin që nuk kurseu asgjë në shërbim të komunitetit, Hysni Sinani.



Rakip Sinani na lë diçka të shenjtë te të gjithë ne. Na lë veprën, të cilën e endi me pasion e përkushtim, na lë kujtimet që i endi me më të mirën dhe më të virtytshmen e tij, na lë imazhin e një fisniku që ikën dhe rivjen për të qenë gjithnjë ai që ne kemi njohur, ai që ne kemi dëshiruar, ai që në kemi dashur dhe respektuar.

Rakip Sinani ishte një intelektual i mirëfillte, i cili njohu me mirë se gjithkush historinë e Dibrës, veçanërisht vendlindjen e Gjergj Kastriotit (Skenderbe), duke u përshtatur me vendin ku jetoi e punoi si ushtarak.

NGUSHËLLIME

Redaksia e gazetës i shpreh ngushëllimet bashkëpunëtorit të saj, Jahe Deliaj - Selmani, për humbjen e djalit të tij, Florian Deliaj, pas rrëzit të helikopterit të ushtrisë në liqenin e Shkodrës.

Redaksia e gazetës i shpreh gjithashtu ngushëllimet e saj edhe mikut dhe aktivistit të shoqërisë civile, Mustafa Tola, për humbjen tragjike të nipit të tij.

Zoti u dhashtë kurajo!

U qoftë dheu i lehtë!

printime dixhitale

me ngjyra dhe bardh e zi

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme

libra | broshura | revista | fletëpalosje

katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.

duke filluar nga 1 kopje e vetme

për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

Pajtohu në gazetën *RRUGA E ARBËRIT*

***Merr versionin* PDF ose kopjen print duke filluar me 50 lekë/muaj**



Gazeta ofron faqet e saj
për REKLAMA apo NJOFTIME
të ndryshme për biznese dhe individë.

ÇMIME TË ARSYESHME
për faqet me ngjyra dhe bardh e zi.

Për individët, njoftimet deri në 50 fjalë
(1/16 e faqes) ofrohen falas!

Për informacion:
E-mail: rrugaearberit@gmail.com
Tel: +355 69 20 68 603

Klinika Mjekësore
"VENIS"

Klinika mjekësore "VENIS" është klinika e parë private e Shëndetit Mendor në Shqipëri, e licencuar nga Ministria e Shëndetësisë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) si një aktivitet i tatueshëm.

Në klinikën "VENIS" ofrohet një shërbim i standarteve bashkëkohore si përsa i përket diagnostikimit dhe opsioneve të trajtimit mjekësor jo vetem me skemat e mjekimeve më të reja me barna por dhe me aplikimin e terapisë biologjike të elektrokonvulsoterapise ECT-Thymatron IV (Teknologjia më bashkëkohore), për trajtimin e pacientëve, te të cilët trajtimi i mëparshëm me barna nuk ka dhënë rezultatet e duhura.

1. **DIAGNOSTIKIM**. Procesi i diagnostikimit të çrregullimeve psikologjike apo psikiatrike realizohet pas një ekzaminimi të kujdesshëm nga specialistët e shëndetit mendor të cilët janë psikiatrit ose psikologët klinikë.
2. **TRAJTIM I DEPRESIONEVE REZISTENTE.** Procedura e ECT-së është një procedurë që realizohet vetëm në klinikën "VENIS" në Shqipëri dhe në trojet e tjera shqiptare.
3. **TRAJTIM MJEKËSOR.** Në klinikët tonë ruhet privatësia e individit, respektohen dhe mirëkuptohen orientimi seksual, përkatësia etnike, gjinore, apo preferencat fetare.
4. **KONSULENCË PROFESIONALE LIGJORE.** Klinika mjekësore "VENIS" ju ofron informim dhe ndihmë konkrete ligjore mbi të drejtat e pacientëve.

MOS KINI PARAGJYKIME! Sa më herët të kërkohet ndihma e specializuar, aq më shpejt trajtohen çrregullimet e çdo lloji.

"Venis" ju ofron mbështetjen e duhur.
Klinika ofron shërbimet e saj vetëm në ditët e javës
Orari: 08:00 - 16:00 E Shtunë, E Diel dhe Festat zyrtare: PUSHIM
Vizitat kryhen me planifikim paraprak.
Kontakt: Sekretaria: **04 2400 669** dhe **068 23 96287**
E-mail: **sadikhlala@gmail.com**